

BIBLIOTEKA

E

81H-32

1427

SHTETIT

GJIROKASTËR

Eglantina
Mandia

Lisa
të
mëdhenj

dy
novela

85H-52
1422

Eglantina
Mandia

LIBRARIA
"NAIM FRASHËRI"

Lisa
të
mëdhenj

•
dy
novela



85H-52
1422

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Dasma

1

Gruaja zbriti me të shpejtë shtegun e malit me një dridhje e një mallëngjim që nuk i kishte provuar prej kohësh. Lufta është një shok i zyrtë. Viti 1920 që më tepër se masakër. Gruas iu drodh trupi, megjithëse ishte korrik.

«Ikte Abdyl Shabani vetë i pestë. Në shpinë të një kali me pak kallamoq ngarkue. Gjithë gjindjen fukara e pa kurrfarë faji, i lidhi detashmenti çetnik e i copëtoi me bajonetë, — shkoi nëpër mend gruaja, — i mbuloi trupat me dhé e me thupra, për të fshehë krimin, por Islami, megjithëse i varrue me trembëdhjetë varrë, nuk pati vdekë dhe mbërrini deri te ne, të na kallëzonte ç'kishte bawaki. Se i ikën vdekjes njeriu me trembëdhjetë varrë në trup, nuk e kisha besue pa e pa me sytë e mi! Jo, — vijoi gruaja, — nuk due të mendoj për vdekje, veç ç'të baj, kur asht e rrethueme Galica dhe Drenica e mbushun me ushtarë.»

Ajo donte të mendonte diçka tjetër të bukur e të lehtë, diçka që t'i kujtonte një çast a orë të qetë. Por ditë të qeta nuk po gjente. Orë të bukura e të ndritura, po,

veç të qeta asnjëherë. Ajo donte t'i përmblihte të gjitha orët, por ato mërgonin nga vetja, diku fshiheshin, si zogjtë e trembur nga tufani. E tufani ishte i egër.

*Mori Hasime, more bi,
Ç'kije, Hasime, qi qan ti?
Unë qaj për dy vëllazni,
Fikë ma kanë të zezën shpi.*

Nga i vinte kjo këngë?

«Motër Hasime, — tha gruaja me zë të lartë, — ndofta kanga jote asht mendimi që po kërkoj e s'po e gjej. Ishe nuse e bukur, si nuset tona veç! E more hakën e vëllazënve, motër. E të mbyllën në burgje të errëta, e thanë: «e kemi robinë Hasimenë, mund të bëjmë ç'të duam me të!» Po në qelinë e burgut ishte një shtambë, e ti, nuse, për të ruejt veten, e vrave dhunuesin. Trupi yt i bardhë, ma i bukur u ba, mbulue nga gjaku në sheshin e burgut të Nishit.

E sot, motër, në kangë vjen tek unë e mendim të bukur po kërkoj prej teje. Për vdekje nuk due të mendoj, po si të baj, Hasime, që e shoh trupin tand të bardhë të skuqun nga gjaku e Drenicën mbushun me ushtarë të kralit.

Unë po shkoj te nana e Azemit. Due të mendoj pak për shtëpinë e re. Shtëpinë që ia ngriti Azemit Galica. Due të mendoj, kur kam hy nuse për herë të parë në atë derë. E po më dhimbset Sherifia, po më dhimbset fort, që duhet ta lajë kullën e sapondueme përsëri, të marrë rrugët e të ikë pa plang e pa shtëpi.

Shumë vjet të jetës së tyne këto nanat tona po i kalojnë kështu, pa nxjerrë asnjë ankim, asnjë ofshamë. Po këtë verë asht gëzue Sherifja. Fare pak kohë ka në kullën e re.»

Gruaja ecte me kujdes. U ruhej pritave e hafijeve.

«Asht kohë pune e njerëzit nguten ta futin grunin brenda, pa ia behë rrebeshi», mendonte.

Po binte muzgu.

Gruaja priti natën, e fshehur. Dritat e Galicës u fikën njëra pas tjetrës. Nata ishte e kthjellët.

«Erdhi koha», mendoj gruaja e hyri në Galicë me hapa të shpejtë. Ecte pa u ndier. I shmangej rrugës kryesore e më në fund u gjend përballë shtëpisë. «Po kjo asht një kullë tjetër. Asnjë ferkem nga kulla ku hyna nuse», — foli përsëri gruaja me zë, që të ndalonte të trokiturat e zemrës.

Nuk ishte as njëzet e pesë vjeçe gruaja, por i dukej se patën kaluar mote qysh kur mbante fustan të lehtë si të gjitha nuset e hynte në dhomën e Azem Bejtës. E Azem Galica, me sytë si gaca të ndezura, rrëmbente nusen, që e kishte pritur aq gjatë, me dorën e tij të fortë, Vitet ishin pak, por asaj i dukej tepër larg pritja e ankthi i kampit të Rudnikut, ku disa herë e qau si të vdekur Azemin. Kjo kishte ndodhur dikur moti.

«E njeriu mund të jetoka për një dekokë, njëqind vjet rrumbullak, — foli Shota. — A je plakë kështu nuse? Je plakë nga dhimbja e nga pushka e të ka humbë kanga. Të ka humbë e nuk po e gjen, veç kur do të mësysh nga Çiçavica?»

Nëna e Azemit u ngrit nga gjumi e nuk po e kuptonte përse po lehnin kështu qentë.

Ndezi llambën e bëri dritë.

Shota qëndronte e mbështetur pas murit.

Hëna verdhonte mbi mullarët e barit e nata dukej e pikëzuar me ar.

Shotën po e tundonte malli e nuk e dinte a kishte pasur në jetën e saj një natë të tillë të hënëzuar, që hynte deri në thellësi të kullës së tyre në Radishevë, kur ajo ishte Qerimja, Shota e vocërr sa grima, apo kjo pati qenë një ëndërr e kurrë e jetuar?

— Kush asht? — pyeti Sherifja.

— Hape, nanë, jam unë, Qerimja.

Shota hyri me vrull e ato mbetën të heshtura në një përqafim të gjatë.

— Mos u tut për ne, se jemi krejt mirë, — tha Shota.

— A jeni ju të gjithë mirë? — Zëri i Sherifes ishte i gëzuar dhe i lehtësuar nga ankthi për të birin.

— Po ju si jeni? — pyeti Shota.

— Për bukuri. Ja edhe kulla.

— E shoh. E bukur si nuse. Era gëlqere po i vjen, — tha Shota, ndërsa ngjitnin shkallët.

— Nuk asht terë ende, — tha Sherifja.

Shotës i theri në shpirt. Barrë të rëndë mbante mbi supe. «Ti je grua, shko në shtëpi, grua. Zjarri shuhet në vatër. Shko pranë vatrës, pranë sofrës, pranë djepit, grua!»

Nuk ia tha kurrë njeri me zë të lartë. Po kjo ishte hija e saj. E kishte këtë emër të butë: grua. Brenda vetes mbante edhe zjarrin e vatrës, edhe erën e sofrës, edhe ninullën e djepit.

Shota shtrëngoi dorën rreth brezit stolisur me fishekë.

— Po ju si keni jetue? — pyeti.

— Si veshka në mes të dhjavit, a s'po e sheh? E kam edhe një lopë, gumësht e djathë të njomë me kulaç. Të ka marrë malli?

— Boll, besa, — tha Shota, që e pati dashur Sherifen që ditën e parë. «Ndofta thjesht se asht nana e Azeomit, — mendoi. — E ata ngjasojnë si dy pika uji.»

— E pe grunin, Shotë? — pyeti Sherifja.

Kishte një fije krenari e gëzim në cdo lëvizje të nënës. Sherifja qëndronte përballë me flokët e rëndë, të thinjur para kohe, me zërin e ashpër prej burri. Shtat-hedhur, si e prerë për rrobën drenicake, nëna ruante brenda vetes qëndresë e forcë.

— Kam kalue përmes kallinjve, — tha Shota, — të naltë, të shëndoshë.

— Po ngutet Galica t'i mbushë hambarët, që të mos ia ketë frikën as dimnit e as kralit, — tha Sherifja e ia ngriti fitilin llambës.

Do të dëshironte edhe Shota ta gëzonte nënën. Do të dëshironte t'i thoshte që sot e tutje nuk do të jetë nevoja t'i tremben askujt. Se hambarët me grurë nuk do të digjen së bashku me kullat, se kallinjtë e grurit nuk do të stërpiken me gjak e me lot. Por ajo kishte ardhur duke u dredhuar pritave.

— Asht rrethue Drenica. Asht e mbushun me ushtarë të kralit, — tha Shota.

— Dale të të shohë pak nana. Je dobësue, Shotë, — tha Sherifja, ndërsa vendosi llambën mbi oxhak.

— Nga rruga e gjatë.

— Drejt e nga Çiçavica?

— Drejt. Azemi të çon të fala e të porosit të bash si të bash e të largohesh.

— Ani.

Asnjë ankim. Asnjë pyetje. Gjithnjë kështu.

Figura e Sherifes luhatej e nuk binte. Lojë e flakës së llambës.

Shota kishte mall. Kishte mall për çdo gjë. Edhe për erën e lehtë të drurit të ri në kullë. Edhe për shtrojat e bardha. Edhe për atë fëmijë, që po flinte e qetë në minder. Ishte vajza e vogël e vëllait të vrarë të Azemit. (I vetmi fëmijë i asaj kulle.)

Shota u gjunjëzua. U përkul e preku flokët e verdhë të vogëlushes, që flinte me një frymëmarrje të lehtë.

Vetëm tre vjet e ndanin me të birin.

Dikur i mbanin në djepe, pranë njëri-tjetrit. «Një çikë e një djalë me yll në ballë», — thoshte atëherë Sherifja. Po vajza ishte zgjatur, këmbët i dilnin jashtë shtrojës, të holla, si të tejdukshme. E djali «me yll në ballë» nuk ishte më.

— Qenka rritë Shqipja, — tha me zë të lartë Shota. — E ka thanë Azemi se do të bahet shqipe mali, — tha Sherifja.

Shota nuk e hoqi dorën nga flokët e butë të Shqipës.

«Baptije Seferi, vetë e dymbëdheta, e ka përcjellë Idrizin në Kaçanik e Moraçe, — mendoj gruaja. — E ti, Shotë Galica, dikur ke ndie dhimbjen e lindjes. E ajo ka qenë një ditë e bukur, e bardhë, si për çdo nuse. Po Baptije Seferi e ka ndjekë burrin me dymbëdhete carrokë në mal e në luftë. Gruaja që ka mundë t'i lindë burrit dymbëdhete fëmijë e të mos i ndahet pushkës, asht grueja ma e lumtun e Kosovës! E qindra mijëra gra të tjera ka Kosova!»

Shota u ngrit me kujdes e u shtrëngua ndër armë.

— Hallall, nanë, se më duhet të shkoj!

— Të shkosh? A nuk ban të pushosh pak?

— Jo, më presin shokët.

— Nuk po të la nana pa u çlodhë pak. Fli, se po të goj vetë. Fli pak, Qerime, se një gotë tamël po ta nxeh. Fli, e mira e nanës! Unë po të baj rojë, mos ki dert, të goj me kohë për Çiçavicë.

Shota u ul pranë Shqipes. Mbështeti kokën në jashtëkun e bardhë. Ndjeu frymëmarrjen e lehtë të vogëlushe dhe e mbështolli era e gëlqeres së re.

— Nesër edhe unë po e lëshoj lopën e po iki, — tha Sherifja duke dalë nga dhoma.

Shotën e këputi gjumi menjëherë. Kur u kthye me qumështin e bukën në dorë, Sherifja mbeti e hutuar. Gërsheti i nuses, i zi, i trashë, kishte rrëshqitur pranë flokëve të verdhë e të butë të Shqipes. Fytyra e Shotës në gjumë, e bardhë, e bardhë si biluri. Një dorë në pushkë e tjetrën ndër flokë të së voglës. Sherifja la qumështin në vatër. Lotët iu ngjitën e po i mbërthenin grykën.

«Ç'asht kështu me ty, plakë, që po të lëshon zemra krejt», — tha me zë të ulët.

Mjegulla e lotëve po i shpërndahej me zor. E sendet i lëviznin si ndër ujë.

«Sokolesha e nanës, kushedi sa kohë ke pa fjetë. Të bani jeta burrë, bijë, të shkoi rinia nëpër male, pa njohë dyshek e ditë të bardha. Në vend të fëmijës, të mbeti pushka në dorë, moj e bardha e nanës. E pate ti një djalë, o Shotë, e nana nuk mundi të ta ruejë, e nana nuk mundi të ta rritë, po ti asnjë fjalë, moj bijë.»

Shota po i nxirrte mallin e Azemit.

Nuk i bënin këmbët të largohej nga dhoma ku flinin ato të dyja. Shota me Shqipen e vogël. Të gjitha ato sende që e gëzuan dhe e qetuan zemrën e Sherifes tani nuk do t'i shihte më.

«E ti, more burrë, në luftë kur ke ra, — mendoi Sherifja, — katër djem i ke lanë pas vetes në kullë. Po sot vetëm me një sy po shohim. Veç Azemi e bija jo-

në Mihania po gjallojnë. Në çika kulla do të mbesë. Çikat e Kosovës në armë janë shtrëngue, o bacë. E ti këtë nuse nuk ke mujtë ta shohësh. I lumë do të ishe me arritë gjysh me u ba, por fort pak burra në Kosovë po arrijnë, se po kositen si bari, pa u rritë mirë», — tha Sherifja, këtë herë me zë e doli të shihte edhe një herë lopën në haur.

Iu afrua kafshës e ndjeu fërgëllimën e trupit të ngrohtë. I lëmoi lëkurën e ndritur e i ngriti kokën. Rrezja e hënës pasqyrohej në sytë e mbushur me lëng, si lot, të kafshës së gjorë!

«Mos u mërzit, moj Laramane! — tha gruaja. — Kisha dashë edhe ndonjë ditë së bashku ta kalojmë, se fort e butë, me sy si mëndafshi më je.» Sherifja i dëgjoi barginjtë që po mblidhnin bagëtinë. Nxori lopën te dera e i tha çobanit:

— Në qoftë se nuk jam në shtëpi, në darkë çoje te të zotët, bir, se ti e di fort mirë se kush na e ka falë.

E shtyu lopën si të donte të largonte bashkë me të edhe mendimin! «Kur të zgjohet Shqipja e të mos të të gjejë, do të të kërkojë.»

Sherifja i ngjiti shkallët shpejt e shpejt, që të zgjonte nusen, por u pendua e zbriti t'i bënte gati diçka për rrugë. — Si e kam humbë krejt, — tha.

«E tash erdhi ora. Një çerepare të ngrohtë me djathë të njomë po u çoj djemve në Çiçavicë. Bahu gati për rrugë Shotë. Se rruga asht e gjatë. E gjatë dhe e vështirë kjo rruga jonë. Ma e lehtë me dekë e ma vështirë me jetue.»

Por ende nuk ishte ngjitur në shkallët e para të kullës, kur një zë e bëri t'i mbeteshin hejbet në dorë. U drodh dhe shtangu, në këmbë.

— Hapni dyert!

Zëri ishte i egër, E me gjuhë edhe më të egër.

«Xhandarët», u step Sherifja, si të donte t'i ndalte të trokiturat e forta të zemrës. I ngjiti shkallët dy e nga dy. Kur u dha në derën e kullës, e madhe, e rreptë, me sy që i flakërinin, si të Azemit, Shotë Galica ishte ngritur e shtrënguar ndër armë.

Vetëm Shqipja e vogël flinte, si të mos ndodhte asgjë rreth saj.

— Të mora më qafë, çikë, që më hangërt gjarpni! — tha Sherifja.

— Isha duke pa andërr, — tha Shota. — E ti, loke, mos ki dert për mue. Merre Shqipen dhe shkoni, po të mundeni të kaloni në ndonjë shteg.

«Bukur po di me ta largue të keqen kjo nuse», mendoi Sherifja, ndërsa tha: — Janë mizëri, Shotë.

— Kërkojnë Azemin, — tha Shota.

— Prit pak, nuse, — tha Sherifja e doli me vrap.

Nuk u vonua asnjë çast. Erdhi me një pushkë e disa gjerdanë fishekë.

— Ata kujtojnë se e gjejnë të çarmatosun kullën e Azem Galicës, — tha.

Sherifja e Shota u përqaftuan e zunë vend përbri dritareve të vogla të kullës.

«Kështu paska qenë kismet, — mendoi Shota, — këtu ku filluem pushkën me Sherifen, këtu ta mbarojmë së bashku!»

«Ma baj hallall edhe ti, Azem, ma baj hallall, se nuk munda me të dhanë një mashkull, se nuk munda me ta mbushë kullën me zana të gëzuem fëmijësh, po me krisma e me gjamë pushke.» Shota qëllonte pa pushim Shtinte drejt e në shenjë.

— Nuk duem të mbjellim vdekje, — tha ajo, me zë. — Duem të mbjellim grunë, Sherife, po nuk na lanë. Galica korr grunë. Këta korrin plumba. Kërkojnë vdekjen në arat tona. Nuk do t'u japim çerepare, se duen kokë, E sa ma shpejt gratë ta lanë furkën e drugën, aq ma mirë do të jetë!

— Këta po duen me na farue krejt, — tha Sherifja e skuqur e tëra, kokëjashtë. Shamia i rrëshqiste ndër supe — Dashkan të rrimë duarlidhun, jo, bre Shotë, armë na duhen. Vetën ta lajmë me nder, ndigjon?

— Të ndigjoj, — tha Shota.

Lufta ishte shtrënguar rreth kullës. Sherifja e Shota i kursenin fishekët.

Sherifja vikaste emër për emër burrat e Galicës.

Shqipja e vogël, gjithë frikë, ndiqte me sy herë gjyshen e herë dadën Shotë.

«Oh, thoshte e vogla me vete, nuk e di përse kam kaq frikë! Po gjyshja do të zemërohet me mue e Laramanen nuk do të ma lajë ta prek me dorë. O dada Shotë, gjyshja nuk i do qaramanet e unë nuk due të qaj, po lotët më shkojnë vetë, e dridhem, as unë nuk e di përse po dridhem kaq fort! Gjyshja më ka tregue se baca Azem për mue shqipe mali paska thanë, po unë as një zog i vogël pule nuk jam.»

— Nuk jam fare as një zog pule unë, dada Shotë, — klithi e vogla me sytë tërë lot, gati të vraponte e të fshihej diku.

Shota ia bëri me dorë.

«Mos lëviz, Shqipe!»

— Po ku asht Galica e shkretë, — thiri Sherifja. — Vëllazën, bjerini anmikut. Bashkë me mue asht rrethue Shota. Vdesim, e gjallë nuk biem në dorë të tyne!

— Këndo, Shqipe, këndo bashkë me mue, — tha Shota e filloi këngën:

*Mark Milani e Mark Milica,
Jam Kosova e tanë në plisa...*

Nga dritaret e kullat e Galicës krisën pushkët. Zjarrri i mbuloi armiqtë nga të katër anët.

Shota e Sherifja nuk e ndalën këngën e pushkën, po këtë herë me zemër të lehtë, duke iu përgjigjur thirrjeve që vinin nga të gjitha anët: «Prite, o prite Azem Galicën!»

«Tash edhe të vdes, — tha Sherifja, — nuk më vjen keq».

Nuk luftonin vetëm burrat e Galicës, por edhe gratë e fëmijët. Pleq e të rinj u përleshën me çfarë u ndodhej në dorë: pushkë, sëpata e shata, sfurqe e drunj e deri fëmijët me gurë e shkopinj.

Në çdo rrugë e shteg të shtëpive të Galicës, në çdo oborr, jehonin krismat.

— Po u ngushtohet rrethi, nanë, — tha Shota gjithë gaz, — po u shtrëngohet laku në fyt e po tërhiqen.

— Qe besa, moj çika e nanës, tash do t'i venë mirë thembrat nga majat e do ta nisin vrapin si lepuj.

— Nuk ka për të dalë asnjë i gjallë nga ky qerthull. Jo vetëm Galica, por edhe fshatra të tjera po e pasojnë, — tha Shota.

2

Galica ishte derdhur si rrëmet rreth kullës.

Shota nuk po i bënte ballë kësaj here dëshirës për t'u falur me Galicën. Nuk e dinte përse ndiente një mallëngjim të thellë edhe për Sherifin, që po e përcillte.

— Thashë se të humbi Azemi për shkak tem. E do të më mbetej peng ta lija djalin pa nuse, — tha Sherifja.

— Nuse pa fëmijë, — tha Shota.

— Shuej, çikë, — tha Sherifja, — mos ta ndigjojë kush atë fjalë.

Nuse që nuk do të përkundë djepe as në kullë e as gjëkund tjetër. Se kurrë nuk do t'i përqethet shtati nga zëri i foshnjës kur lind. Se ajo nuk do ta ndiejë kurrë më atë lumturi, për të cilën jeton në çdo kohë çdo grua.

Armiqtë shumë shpejt do ta sulmonin Galicën. E në Sherifja duhej të shpejtonte, të shpejtonte për t'u fshehur nga hakmarrja e egërsuar.

Nuset drenicake e përcillnin Shotën me sy të gapërruar nga çudia e pyesnin me druajtje:

— A kjo asht nusja e Azemit?

— Po, kjo asht Shota e Azemit, — tha bacë Ujkani, që kishte sjellë doriun e tij.

Sherifja e galicasit ia patën mbushur plot hejbet për trimat. Doriu qimekuq turfulloi, kur Shota iu hodh mbi shpinë. Tha ajo:

— Dita e sotme asht ndër ditët ma të bukura të jetës sime! I falemnderit ndihmës e miqësisë së Galicës! Kudo që kemi shkue, na ka dhanë jetë e krahë. Ne kemi ba gjithçka mundemi për t'i ndalë katilat.

— Udha mbarë, bijë! Merr dikë me vete, — tha bacë Ujkani.

— Mos u bani merak për mue, vëllazën, veç ju të jeni të kujdesshëm e të bashkuem.

— Çika ime, — tha Sherifja e zverdhur nga mundimi për të mos lëshuar lot.

— Mirupafshim, vëllazën, — tha Shota, ndërsa shkëputej nga përqafimi i Sherifes e i Shqipes së vogël, që po i thoshte: «Më merr me vete, dada Shotë!»

Gruaja ia mblodhi doriut frerët dhe ai u ngrit në këmbët e prapme e u lëshua përpara si shigjetë. Gërshetat ia merrte era, e ajo kthente kokën herë pas here, si të mos ndahej dot nga vështrimi i Galicës.

I ndiente ende në qafë duart e hajthme të Shqipes së vogël dhe pëshpërimën e saj «Më merr me vete, dada Shotë!».

E ku ta shpinte dada Shotë atë çikë të imët, me flokë të verdhë si qelibari, që trembej në gjumë? Dikur Shota i pati kënduar asaj dhe të birit: «Fli, o i miri i nanës-o!»

Me të vërtetë i pati kënduar ajo djalit të vogël në djep? Kjo i dukej sikur i kishte ndodhur qemoti një nuseje të re, të largët, me emrin Qerime. Kjo kishte ndodhur pesë vjet më parë, si të qenë pesëqind vjet larg, midis asaj nuses së re, që kthehej nga rruga e vdekjes e mbushej me gazin e kapjes së gjirit nga i vogli. «Djali me yll në ballë». Një det gjaku e lotësh të Kosovës e ndante nusen nga djepi, nga kënga, nga jeta e natyrshme e gruas.

Shota ecte mbi kalë.

Nuk ecte, rendte me duhi.

E dinte që nuk kishin fare kohë dhe së shpejti duhej të gatiteshin për një mësymje të re.

Kali trokonte mbi tokën e thatë. Korrik. Trokonte një kalë. Kalorësja që veshur me rroba të thjeshta të komitës. Në një ditë jetonte dhjetë vjet. Çdo dekitë i ka-

lonte bashkë me vuajtjen e dhimbjen e kombit. Shpirtin të mbushur me këngë të lashta e të reja. Po më tepër një këngë djepi dëshironte: «More i miri i nanës-o».

Buzët mbi pushin e faqeve të një njomëzaku. Në vend të këngës lëshonte plumba e mbillte vdekje. Vdekje dushmanit.

Kali trokonte.

Vdekja e kishte emrin Ceroviç. I zi si nata e zezë. Përse Kosova të jetonte midis netve të zeza të Ceroviçeve? Përse të paguante një haraç kaq të rëndë, e copëtuat dhe e bërë troha-troha? Përse?

Një vit më parë ishin përballë tij. Mbillnin fjalë me deputetët e Mitrovicës në parlamentin e Beogradit.

Ceroviçi donte qetësi!

Azemi kërkonte në emër të çetave të Drenicës: të ndalohen menjëherë vrasjet, djegiet e plaçkitjet kundër shqiptarëve. Të ndalohet grabitja e tokave të shqiptarëve dhe ardhja e kolonëve, të ndalohet dëbimi i shqiptarëve jashtë vendit.

Ceroviçi tërbohej. Mezi e mbante veten.

«Kërkesat tuaja kanë një rëndësi kaq të madhe, sa nuk mundem t'ju përgjigjem pa marrë urdhër prej kralit e qeverisë në Beograd».

«Sa fort më asht dashë të përmbahem që të mos ia numëroj në lule të ballit atij qen bir qeni», mendonte Shota.

Bashkë me trokun e nxituar të kalit trokonte përgjigjja flakë për flakë e Azemit.

«Këto janë dëshirat tona. E sa për kryemjen e tyne, nuk presim kujdesin e kralit, mbasi kujdesemi vetë për t'i cue në vend.»

Ceroviçi përdridhej nga halli.

«Krali e nderon një trim si Azem Galicën, por, kur të bëhet mik i tij, do ta çmojë më tepër.»

«Po më ngushtohej zemra, kur shihja fytyrën e zverdhun të Azemit.»

«E njohim mirë bujarinë e kralit, — gjëmonte zëri i Azem Galicës, — Asht e lame me gjak.»

Një erë e lehtë frynte mbi kodrat e Drenicës.

Trokëllima e thundrave të kalit ushtonte larg e copa të vogla dhe vërtitëshin mbrapa.

«Gjanë ma të thjeshtë kërkojmë, — ngulmonte gruaja. — E thjeshtë dhe e pastër si drita e diellit. Na lini të jetojmë në tokën ku bukës i thonë bukë e ujit — ujë. Kjo asht e gdhendun në çdo thep e gur, në çdo dru e kullë. Përse na jeni lëshue si bisha me na e pi gjakun?»

Ç'është nevoja që edhe gratë të bëjnë një jetë të egër si kjo?» — pyeti dikur Ceroviçi.

«Nuk asht egërsia jonë, po egërsia juëj, që nuk na lini me jetue të qeta», — iu përgjigj Shotë Galica.

«Mosbesimi që keni te krali, ka për ta zemëruar atë dhe për ju është më keq.»

«Ceroviçi, — foli Shota me zë të lartë, ndërsa vraponte me kalë, — më asht dashë të përmbaj veten, mos me t'i hedhë trutë në erë. Na asht dashë të përmbahemi e të heshtim, jo vetëm kur shohim trembëdhetë varrë në shtat të burrit, po me qindra varrë në shtatin e kombit. Janë varrë që nuk mbyllen lehtë. Varrë që nuk harrohen ndër shekuj. Nuk e kemi besue e nuk do ta besojmë kurrë kralin. Le të tërbohët sa të dojë. Këtu jemi. Nuk ikim. Burra e gra kemi me luftue. Rroposemi, po nuk dorëzohemi!»

«Drenica, kjo çerdhe komitësh midis vendit tonë, është dhunë për shtetin», — kishte thënë Ceroviçi.

«Gjithmonë ashtu qoftë, Ceroviçi, Vec dijeni se Drenica s'asht midis vendit tuej, po midis Kosovës!» — përsëriti Shota përgjigjen e saj e u shtrëngua pas doriut.

Drenica është në vendin e vet. Lugina e mbushur nga jehona e fjalëve tona! Rrapi mijëvjeçar, ku janë varur armët e trimave, që ka pritur e ka përcjellë kuvende shqipesh.

Shota e ngacmonte doriun, që ishte djersitur tashmë. Eci një copë rrugë thujse pa asnjë mendim. Shkreti. Korrik.

Dikur u ndal në një muranë. Zbriti nga kalë si të donte të falej me të. Gurët ishin zverdhur. Kishin zënë edhe myshk. Shota u gjunjëzua.

«Iku një vit, vëlla Nezir, — tha. — Një e nga një po farohen vëllaznit në lulen e moshës.»

«Nuk pata as kohë me t'i pa çikat, vëlla Nezir», — vazhdoi Shota e mendoj Mihanen e fshehur në Dubofcë me dy kërthinj të njomë. Mendoj Sherifen, që ikte me Shqipen për dore drejt tyre.

«Ec, grue, — tha Shota, — e mos mendo ma». Iu hodh doriut sipër.

«Ik, motër, se edhe vëllanë nuk ke mundë ta shtiesh në dhë. E ke lanë në duer të hueja. Ik, grue, e mos mendo. Jeta paska qenë e mbushun me plagë e çdo ditë, pa u tha të vjetrat, po hapen të reja».

Shota nuk e ktheu asnjëherë kokën nga murana, por e dinte që ajo ishte atje, e heshtur, e vetmuar si vdekja.

«E ti, mortje e zezë, ma e zezë se nata e zezë e Kosovës, po do të na farosh në tokën ku bukës i thonë bukë e ujit — ujë? Qe besa, nuk po arrin dot kurrë, Ceroviç!» — buçiste brenda vetes Shota ndërsa ngjitej në Çiçavicë. Azemi e priste. Prej tij pati mësuar se në këto anë veç zanat kalojnë. «Dikur moti isha më Azemin e plagosun në shpellë për tre muaj rresht, — kujtoi gruaja. — Fliste përçart Azemi, po kurrë nuk rënkonte me za. Iku një pranverë. Në qershor Azemi u mëkamb. Barinj të sillnin në bjeshkë bagëtinë për verim. Azemi zinte vend nën hijen e bredhave e sodiste tufat e bagëtive. Dukej se luftë kurrë nuk ishte ba. Se ata qengja po lodrojnë tash sa mot laradasha. Bukuri të tillë rrallë sodit njeriu i gjallë. E ti, Shotë Galica, nuse për në mal ishe nisë e po të qante zemra për një fëmijë të dashun e të butë si ata qengja.»

Çiçavica bashkohej me qiellin.

«Të duket se mund ta prekësh me dorë veç pak ta lakmosh», mendoj gruaja ndërsa lëshonte doriun e vraponte me një frymë drejt e tek Azemi.

— Mirë se erdhe, Shotë, — tha Azemi. — Duhej të ishe që mbramë këtu.

— Jemi ndalë pak, se na rrethuen, — tha gruaja.

— E nana?

— Qëndruem për krah e Galica bashkë me ne.

— Po fillon daveti i ri, — tha Azemi. — Ulu, Shotë.

— Qenkemi për rrugë, — tha gruaja, kur pa shokët e çetës.

— Jo të gjithë, — tha Azemi.

— Pritni, trima, — tha Shota, që po i mbante akoma hejbet ndër duar. — Galica ju ka dërgue çerepare.

— Po nana, u nis për në Dubocë? — pyeti Azemi.

— Tash do të ketë mbërri, — tha Shota.

— Kisha dashë me e pa një herë, — tha përsëri Azemi.

3

Sherifja e përcolli nusen me sy derisa erdhi duke humbur pas kodrave, përkulur mbi kalë.

Tani që Shota nuk ishte më, galicasit po e vështronin si me çudi Sherifen, që qëndronte përballë kullës së lartë, e thjeshtë dhe e rreptë.

— O miq, edhe unë po largohem, — tha Sherifja, — se, kur të kthehen ushtarët e kralit e të mos na gjejnë, do të hakmerren me kullën e, dhantë zoti, të mos ju damtojnë ju, se fort jeni ngushtue për mue e për jetën e tim biri. E tash që Shota doli gjallë prej këndeje edhe deka po më duket e ambël e nuk do t'ia harroj kurrë Galicës.

— Ç'asht ajo fjalë, fisnike, — tha bacë Ujkani, — Due me të përcjellë vetë. Bahu gati.

— Gati jam, — tha Sherifja.

Mori një bohçe e Shqipen e vogël për dore.

— Ikim, bacë.

— Nisemi, Sherife, — tha Ujkani.

— Të falem nderit. — tha Sherifja e përmalluar e u nda për së gjalli me Galicën.

— Nanë, ku po shkojmë? — pyeti Shoipja. — Po Laramanen?

— Laramania do të qëndrojë në Galicë.

— Nuk do ta shohim ma?

— Do ta shohim, — tha Ujkani. — Edhe Laramanen do t'jua ruejmë si doriun e Azemit.

E donte shumë Laramanen Shqipja e vogël. I zbriste shkallët e kullës gjithë gëzim e u shkante pas Sherifes e Laramanes. Fliste me të. I tregonte që e merrte malli, se donte prej saj një viç të vogël, se do t'ia ruante Shqipja, të mos kishte dert fare. Ajo, kur gjyshja e qortonte, vetëm te Laramania shkante dhe e mbështeste kokën. Laramania e shikonte me sytë e mëdhenj të lëngshëm. Ishte e lumtur Shqipja e vogël, kur ulej përballë Laramanes e shihte Sherifen se si ia milte qumështin.

— Mos u tut, o Shqipe, — tha Ujkani. E vogla u drodh nga dora e rëndë gjithë eshtë e bacës mbi supet e saj të hajthme. — Në Dubofcë asht vend i sigurt.

— Bacë, — tha Sherifja, — po më dhimbset gruni. Nuk asht korrë ende.

— Nuk asht korrë, — tha Ujkani.

— E kam lanë pushkën në kullë, bacë, — tha përsëri Sherifja. — Do ta mbaja edhe unë si Shota, pranë, veç më ka mbetë krejt pa fishekë e rrugës me armë nuk mund të kalojmë.

— Qoftë e bekueme, se ta ka zbardhë faqen, — tha Ujkani.

— Kisha dashë që kulla e re, në Galicë, të priste miq e dashamirë para se të rrafshohet e të digiet përsëri. — tha Sherifja, që e trishtonin kullat e nxira e të tymosura, kullat e shkreta, pa zot. — Galica e tregoi veten si përherë trime e fisnike. Se bukën e tokën duen me na i heqë prej goje.

— Kurrën e kurrës, sa të jetë ieta, — vazhdoi gruaia. — Të falem nderit, bacë! Ti më ke sjellë nuse në kullë të Bejtë Galicës.

— Po, moi bijë. Binin tupanët në kullë. Vlonte kanga e gazmohej vendi se trimat me trimat po lidheshin.

Kulla e Galicës kishte pasur meshkujt të rrallë. Nuk i linte plumbi të bënin shtat. Nuset sillnin jetën, gëzimin, fëmijët. Shumë, shumë fëmijë të shëndetshëm, të fortë — krenaria e nuses, shpresa e nënës dhe e tokës.

Plumbi i sharronte burrat në lulen e moshës. Nuk i linte të thinjeshin e të bëheshin bacalokë. Veç Ujkani ishte thinjur krejt. Ishte tharë ndër rrudha të thella si brazda e gjithëka tek ai ishte e bardhë: plisi, mustaqet, flokët si të kishte dalë nga mulliri. Dikur Bejtë Galica i tregonte Sherifes së re një si përrallë a si të vërtetë për Ujkanët. Kur kishte ndodhur? Moti, sigurisht...

Sherifja ndiqte Ujkanin, që ecte i qetë përbri saj dhe Shqipës së vogël. Kishin hyrë nën hijen e Çiçavicës.

— Natë për natë digjen katunde e rrënohen vatra, — tha Ujkani.

Sherifja dëgjonte.

Shqipja e vogël kishte etje. U ndalën në një burim. Vajza u përkul dhe piu ujë me dorën e vogël, të hollë si të tejdukshme.

E brishtë ishte Shqipja me flokë të butë ngjyrë ari. I vetmi fëmijë i Galicajve. Sherifes diçka i ngjante me Ademin, vëllanë e Azemit, xhaxhanë e vogël të Shqipës.

«Ishte i njomë Ademi, — mendoi Sherifja, — kur patën marrë rrugët së bashku me Shotën edhe Azemin. Kur ishte fëmijë, si Shqipja, edhe Ademi i pati flokët të butë, si mëndafshi, e të çelët. Nuk mbërrini me u burrnue djali», mendoi lokja e i fshiu Shqipës buzët me shami.

— A u lodhe, Shqipe? Do të shkojmë te Rahimja, çikë, — tha Sherifja.

— A përnjimend? — pyeti Shqipja, që e kishte marrë malli për të kushërirën, vërsniken, vajzën e hallë Mihanes.

— Po, moj e vogla e nanës.

— Në Dubofcë nuk guxon kush ta zgjatë krahun, — tha Ujkani.

— U bie hija e Çiçavicës, — tha Sherifja.

«Ndoshta edhe Ujkani ka me rrojtë sa stërgjyshët e vet të lashtë? — mendoi Sherifja. — A thue ka me e mbërrë moshën e Ujkanit të vjetër e i verbët ka me e pa udhën pa u gabue? E i verbët, dikur kangë për Azemin e Shotën ka me këndue? Po Azemi asht ende djalë i njomë. Kisha dashë nana plak me mjekër të bardhë, i lashtë si Ujkani të bahet.»

Shqipja e vogël nuk po pushonte asnjë çast. Pyeste për Laramanen.

«Ç'asht fëmija, — mendoi Sherifja. — Plumbat i harroi, shkretinë e shkrumbin e grunit e të kullave nuk po i sheh, veç Laramania i mungon.

— Po ti mos u ngushto, o Shqipe e vocërr. Laramanen bacë Ujkani në Dubocë ka me jua sjellë, — tha plaku.

4

Ato u gëzuan aq shumë, kur në shtëpinë e tyre atë mëngjes u gdhinë me Sherifen e Shqipen e vogël pranë.

E bija, Mihania, sa nuk fluturonte nga gëzimi.

— Paj, moj nanë, — i tha Sherifes, — si munde të na e gjesh këtë strofull?

— E ç'nuk po mundet të bajë njeriu kur asht në hall. Ujkani e di edhe strofullën e dreqit. Paskam qenë me ditë të bardha, se më pati këputë malli për ty.

Mihania nuk dinte si të gëzohej që paskësh luftuar edhe Sherifja së bashku me Shotën.

— Po ti je trimnesha jonë, moj nanë. Unë do të doja të të ngjaja pak, po nuk mundem, — tha Mihania.

— Dikush, lind çika të bukura, — tha Sherifja, — e dikush i mbron. Kështu asht kjo punë. Veç mos thuej se nuk je trime, se Kosova asht mbushë me trimnesha, derisa anmiku vrit, e në ngri kulla plot fëmijë e djepe. Anmiku zi e tym, ne dasma e çifteli, me kangë me kalue dertin e me fjalë me e zbutë dhimbjen. Jo, çika ime, mos ma thuej atë fjalë. Më trego, si ke jetue, bijë?

— Neziri e ka shitë kalin para se të vritej. Ia kam vu në krah të Rahimes lirat. Vend ma të sigurt nuk gjeta, kështu si jemi, gati të vrapojmë në çdo çast, nga një cep në tjetrin.

Vajza e vogël e kapi krahun për t'u siguruar a ishte

aty e gjithë pasuria e familjes. Mihania ia kishte qepur lirat në një qese, e ajo e mbante me vete.

— Afrohu, Rahime, — tha Sherifja. — Ti më je se litë qysh kur nuk të kam pa e pak e po ma arrin dhe Mihanen, moj mbesë e dashun.

Rahimja e vogël dëgjonte Sherifen dhe shihte Mihanen, me sytë e bukur, me fustanin e errët. Diçka ishte nxirë e nuk po e dinte e vogla përse nuk e vishte kurrë më atë fustan të bukur nëna e saj.

— A ka me ardhë baba Nezir? — pyeti Sherifen. Mihanes iu mbushën sytë.

— Përse nuk del të luesh me Shqipen? — tha.

— Jo, më ka marrë malli për babën Nezir, — nguli këmbë Rahimja, — kur do të vijë përsëri, më thuej, nanloke, kur do të vijë?

— Nuk e di, moj e mira, — tha Sherifja. — Ka ikë larg e ndoshta rrugën nuk po mundet me e gjetë.

— Larg, shumë larg?

— Larg, bijë.

— E nuk do të vijë kurrë ma?

— Kurrë, moj çikë, nuk mundet me u kthye njeriu prej asaj rruge të shkretë, — tha Mihania.

— Fëmijë asht e ka mall, — tha Sherifja.

— Malli nuk na ndahet, — tha Mihania, që përpiqej t'i kapërdinte lotët, — po kur mendoj kushërirën tonë, Sofijen, me çikën e vet e Hajrijen, që iu vranë të gjithë burrat e iu shue krejt fisi, them se njeriu asht i fortë. E duroka shumë, i ngrati.

— Asht ma i fortë se guri, bijë. Se gurin e plas dhimbja, po njeriu duron. Duron se ka shpresë e trimnohet edhe kur nuk asht trim. E po më vjen mirë që jeni gjendun pranë njana-tjetrës. Sofija ka marrë Bainsët, trima të çartun, e njeriu i vleftë njeriut kur asht zi.

— Këto shtëpi të lana shkretë po na bahen fole e strehë, — tha Mihania e menduar. — Ditët e para e kemi pasë vështirë, loke, gra të veja, pa burra, me çika të mituna.

Kaluan disa ditë në Dubocë. Vajzat e vogla nuk i linin të dilnin jashtë. Rrotulloheshin rreth oborrit. Gjenin

lodra. Kërkonin flutura e bubureca nëpër trungje pemësh. Flisnin me zë të ulët, që kurrkush të mos e dinte se ajo shtëpi ishte e banuar, veç Ujkanit dhe njerëzve të besuar. Të zotët e saj ishin mërguar e ajo shtëpi e vetmuar, në rrezë të Çaçavicës, ishte bazë e komitës. Sherifja me të bijën nuk çmalleshin dot me njëra-tjetrën. Krinin e flisnin me orë në dhomën e madhe, aq sa nuk e vunë re kur hyri kushërira Sofije me tabakanë e kafes në dorë.

— Sofije, — tha Sherifja, — qofsh e bardhë, moj çikë, që u kujtove të na kthjellosh!

— Shpesh kemi folë me Mihanen për ty, nanë, — tha Sofija.

Kushërira Sofije ishte e shkurtër, e plotë, në moshën e lulëzimit të gruas, me vetulla të mbërthyera, me sy të blertë e të tërhequr anash. Kur qeshte, gropëçelet i bënin dritë fytyrës së saj të pastër. Kroba i derdhej në trup e llërët e forta e tregonin një grua të patundur e të vendosur. Fytyra dukej gati e habitur, fëmijore, po sytë e duart e saj flisnin më tepër. «Sëpatën — dukej sikur thoshin— sëpatën di ta mbaj e ta përdor mirë!» Sherifes i kishte treguar Mihania që Sofija flinte me sëpatë nën kokë.

— I kam thanë Ujkanit të na sjellë sa më parë armë, — tha Sherifja, ndërsa gjerbte kafën me gllënjka të vogla.

— Kush do të qëllojë me të? — pyeti Mihania.

— Veç t'i kemi, po do t'i varrojmë mu në lule të ballit, — tha Sherifja.

— O nanë, ti të tremb, — tha Mihania.

— Sofija do t'i pikojë, — tha Sherifja.

— Po, besa, — tha e qetë kushërira Sofije.

— Do t'ua bajmë bukur, si Zenel Bainca, — tha Sherifja.

— Nuk mundem të mbaj në shpirt veç fytyrës së tij, — tha Sofija.

Forca të mëdha rrethuan Çaçavicën në pranverë e nuk pati mbetur tjetër mjet shpëtimi për çetën e Azemit, veç të dilte nga pyjet e Kozmaçit. Po Zeneli me shtatë

trima qëndroi në istikamin e Gurit të Gradicës. Armiku sulmonte dhe ata qëllonin e lëshonin kushtrimin «Prite, Azem Galicën!» Qarku i rrethimit ngushtohej. Ushtarët e kralit hidhnin bomba, por edhe Zeneli u përgjigjej me bomba. Armiqtë, të hutuar, i hidhnin pa u hequr siguratat. Trimat e Zenelit i përdornin. Vërenin për qark, dilnin me radhë dhe ua kthenin mbrapsht.

— Zenelit i ka ngritë kangë Ujkani, — tha Sherifja.

— Hajrije, Hajrije, — thirri Sofija, — eja shpejt, çikë!

E bija e Sofijes, Hajrija, e gjatë, e hollë e thyeshme si purteka, me gërsheta të trashë si gjarpërusha mbi supe, erdhi me një frymë.

— Çka ka ba vaki, nanë?

— Mësoje kangën e Uikanit për Baincët, se edhe ti je Baincë, — tha kushërira Sofije.

— Ulu këtu pranë meje, Hajrije. — tha Sherifja. —

Një pëllambë mbi tët amë po ban hije. Ka me ta mësue vetë Ujkani, kur të vijë, kangën e Zenelit, çikë.

Vajza u bë flakë.

— Po më skuqesh si trandafili, moj e mira e nanës, — tha Sherifja, dhe e puthi në faqe. — E ty, Sofije Bainca, Mihania të ka motër, se motër nuk i ka qëllue, veç Shotës.

Vogëlushia Rahime me Shqipen çuçurinin dhe Zoja topolake i ndiqte pas, pengohej e kthehej me lot te Mihania.

— Nanë, o nanë, Rahimja...

— Nuk di veç me u kapë ke fustani i nanës, — i tha Shqipës për të motrën, Rahimja.

— Anë, asht e vocërr. — iu përgjigji Shqipja.

— E vocërr sa një gogël, — ia priti Hajrija, kur e pa që shqeponte duke qarë e duke zgjatur duart nga e ëma. Mihania e shtrëngoi fort në krahë.

Vëllezërit e Shotës ishin ende gjallë. Po Mihania e pati dashur tepër Nezirin. Dyfish ishin të lidhur me Shotën. Lidhje gjaku e zemre.

Edhe Sofija, edhe Sherifja e ndiqnin me ca sy të

ndritshëm dhe mendonin të njëjtën gjë. «Pa i mbushun ende njëzet e pesë vjet, mbeti e ve Mihania.»

Mihania po tregonte për atë natë të mbrapme, kur Neziri u fal me të dhe ajo lutej që t'i jepte edhe një mashkull. Si ta dinte, që kurrë nuk do ta shihte nusen e tij Neziri, i pati thënë: «Çikat e Radishevës nuk bien ma poshtë se burrat e fisit. Ne ishim gjashtë vëllazën, po Shota asht ma në zë.»

— Ka pasë të drejtë Neziri, bijë, Shota turpnon çdo burrë.

Sherifja vërente Sofijen. Sytë e saj kishin marrë flakë. Në ninëzat e zmadhuara dukej ankthi për të bijën, Hajrijen. Gruaja mbloodhi duart, si të kishte të ftohtë. I shtrëngoi fort e ndër llërët e zhveshura i kërcyen damarët, sikur po shtrëngonte sëpatën.

— Në qoftë se të vjen thika në rrasht, në qoftë se të therin aty ku nuk mban, Mihane, atëherë edhe një sëpatë a një copë shtambë bahet plumb, se nderi asht ma i shtrenjtë se jeta.

Vajzat e vogla silleshni rrotull nëpër shtëpi. Nuk guxonin të flisnin me zë të lartë.

— Të jesh edhe një herë fëmijë, — tha kushërira Sofije, po nuk arriti ta mbaronte fjalën, kur u hap porta e oborrit dhe hyri një burrë i pluhurosur me kalë.

— Ujkani! — thirri Sherifja e iu drodh zemra. — Ç'ka ba vaki, burrë i dheut?!

— Galica asht e gjitha në flakë, edhe kulla.

— Ani, kryet shëndoshë, — u përgjigj Sherifja e nuk guxoi ta pyeste Ujkanin për armë, derisa ai vetë ishte i çarmatosur.

— Hajde brenda, bacë!

— Jo, — tha Ujkani, — po ngjitem nalt në Çiçavicë, Ç'ti them Azemit?

— Edhe njëqind kulla i bajmë kurban, — i tha Sherifja.

— Atëherë po të them edhe unë betimin e Drenicës, Sherife: vdesim, po vendin nuk e lëshojmë, nuk e lëshojmë kurrë! Largimi për ne asht vdekje e shkue vdekjes. Këtu na lanë prindër e të parë, e këtu do të jesisim. Kris-

mat e pushkës janë sot kangët e Kosovës, e Kosova asht kthye në një flakadan të madh. Lamtumirë, Sherife! — tha Ujkani e u nis fluturim.

Gratë mbetën në këmbë, me agështi në shpirt. Të heshtura u kthyen në punët e zakonshme. Ishin në ëndërr apo në zhgjëndërr?

Vajzat e vogla me fytyrë serioze. Shqipja e frikësuar në duart e Hajrijes. Hajrija ia lëmonte flokët e diçka i tregonte me zë të ulët, si të desh ta vinte në gjumë.

«Hajrija asht me të vërtetë e bukur. E bukur si zanë mali, — mendoj Sherifja. — E bukura asht tundim. Ka të drejtë Sofija që nuk e heq sëpatën nga vetja. Në shpirtin e Hajrijes kanë lulëzue lulet e Kosovës. Në zarin e saj kanë gurgullue burimet e Kosovës. Gërsheta të zez, trup të gjatë të hollë si borigë. Vajza ecën në majë të gishtave, sikur përkulet e përthyer nga era. Krahë të hollë dhe vështrimin e syve të thellë, të menduem. Këtë çikë nuse për Ademin do ta kisha marrë, po Ademi kalbet në dhé! E ti, Sherife, nuk po mësohesh dot, që një djalë të njomë gjashtëmbëdhjetëvjeçar ta tresë dheu.»

Hajrija diçka u tregonte çikave të vogla: Sherifja ndali këmbët. Zëri i Hajrijes gurgullonte e gurgullonte si burimet ndër gurra. Sherifja u ul pranë tyre.

— Do t'ju tregojë nana për Ujkanët, — tha.

5

Qielli i Kosovës i zi, i tymosur, megjithëse në Galicë binin tupanët, e kulla ishte e stolisur. Burrat shkonin te rrapi i moçëm, e i varnin armët ndër degë. Pastaj zunë të vinin dasmorët nga fshatrat e largëta me dhuratat. Kullat përreth u shndërruan në konakë të miqve dhe dallet e ngritën në këmbë gjithë Galicën. Kuajt e dasmës hingëllinin. Kënga e vashave shpërtheu si lumi pas shi-

rave dhe mbushi ajrin me gëzim. Me buçimën e daulleve u nisën kuajt revan bashkë me kalorësit me petka të dasmës. Zhurma e hareja mbetën prapa, pastaj jehuan rishtas, më të fuqishme se më parë.

«Dasma të kemi, të mos jemi kurrë pa to», folën trimat:

Po kush martohej?

Dasma ishte në kullën e Azem Bejtës.

Sherifja gazmonte. Çikat e vogla gëzonin. Binin dallet e burrat e Drenicës kërcenin në sheshin para kullës. Vallja ishte e rreptë. Kënga e sertë. E Shota po këndonte me sharki. Këndonte për Kosovën, për burrat me varrë në shtat që po i iknin vdekjes dhe për një nuse të bardhë, më të bardhë se bora e bjeshkëve, që po e sillnin krushqit në kullën e Azem Galicës, për Azemin. Pastaj për disa çika të reja që kërcenin valle rreth zjarrit, para vdekjes, që ua dogjën petkat dhëndurëve të dashur, që kishin rënë në luftë e vetë vdiqën të helmuara që të mos i prekte dora e të huajit.

Në krye të rrugës u duk balli i krushqve. Flamuri i arbrit valëvitej e shqipja dukej sikur fluturonte nën një qiell gjaku. Po nusja ishte e bardhë si drita e dukej më e bardhë e më e druajtur në vrapin e kalorësve të djersitur, që u nxirrnin xixa potkonjtë. Shota u ngrit në këmbë dhe e mposhti fërgëllimën e trupit. Çdo gjymtyrë i dridhej. U dha shenjë daullexhinjve që t'u binin me gjithë fuqinë. Dhe ata i ranë. «Po vjen nusja, po vjen», — thirrën dasmorët. Turma e grave e mbështolli saora. Çikat ia shtronin rrugën me lule, oriz e sheqer. Galica martonte Azemin. Nusen e zbritën nga kali. Kalin e bardhë e mbante për freri bacë Ujkani. Nuses i vunë në prehër një djalë pesëvjeçar.

Shotën e mbuluan djersët nga çudia. Ishte djali i saj. Ishte rritur djali dhe i qeshte Shotës, nga prehri i nuses.

«U shtoftë shtëpia juaj me djem dhe u rritshin me prindër», — tha Ujkani.

Në oborr, bashkë me bubullimën e tupanëve, hidhej vallja. Këmbët e valltarëve binin lehtë-lehtë e krijonin vallen e shtruar e të rëndë të shpatave.

Shota i binte sharkisë, Azemi ishte përzier në valle. Shota këndonte. Azemi u shkëput për një çast nga vallja e ia vuri dorën Shotës mbi sup.

«A po qan, a po këndon?» — e pyeti.

«Po këndoj, o burrë i dheut!»

«Po këndon në dasmën time, Shotë!»

«Po këndoj për dasmën e Kosovës. Gruaja për të jep birin, burrin dhe jetën, Azem!»

Gruan e mbërtheu një makth për fyti. Lëshoi shar-kinë e u ngrit në këmbë.

Sherifja i vinte rrotull nuses së re. Shotës i theri në zemër. Shqipja e vogël flokëverdhe zgjati duart drejt saj: «Më merr me vete, dada Shotë!» Shota kërkonte të birin në prehër të nuses. Po prehri i nuses ishte bosh. E nusja qante e këlthiste: «Ku asht djali i Azem Galicës?».

«Ku iku djali?» — pyeti edhe Shota.

Djali kishte hyrë në vallen e burrave. Djali ishte veshur me tirq e plis të bardhë mbi kokë. Shota vrapoi dhe e zuri të birin për dore.

«Nanë! — tha djali. — Nanë!»

Shota ia shtrëngoi dorën fort, po djali humbi.

«Ku iku djali, Azem? Ku iku?» — pyeti Shota.

Ai s'dukej gjëkund.

Burrrat patën ngrirë në valle.

«A po qan, a po këndon, Shotë Galica?»

Shota u zgjua e mbytur në djersë. Nata e korrikut ishte e kthjellët në Çiçavicë. Azemi flinte i qetë pranë saj. Gjumin e bënte të thellë Azemi, me pushkë mbështetur pranë vetes. Shota sa nuk klithi nga gëzimi që kishte qenë në ëndërr. Ajo u përkul e ndjeu frymëmarrjen e burrit dhe një dëshirë e marrë, si tallaz e tundoi. Rrobat i rëndonin në trup. A është burrë, a është grua? Tirqit e shtrëngonin, sikur po ia ndalonin rrjedhën e gjakut. Shota e puthi me zjarr Azemin e ndjeu se ishte skuqur e tëra. Ëndrra i kishte depërtuar në çdo pjesë të shpirtit e të trupit. «A po qan a po këndon, Shotë Galica?»

Shota kishte dashur më tepër se çdo gjë atë çast të

mbante në trup një palë petka të lehta, të qëndisura, si atë ditë të paharruar, kur erdhi pranë saj Azemi e ajo kishte ndier në shpirt bukurinë e qetë që ishte bërë grua vërtet dhe nënë e djalit të Azem Galicës.

«Grue — tha Shota, — mblidh mendjen, se po të fluturon». U rrotullua në shpellë e ndezi zjarrin, me duar të dridhura. Në zjarr vuri kusinë me mish. Kërkoj mjeletin që pati sjellë nga Galica. Gatoi një bukë misri dhe e poqi duke e mbuluar në prush. Kur po e nxirrte bukën nga zjarri, u zgjuan Azemi dhe shokët. Shota nxori bukën dhe e vuri kusinë në mes trimave. Ndau nga një copë bukë dhe nga një lugë druri secilit.

Nuk ishte gdhirë ende. Por ata ishin për rrugë.

Azemi e shikonte me dhimbje fytyrën e Shotës nën dritën e zbehtë të zjarrit. Vetëm ai diktonte, nëpërmjet dritëhijeve, turbullimin e saj. Burri po e vërente në sy me ngulm, po Shota nuk i lëvizte qerpikët, thuase kishte frikë mos ai lexonte ndër ta. Thuase druhej mos e shihte edhe Azemi atë nusen e bukur të ëndrrës, që zbriste gjithë shend nga kali dhe i vinin djalin e tyre në prehër!

Të tjerët s'vinin re asgjë në vështrimin e ngulur përtokë të Shotë Galicës.

— Të lumtë dora, o Shotë, paç e shtrofsh gjithmonë, — i thanë.

— Falemnderit, — u përgjigj Shota. Bëri çudi kur në hyrje u shfaq Ujkani.

Nga lartësitë e Çiçavicës nuk kishin mundur të dallojnë asgjë. Po derisa kishte ardhur Ujkani nëpër natë, laku u ishte shtrënguar në fyt.

— Ka marrë flakë toka, — tha Ujkani. — Nuk ka veç zjarre!

— Do të zbresim menjëherë, — tha Azem Galica.

Ata hynë rrufeshëm midis rreshtave të armikut. Armiku filloi të përdorte mortajat.

Ishte një përpjekje e furishme. Tri a katër herë luftëtarëve të çetës së Azemit u takoi të ndesheshin fytyrë. Shota ishte ngujuar në një kullë tjetër, për të ndihmuar shokët të çanin përpara. Gruaja shtinte pa ndërprerje nga dritarja e këndonte. Shokët ecnin përpara e Azemi pyeste veten: «Kush po m'i vret këta para meje?»

Shota, duke mbrojtur shokët, e harroi veten.

U vonua e mbeti e vetme në rrethim.

Artileria qëllonte pa pushim muret e shtëpisë ku ishte Shota.

Në këtë gjendje, të ecte e vetme pas shokëve, ishte e pamundur. Gruaja vendosi të dilte nga rrethimi në një drejtim tjetër, për në Mitrovicë. E pushoi qitjen e doli në oborr. Ra barkas pranë një gardhi dhe, duke përbiruar nëpër të, kaloi në arën e mbjellë. Gruri kishte filluar të digjej. Gruaja hiqej zvarrë. I dukej se po digjej e gjithë Drenica. Kur po dilte nga ara, në cep të saj u ndodh ballë për ballë me një xhandar.

— Mos luej, se të vrava, — briti Shota. — Po të dorëzohesh, je i falun.

Xhandari, i hutuar, mbeti si i ngrirë nga frika dhe u dorëzua. Shota me nagant në dorë iu afrua dhe, pasi i hoqi pushkën, i mori shulin e ia ktheu prapë.

— Ec përpara, përkrah meje. Kujtdo që do të të pyesë, do t'i përgjigjesh se më ke arrestue.

Shota e xhandari ecnin përbri njëri-tjetrit. Xhandari i çarmatosur, ndërsa Shota gishtin në këmbëzën e nagantit të fshehur. Kështu, derisa doli nga rrethimi, e mori drejt Çiçavicës.

7

Ndoshta qenë ditët më të bukura e më të qeta të jetës së tyre në shtëpinë e vetmuar rrëzë Çiçavicës. Sherifja priste të birin. Gatuante për të. Ia ruante gjellën të

ngrohtë. I bëhej se ai po hynte me vrull në oborrin e shurdhër, duke përmbysur heshtjen e duke sjellë gaz me atë zërin e tij të fortë «A je burrneshë, Sherife Galica?». Kështu e përmbante mallin e dashurinë Azemi, dhe Sherifja gazmohej se ai ishte burrë. Por ajo donte që djali të clirohej sa më parë nga hijsa e rëndë e armëve, ta hiqte pushkën nga supi, ta varte në mur e ajo të ulej pa druajtje, në gjunjë, pranë tij. Se ishte nënë e, si të gjitha nënat e botës, kishte mall. Djali na paskësh ardhur nga rruga dhe kishte mbështetur kryet në vatër.

«Pa hë, Sherife?»

«Malli më ka këput për ty, bir!»

Kishte kohë që nëna ndahej e piquej me Azemin rrëmbimthi, gjithë ankth. Malli për të birin e përvëlonte e ëndrrat nuk e linin të qetë. Ndër to Azemin e shihte veç fëmijë. Azemi ishte në një ngutje të vazhduar. Kjo filloi që atë ditë kur nusja i lutej «më merr me vetel!». Sherifja e ndieua se Shota do të ishte përjetë pranë, syri i saj do ta ruante e nënës iu bë zemra mal. Shota shkante e vinte më shpesh.

Si patën ikur kështu të zotët e kësaj shtëpie e nuk morën asgjë prej saj?

Sherifia nuk donte ta mendonte ku ishin tretur gjindtë e asaj shtëpie. Ajo ishte një shtëpi e bukur, e ndërtuar me gurë të bardhë. Cdo gjë dukej sikur pati mbetur shtangur aty; edhe carcafët e qëndisur të nuseve, edhe enët e bakërta që farfurinin, edhe qilimat e shtrojat. Duket nuset i kishin dashur tepër shqiponjat, se ato nxirrin kokë në cdo skaj, madje edhe në jastëkët e dyshekët. Do të kishin qenë nuse hasiane.

Ajo shtëpi e bukur ishte punuar më nge. Dyert, tavanet, dollapët në ngjyrën natyrore të drurit, ku shpërthenin zambakë. Arkat e nuseve, gdhendur në dru. Edhe shandanët. Vetëm një hall i jashtëzakonshëm mund ta detyronte njeriun të ikte nga sytë këmbët prej asaj botëze të shtrenjtë.

Sherifja nuk donte të mendonte. Por ishte e pamundur të mos i shihte me sytë e mendjes se si iknin gjin-

dtë e asaj shtëpie e nuk merrnin asgjë me vete, veç shpirtit e robet e shtatit, në dhera të largëta, të ftohta si vdekja.

E Sherife Galica ndrydhte mallin për të birin. Çdo lëvizje e Azemit ishte e ngulitur në sytë e nënës. Ndofta Azemi do t'i tregonte si i kishin ndjekur zotërinjtë e ngopur deri në grykë, njerëzit e kësaj shtëpie. Zotërinj që, si vampirët nuk nginjen dot, me gjak njeriu.

Zotërinj të dhjamosur, sa gati nuk u bie pika prej tij, rrethojnë Galicën, djegin kullat. Janë mësuar në të ngrohtë e nuk e dinë si ngrin fëmija nga acari, shkrumbojnë vatra, çika e fëmijë e i detyrojnë gratë ta mbajnë sëpatën nën jastëk, si Sofija.

Sherifja ngrihej menatë. Gjumi i dilte para se të zbardhte agu. Mihania me të bijat flinin. Edhe kushërira Sofije me Hajrijen.

«Flenë, — mendonte nëna, — janë të reja. Lufta nuk ua ka bjerrë gjumin.»

Sherifja përgjonte udhën dhe shihte si çlirohej Çiçavica nga nata e si dilte me druajtje, si çikë e bukur, para syve të saj.

E para ngrihej e bija, Mihania.

— Kaq herët je çue, nanë?

— Gjumi asht për të rinjtë.

Mihania nxirrte ujë nga pusi dhe vështronte Sherifen. «Pret bacën», mendonte. Azemi ishte vëllai i madh. Dikur luanin bashkë. Ajo ka mbetur Mihania e vogël dhe Azemi në tridhjetë vjeç ishte «bacë!»

Litari gërvinte. Kova përplasej nëpër anët e pusit.

— Çka ke, bijë?

— Ky asht pus i thellë. Sa herë nxjerr ujë prej tij, më kapin të dridhunat.

— Përse, bijë?

— E çuditshme asht kushërina Sofije, loke. Para se të vije ti këtu, më thoshte se, në qoftë se sëpata e saj nuk do të na mbrojë dot, ky pus do të jetë mjaft për ne. Ma mirë mbytemi në puset tona, thosh, sesa robina në derë të kralit. Nuk e di përse ka aq frikë Sofija!

— Sofija mendon për Hajrijen. Jeni të reja, çikë!

— Po ne jemi në rrazë të Çiçavicës, e deri këtu asht tepër larg.

— Tepër larg nuk asht. I kam kërkue armë Ujkanit. Ujkani asht ngjitur në Çiçavicë.

— Siç duket nuk ka armë.

Sherifja e kishte frymën pezull. Priste të birin. Po në vend të tij vinin lajmet: «Azemi është vrarë!»

Nënës i ftohej gjithë trupi dhe i dukej se ishte e tëra prej akulli.

— Jo, — thoshte me zë të lartë, — gënjejnë. Jo vetëm Azemin nuk e vrasin dot, po as kalin e tij nuk guxojnë ta prekin.

Çikat e vogla e dëgjonin gjithë çudi.

Shqipja u rrëfente për doriun e bacës, që turfullonte kur ikte me dadën Shotë nga Galica. Doriun e pati ruajtur bacë Ujkani.

— Pa shih, — thoshte Sherifja, — Shqipja e Galicajve po rritet.

— Jo, nanë, unë veç sa një zog pule jam.

E kishin me të vërtetë një pulë me zogj në oborr. Nuk qenë ndarë ende nga kloçka. As të vegjël as të rritur. Zogj të bukur.

— Do ta sjellë Laramanen bacë Ujkani? — pyeste Shqipja.

— Do ta sjellë, — i përgjigjej Sherifja.

— Ju nuk e dini sa e bukur asht Laramania. Si i ka sytë me lot, si të ish njeri.

Pse qan Laramania, gjyshe?

— Për kullën!

— Për kullën?

— Për kullën që digjet nga flakët, — vazhdonte Sherifja. — Veç kalin e Azemit nuk e prekin dot.

— Kurrë, kurrë! — thoshte Rahimja dhe qeshte me Zojën, që vraponte pas zogjve e kloçkës.

— Kurrë, asnjëherë. Mos, se po bie, moj: «Shota e nanës», — thoshte Sherifja dhe e merrte në prehër Zojën. — Po më shgrahesh pas zogjve, si një rosë e vocërr, — i thoshte dhe e puthte në faqet e kuqe topolake. E puthte edhe në duart me vrima. Ende Zoja i kishte

duart të fryra, si të foshnjave dhe gishtërinjtë të vegjël, e vetë si një top i rrumbullakët, që veç qeshte e luante me zogjtë.

— A vërtet i ka krahët e dragoit bacë Azemi? Fluturon ai me krahë nga një kodër në tjetrën? — pyeste Rahimja.

— Fluturon, — thoshte Sherifja.

— Thonë se ka shtatë zemra e ka le me këmishë, — vazhdonte Hajrija.

— Me këmishë nuk ka le, se këtë unë e di ma mirë nga të gjithë. Po trimat i kanë gjithmonë shtatë zemra. Siç kanë pasë Ujkanët e lashtë, — përgjigjej nëna dhe e shikonte disi me mall Hajrijën. Qerpikët e dendur, të gjatë, të errët, i bënë hije mbi mollëza. Fytyra i merrte ngjyrën e pjeshkës së pjekur.

«Krejt si zanë mali, — mendonte Sherifja. — Nuse për tim bir e kisha dashë.»

8

Kështu deri atë mëngjes.

Ishte një mëngjes i bukur. Mihanja e kishte vënë kazanin pa gdhirë e po lante çarçafët. Sherifja po u bënte çikave një pite me petë të holla. Zoja e vogël flinte. Sofija e ndihmonte Sherifen të shtronte petët. Ishte skuqur e tëra nga zjarri e doli në oborr t'u hidhte dy grushte ujë syve.

Hajrija lante vajzat e vogla e qeshte me zë të ulët. Kishte gjithë mëngjesin që po nxirrte ujë nga pusi së bashku me Mihanen. I kishin shpëlarë çarçafët, e ata dukeshin më të bardhë kur i ndenin në gjithë oborrin.

— Deri kur nuk do të mundemi të qeshim e të flasim me za të naltë, nanë? — pyeti Hajrija të ëmën, që po priste ujin te gryka e pusit.

— Derisa bacë Azemi t'i ketë shue këta të mallkuem, — tha Sofija.

Vajzat e vogla u gazmuan.

Hajrija hodhi kovën në pus dhe e ngriti ngadalë, me çikrik.

— Jemi mbledhë këtu gra pa burra e çika pa baballarë, — tha Hajrija, ndërsa i shtinte ujë Sofijes. E ajo e merrte midis grushteve dhe e përplaste mbi fytyrën e djesitur. Hajrija hidhte ujë e mendonte për sëpatën nën jastëkun e së ëmës. Hajrija shikonte ëndrra të ngatërruara me njerëz me koka të prera, me shtëpi që digjen flakë, po nuk ia tregonte asnjëri, as nënës së saj.

— Ç'ke kështu, bijë, — pyeti Sofija. — Nuk je mirë? Hajrija e pa në sy.

— Jam krejt mirë, nanë, — tha.

Mihania kishte mbaruar së nderi garçafët e shikonte me kokën mënjanë çikat e vogla.

— E mbaruat piten? — pyeti Sofijen, që u nis drejt shtëpisë.

— Edhe pak, — tha Sofija. — Po nxitojmë mos na zajë zhegu, se do të na djegë saçi.

— Tash ka me ju sjellë nana edhe përsheshin me qumësht, — u tha Mihania vogëlusheve dhe hyri brenda.

— Ta zgjojmë edhe Zojën? — pyeti Rahimja.

— Le të flejë, se asht e vogël, — tha Hajrija.

— E vogël, si trumcak, — tha Rahimja.

— Mos bani zhurmë, — tha Hajrija.

— Si mos me qenë hiç, — tha Shqipja. — Se ju nuk e dini se si vijnë ata hajna. O, sa frikë pata kur po e shihja dadën Shotë duke luftue e këndue.

— E lumja ti, — tha Hajrija.

— E lumja unë? Jam futë nën jorgan. Jam dridhë si purteka. Ju nuk i dini si bërtasin ata «dorëzohuni, hapni derën! Do t'ju djegim gjallë!»

— Shuej, ti, se vërtet po më hyjnë të dridhunat, — tha Rahimja.

Shqipja e pa Rahimen me ca sy të hapur jashtë mase.

— Mos u tremb, — tha Hajrija. — Këtu jemi në kambë të Çiçavicës, — dhe e afroi vajzën afër vetes, e mbështolli në krahë e ndjeu të rrahurat e zemrës së vo-

gël. — Prit, — i tha e ia lëshoi flokët e butë e të verdhë mbi supet që t'ia krihte.

Në vend të Mihanës erdhi Sofija me përsheshin me qumësht.

— Po pjek byrekun, — tha për Mihanen dhe i dha tasin e lugën e druntjtë Rahimes.

Rahimja e mori në dorë tasin me qumësht të ngrohtë. Sofija vërente enën e gdhendur bukur.

«I zoti i kësaj shtëpie ka qenë mjeshtër i drunit. Kudo të rrethon dora e tij, — mendonte Sofija. — Ai e pati ndërtue shtëpinë aq larg, që të mbrohej nga rreziku. Po rrezikzi kishte qenë, se ai nuk i ishte nda dhe e pati ndjekë edhe aty. A thue janë gjallë ata njerëz në dhena të hueja? A thue, ai mjeshtër, do të mundtë të gdhendte zambakë e zogj në dru? A thue, nuset do të mund të endin e të qëndisin shqipe në këmishë e peshqirë?»

Asnjëra nuk e afronte pranë të keqen. Asnjëra nuk e dinte që armiqtë po i kërkojnë si shpërblim të humbjeve të tyre. Se duan të godasin Azemin në zemër. T'i shuajnë farefis. Të mos i mbetet njeri i gjallë. T'u dërrmojnë zemrën e pastaj trupin atij dhe të gjithë luftëtarëve.

Hajrija ia kreu flokët e butë si mëndafshi Shqipes e ia lidhi me një kordon të kuq. E kuqja po dukej më e kuqe në flokët e Shqipes.

— Shumë bukur, — tha Rahimja dhe përplasi shuplakat. — Shumë bukur! A ka edhe për mue?

Ato nuk e dinin se ishin të rrethuara, se dera do të shkallmohej me kërcëllimë. E dita, ajo ditë e bardhë si qumështi, do të nxihej e do të errësohej.

9

Sherifja doli e para në oborr me duart ende me brumë. Xhandarët ishin sulur mbi fëmijët.

— Pritni pak, bre burra, — tha Sherifja e u përpoq t'i

nxirrte vajzat nga duart e tyre. Rahimja kishte mbetur si zog i truar, e habitur; përsheshi ishte derdhur e kupa me luginë e drunjtë ishin përmbysur. Shqipes po i mbusheshin sytë me lot dhe Hajrija kishte mbetur e shtangur, e tendosur e tëra, gati të vraponte e të hidhej në pus.

Sherifja iu afrua kovës me ujë dhe lau duart me një fije shpresë që të vonohet e Mihania me Sofijen të kishin kohë. Xhandarët ia përmbysën kovën Sherifes dhe u sulën brenda me sy të çakërditur, të etur për gjak. Për një çast i nxorën Mihanen me Zojën e vogël në krahe dhe Sofijen, që po e ndiqte një xhandar i gërvishtur e i gjakosur, i cili ia kishte marrë sëpatën nga duart. Çarçafët e bardhë i pengonin dhe xhandarët i shkulën e i hodhën përtokë. Xhandari i binte Mihanës pa mëshirë, që ta lëshonte Zojën nga krahu, po ajo e mbante të shtrënguar fort. «Plumbi e deka njëqind herë ma të ambël» — tha Sofija, që ishte qetësuar tashmë.

Xhandari ia rrëmbeu më në fund nga duart Zojën Mihanës dhe e flaku përtokë.

E vogla klithi e lebetitur.

— Hajdeni, more burracakë, — tha Sherifja, — bukur po shitni trimni me plaka e foshnja! — I theri në zemër për Zojën, që ishte ende e përgjumur e nuk kuptonte gjë prej gjëje veç shkonte duke u kalamendur drejt Mihanës e iu ngjit pas fustanit duke qarë.

Gjithçka ndodhi aq papritur e befasisht, saqë gratë nuk patën kohë as të mendonin.

I nxorën jashtë oborrit duke i shtyrë me kondakë. I rrahën egërsisht. I lidhën njëra pas tjetrës. E megjithatë Sofija përsëriste me vete: «Vdekja — kapak florini!»

Në ballë të rreshtit ecte Sherifja. Majat e bajonave u qëndronin përbri. Mihania ia shtrëngoi dorën e vogël Rahimes, që po qante pa zë. «Shuej, çikë», i tha, po e vogla qante nga gjaku që i rridhte Mihanës prej dorës e mendonte: si pulë e therur, pulë e therur. Rahimja kishte frikë kur thernin pula, fshihej kur shihte shkulet e gjakut. Kurse tani gjaku nuk i pushonte Mihanës nga krahu, që ia kishin prerë tejpertej me bajo-

netë. Mihania e njohu menjëherë hafijen që kishte sjellë xhandarët deri tek ato. Dikur rrinin fare pranë shtëpisë së Vuko Stankoviqit. Neziri thoshte që edhe gruen e shet për pare ky Vukoja, buall, më tepër i gjanë, sesa i gjatë.»

Mihania po çuditej me veten. Nuk kishte frikë, megjithëse i shtynin me bajonetë, i rrihnin me kondakë pushke, u bëytinin:

— Ku janë komitët tuaj? Ku fshihen? Tregoni!

Ahishta ku po i futnin, ishte e heshtur. Gratë u lëkundën, po nuk ranë nga goditjet. Mbaheshin te njëra-tjetra.

Sherifja u përsëriste: «se deka me nder e faqe të bardhë asht dasmë.»

Po zemra i pikonte gjak Sherifes për Zojën, që herë pas here binte e nuk e ndiqte dot nënën e saj, për gjakun e së bijës, që nuk pushonte.

— More burracakë. — tha Sherifja. — po me foshnjat kapeni, o të mallkuem?

— Me të gjithë, moj shtrigë, — thirri Vukoja dhe e qëlloi. — Trego, plakë, ku e ke Azemin?

Shqipja iu vërsul Vukos me thonj, por ai ia përdro dhi dorën e njomë. Dora iu var, po, për çudi, Shqipja qante me sy të zmadhuar, fare pa zë, pa britma. Atëherë Vukoja u tërbua krejt. I gjakosi. I bëri me plagë gra e fëmijë.

«Fol edhe ti, moj motër e Azem Galicës», — i ulërinte Mihanes.

«Oh, mendoj Mihania, kurrë s'kam qenë trime. Po nuk kam ma frikë. Nuk do të kisha nxjerrë dot një fjalë të vetme e për çudi nuk paskam ma frikë.»

Rruga kishte mbaruar në ahishtë. Pylli ishte i heshur. Vetëm lart, shumë lart, dukej një copë qiell. Ahët dukej sikur ushtonin e përcillnin zërat e xhandarëve.

— Shtini, të mallkuem, e mos shitni trimni se jeni duke vra foshnja e gra të lidhuna, — tha Mihania, duke mbledhur të gjitha forcat, se po i errësoheshin sytë e po e lëshonin gjunjët.

— Bijë e nanës, — tha Sherifja! — Deshe të ishte trime. Trime je. Motër e nuse trimi.

Xhandarët e Vukos po e copëtonin. Mihanen me kon-dakë.

Rridhte gjaku përtokë pa pushim. Bari u skuq nga gjaku i Mihanës.

Sherifja, krejt e mpirë, e shtrëngonte veten të mos je-pej. Sofija ishte e qetë. Ishte krejt e qetë dhe pa fjalë. «Se ka edhe ma keq, mendonte Sofija. Deka asht një-qind herë ma e mirë se humbja e nderit.» E kishin lidhur së bashku me të bijën. Hajrija dridhej lehtë pranë saj, po Sofija i jepte zemër: «Dekën për këtë vend e kemi borxh!»

Hajrija dridhej si purteka, ndërsa shihte Mihanen që po binte. Ishte nuse e re, e lartë Mihanania, e u këput përdhe si një pemë që e sharrojnë në rrënjë. Zoja, e lidhur pas fustanit të saj, u përpëliti, veç një çast, aq sa ç'përpëlitet një zog, e mbaroi menjëherë.

Rahimja e vogël u shkëput prej tyre dhe vrapoi të shpëtonte nga llahtari.

Vukoja e rrëmbëu nga krahu e deshë ta hidhte pranë Mihanës, por i ndeshi dora në qesen me lirat dhe e mbaj-ti pranë e nuk e lëshoi.

Dukej sikur ahishta dridhej e rrëqethej për një çast nga të shtënat që jehonin nëpër të me gjëmë, e pastaj bi-nte në qetësi. Rahimja ishte e tmerruar e nuk e kuptonte tamam se ç'po ndodhte. Veç nuk donte që nëna me Zo-jën të qëndronte ashtu pa lëvizur mbi bar. Rahimes i shtrëngohej zemra për motrën e vogël si një lule e skuqur nga gjaku. Motra e vogël, si të mos donte të ndahej prej fustanit të Mihanës, dukej sikur flinte.

«A thue flenë vërtet? — mendonte Rahimja.

Xhandarët vazhdonin punën e tyre.

Vukoja, as i gjallë e as i vdekur, e tërhoqi Rahimen, i rrëmbeu qesen me lira nga krahu dhe e shtyu në the-llësi të pyllit.

Rahimja ikte duke qarë.

Zërat e ndiqnin pas.

Zërat i vinin të shumëfishuar nga të gjitha anët e

pyllit. Vajza e vogël nuk kishte më forcë të largohej e u fsheh nëpër shkurre.

Po zërat ushtonin.

«Të mallkuem! Ju po vritni fëmijë dhe plaka, se nuk mateni dot me trimat», — thoshte Sherifja me zë të thekshëm, kur vuri re Vukon tek kthehej nga pylli.

«E ka vra Rahimen e i ka marrë lirat», mendoi. Vuko Stankoviçi u drejtua si i tërbuar te Sherifja, nga frika mos fliste për lirat e vajzës dhe xhandarët do t'i kërkonin pjesën.

— As tash, moj shtrigë e keqe, nuk po bindesh se si po e shfaros Kosovën, yt bir, Azem Galica? Ai vret dhe ne vrasim, — thirri Vukoja, që tundej si derr i majmë, i skuqur i tëri.

— Hajdut, — tha Sherifja. — Faqja e zezë mbetet mbi ju. Ne kurrë nuk vrasim fëmijë e gra. Ne kurrë nuk i kemi nga gratë tueja, o të mallkuem, megjithëse në tokën tonë kanë ra e me bukë e kripë i kemi pritë, e ti, more i pabesë, tash gjakun po na e kërkon borxh. E tash, çka prisni? Mos doni t'ju lutemi? Të shkyejmë teshat, të nxjerrim flokët e të qajmë? Nuk e mallkon nana Azemin, as shokët, as nusen e tij. Hallall qumështin! E nuk jam pishman që po vdes, veç po më mbetet peng se nuk pata edhe Azemë të tjerë, — tha Sherifja.

— Jo, — briti edhe Sofija, me zë të ngjirur, ndërsa shtrëngonte të bijën për krahu fort, që të mos i rrëzohej. — Nuk do të qajmë, Sherife. Do të këndojmë si Zenel Bainca. Do të këndojmë kangën e Zenelit, Sherife...

*Ai Zeneli n'kamb u çue,
Vet'i shtati ish qëllue,
Naçallniku ngat iu afrue.
Të plaçin sytë, ku je tuj shkue,
As n'kët mal nuk don me m'lan mue.*

Zëri i Sofijes ushtonte e kthehej nëpër ahishtë.

— Zenel Bainca — thirri Vukoja. — Ju jeni të Zenel Bincës, — e sytë iu skuqën prej gjakut që i buisi ndër ta.

— Po, — tha Sofia, — Jemi Baincë, e do të vdesim si Zeneli. Nuk do të qajmë.

Pastaj erdhën krismat në pyll deri te Rahimja. E u bë qetësi. «Nuk do të qajmë. Nuk do të qajmë!» dukej sikur ushtonte herë pas here pylli. Veç Rahimja e vogël qante. Qante e dridhej e tëra. Nuk guxonte as të lëvizte kokën. Lotët e pengonin të shihte qartë, por ajo e dallonte fare mirë Sherifen, si pehatej e lëkundej nga breshëria e plumbave. Mbi trupin e saj u rrëzuan flokët e verdhë të Shqipes me kordonin e kuq si gjaku, e kordoni u bë më i kuq se gjaku i Shqipes.

Kushërira Sofije me Hajrijen u këputën menjëherë e nuk u ngritën...

Rahimja dridhej e tëra. Dridhej, vetëm dridhej, megjithëse ishte korrik. Nuk e kuptonte ç'donin t'u bënin tjetër Vukoja me xhandarët atyre që ishin shtrirë në bar, kur asnjëra nuk lëvizte më.

Po ku mund ta dinte një fëmijë se edhe të vdekura do t'i mundonin duke i copëtuar me bajonetë e sakicë. si të marrë mendsh? Jo, kurrë nuk mund të dinte një vajzë e vogël, se armiku ishte më i egër e më i tërbuar se ujku. Se kënaqej duke copëtuar duart e foshnjave e grave, se ai qeshte, kur e bënte këtë punë të zezë.

Rahimja, e struktur ndër shkurre, nuk lëvizte fare.

Nuk do të luanin më as me motrën, as me Shqipen.

Pylli ishte i heshtur. Thuase asgjë nuk kishte ndodhur.

Rahimja rrinte e fshehur, e tmerruar, e uritur dhe nuk besonte që ata të mallkuar po iknin.

10

Dhe për një hop heshtja u bë e mundimshme. Ishte vetëm, krejt vetëm Rahimja. U ngrit e çjerrë, si e dehur, duke u mbajtur mbi atë grumbull të vrarësh. U soll e u përsoll rreth tyre. Thirri motrën, nënën, gjy-

shen, Sofijen e Hajrijen. I thirri e i thirri: zëri i dobët përcillej nëpër pyll. Shkonte e vinte nëpër të. «Nanë! O nanë!» Ahishta ishte e shurdhër. E dëta po ikte. Vajza dridhej nga frika. Nuk dinte nga të shkonte. U kujtua se Mihanës i rridhte gjaku nëpër rrugë. Që nga shtëpia i ishte hapur plaga e Rahimja e shkonte si pikonte gjaku. Rahimja nuk e kuptoi se si u nis nëpër gjurmë të gjakut të Mihanës. Edhe e vdekur iu bë dritë nëna e shkretë.

Rahimja ikte. Në fillim me kujdes, pastaj veç vraponte. Vrapoi deri afër shtëpisë, rrëzë Çiçavicës.

Ajo e dinte që ia kishin përmbysur tasin me qumësht te pusi. Po ç'bëhet atje? Ç'bëhet atje? pyeste veten Rahimja. Përse ia bëjnë me shenjë ato vajza lart në pemë? Përse ia bëjnë me dorë të mos shkojë asaj rruge?!

Rahimja ishte e hutuar. Lotët nuk i pushonin. Uria po e gërryente, nuk kuptonte asgjë. Vetëm kur ishte fare pranë shtëpisë, një xhandar i tha: «Aty është djegur Azem Galica!»

Aq tepër u drodh Rahimja, sa nuk iu largua dot xhandarit, që e rrëmbeu dhe e hodhi në zjarr.

Rahimja u ngrit e tmerruar. Vetëm duart iu dogjiën. Pëllëmbët i ishin rrjepur nga zjarri. Vajza nuk e dinte nga i erdhi ajo forcë për të ikur nga sytë këmbët.

Vonë e kuptoi përse ia bënin me dorë vajzat e vogla lart nga pema.

«Mos shko asaj udhe!»

Rahimja ikte. Ikte larg nga shtëpia, që digjej flakë. Duart i përvëlonin. Nuk mund të shkonte më tej. Ishte futur në një fshat të shkretë pa njerëz. Rahimen po e kaplonte frika. Filloi të qante me të madhe. Thërriste e bërtiste si në një shkretëtirë. «O nana ime, ku je?» Megjithëse i kishte parë të gjitha me sytë e saj, prapëseprapë nuk e kuptonte dot Rahimja se nëna nuk e dëgjonte dhe nuk do ta ndihmonte, siç kishte bërë përherë.

Vetëm kur zëri i ishte ngjirur krejt, doli një plakë e moçme nga një shtëpi dhe i foli:

«Hajde te nana, çikë!»

Ajo plakë nuk ngjante fare me Sherifen. Ishte tepër e moçme, me fytyrë si pergamenë.

Rahimja qante me të madhe. Nuk mund t'i duronte më dhimbjen e duarve të rrjepura, urinë dhe atë dhimbjen tjetër, që nëna nuk i përgjigjej kur e thërriste.

— Ç'të kanë duert? — pyeti plaka.

— Jam djegë, — tha Rahimja e i tregoi përmes dënesave ç'kishte ndodhur atë ditë.

— Të ka marrë uria?

— Më ka marrë, sa nuk po duroj dot, — tha Rahimja.

Hynë në shtëpi. Plaka i lidhi duart e i dha të hante. Vajza deshi ta mbante bukën me duart e lidhura, por ato i dhimbnin fort. Por i dhimbte edhe më shumë zemra. Nuk e dinte a do të mundej nëna e gjyshja të ngriheshin edhe një herë. A do të munden ta marrin rrokaqafe dhe t'i tregonin atë përrallën e moçme, që edhe kur e prisnin armiqtë trimin, troha-troha, ai ngrihej e luftonte përsëri.

— Ma kanë pre nanën, gjyshen e motrën, copa-copa, — filloi të qante përsëri Rahimja, — hajde të shkojmë te nana. A thue po fle nana? A thue do të ngrihet?

— Ikim, çikë, ikim, — tha plaka dhe mori një torbë me bukë. E pa ikur larg, ia behën xhandarët e kralit.

— Ikim, çikë, se këta janë trenue krejt e po na djegin bashkë me shtëpinë.

U err. Shtëpitë e fshatit u dogjën njëra pas tjetrës. Rahimja ishte tulatur në gjoksin e rrasët të plakës. Qielli dukej i përflakur, si të që ditë.

— Tash ka me ua tregue vendin Azemi, mos ki dert, tha plaka, ndërsa shtrëngonte në krahë Rahimen, që dëneste herë pas here.

— A i sheh baca çka po bajnë?

— Azemi i sheh të gjitha.

— Oh, nanëloke, përse nuk bante zë kur po i kullonte gjaku nanës sime?

— Ka me i pa përmidis flakëve, çika ime. Këto flakë ndriçojnë tash natën e Kosovës e duken deri në majën e Cicavicës. E veç kur t'ia behë Ujkani me kalë si shqipe mali!

— Bacë Ujkani e ka sjellë gjyshen te në.

— Bacë Ujkani do të vijë edhe këtu. Ai vjen përherë këtu. E unë nuk largohem kurrë pa ardhë Ujkani. Fli, bija ime, Ja, te ky mullar me bar nuk na gjen njeri veç Ujkanit e Ujkani do të të çojë tek Azemi e dada Shotë. Fli, e mira ime, — tha plaka e filloi të mërmëristë:

*Hasmi don me na farue,
Me na i mbytë fëmit në djep,
Me na i varë trimat në plep.
Na ndrron gjuhë e na ndrron zakon,
Na i çon djemtë në hapsanë...*

Kënga ishte si një thatësirë e shkretim.

Rahimja ishte e lodhur dhe e këputi gjumi. Gjithë natën fjeti e strukur në gjoksin e lokes plakë.

Vetëm kur u zbardh e dielli filloi të ndriçonte, Rahimja hapi sytë. Nuk po e kuptonte ku ishte. Kush e pati sjellë këtu. Ajo prekte plakën, rrobat, trupin. Mos kishte parë vetëm një ëndërr të llahtarshme? Po nëna, ç'bënte atje? Ç'bënin atje, të gjithë mbi barin e skuqur nga gjaku?

U zgjua edhe lokja e plakur shumë. E shikonte vajzën me sytë e vegjël, si të shuar, dhe ia lëmonte flokët me dorën e ashpër. E dinte lokja përse shikonte ashtu si zog i truar e vogla. E dinte së do të kërkonte motrën, nënën, Sherifen.

— A të dhembin duert, bijë?

Lokja e pati njohur Nezir Radishevën e hedhur e të zjarrtë. Edhe nusen e tij të bukur Mihanen, edhe Sherifen. Sherifja mund të ishte bija e saj. Lokja ishte mpirë në vite të largëta. E vdekja e pati harruar. E pati harruar, që të shihte ç'po sheh. Truallin të shkretuar nga flakët. S'kishte më flakë, vetëm shkumb e hi. Kishte mbetur tek-tuk ndonjë tra i madh, i padjegur deri në fund.

Ujkani ishte i tëri i pluhurosur.

Rahimja mbahej fort pas tij. Kali turfollonte e linte pas dhimbje e derte, shkrumb e flakë.

Ujkani kishte një peng të madh që nuk arriti me kohë me armë te Sherifja.

Pushkët i vareshin dhe e pengonin të ecte me revan. Dhe ai kishte një duf të çmendur.

Ky mëngjes do t'i binte në ballë Azemit.

Ujkani nuk deshë ta shpinte lajmin në Çiçavicë. Po nuk kishte njeri tjetër veç tij që ta tregonte këtë të vërtetë. Ai kishte vrapuar me vajzën e vogël, deri në pyll. Kishin hapur varre. Ujkani kishte varrosur në jetën e tij shumë njerëz. Po nuk e kishte pasur kurrë në shpirt atë makth dhe urrejtje. Ujkani ishte burrë i vjetër. Gruaja kishte qenë e shenjtë për të. Gruan nuk e kishte vrarë e aq më tepër masakruar shqiptari. Ujkani varrosi në pyllin me ahishtë katër gra e dy foshnja të njoma.

Ai mbante me vete një fëmijë, që kishte jetuar brenda një dite sa për një shekull.

Një fëmijë, në sytë e së cilës ishte luajtur një tragjedi e përgjakshme. Ai fëmijë nuk do ta harronte kurrë ç'kishte përjetuar, e do të përcillte ndër breza gjëmën e Kosovës.

Gruaja nuk po e mblidhte dot veten. Nuk ishte hera e parë që brenda një dite shkatërrohej gjithçka. Gjithçka mund të pëmbysej brenda një çasti, jeta e një njeriu, e një familjeje apo e një fisi. Kjo ishte moti e njohur. Shota nuk e fshihte dot, nga vetja të paktën, që po dridhej e tëra. Nga të tjerët tashmë duhej t'i fshihte ndjenjat e mendimet, sepse në sytë e saj shihte Azemi. Burri

vërtet është shumë i fortë e trim, po do të bëhej më i fortë e më trim, në qoftë se sytë e gruas nuk përcillnin dëshpërimin.

Nuk mund ta fshihte Shotë Galica se qenka e vështirë të jetosh kështu, krejtësisht për të tjerët dhe aspak për vete.

Azemi e çeta e kishin dëgjuar Ujkanin, pa marrë frymë, krejt si të ngrirë.

Shota e shtrëngonte Rahimen në krahë e dëgjonte fërgëllimën e trupit të saj të hajthëm, të njomë, dhe mendonte se kishin parë shumë, e megjithatë kjo ishte e tepërt. Të vrasësh gra e fëmijë, të masakrosh foshnja e nuse të reja, kjo do të thotë të bësh luftën e ulët të frikacakut.

Balli i Azemit, i akullt, i ftohtë, nën dritën e hënës në lartësi të Çiçavicës.

Çiçavica, si një kullë e lartë, shpon qiellin e fsheh nëpër honet e saj kujet e gjëmën, që të mos ligështojë zemrat e burrave.

Ujkani me duart e veta kishte varrosur gra e foshnja. Gjashtë me radhë. Tani e shikonte me çudi Rahimen, që e shpëtoi lakmia e Vuko Stankoviçit. Rahime Radisheva do të ishte varri i shtatë.

Ujkani me pak fjalë kishte thënë: «Ne gruen nuk e vrasim».

Kishte vërtet një kanun të shkruar, që gjaku në e gruas e çmonte më pak se të burrit, po kishte edhe një kanun të zemrës, që nënën, zonjën — mëmë të të parëve, e çmonte sa jetën.

Azemi vetëm heshtte. Ishte heshtja për gjashtë varre, më e rëndë se vetë vdekja. Brenda saj ndrydhej urrejtja. Urrejtja dendësohej në shpirt, si një natë e errët dhe e ftohtë dimri.

Shkreti e dimër në korrik. Shota nuk donte që acari të ngrinte zemrën e Azemit. Veç gruaja e dinte. Zemra është zemër. Edhe prej stralli po të jetë, me të nuk mund të luash e të tallesh. Jo, nuk mund të luash kurrësi.

Shota e dinte se nën heshtje burrat ndrydhnin urrejtjen. Mjerë kush nuk e di si fshihet nën heshtje urrejtja

e dhimbja. Mjerë kush nuk e di si shpërthen ajo, sapo që çlirohet prej saj.

Azemi u tha:

«Nesër jemi për rrugë, burra, e tash duhet të flemë».

Ujkani u ngrit ngadalë.

Burrat e çetës e ndiqnin Ujkanin me sy. E dinin që Ujkanët kanë një përrallë a një legjendë të hershme. E dinin se Ujkani ka luftuar dikur krah Sulë Vokshit, Mic Sokolit, krah Sefë Koshares.

Ishte plak i lashtë tashmë Ujkani, dhe, kur u ngrit në këmbë, i gjatë, si plep, i papërkulur, i drejtë e krejt i zbardhur, u ngritën edhe Azemi dhe shokët e çetës.

«Betohemi burra, — u tha Ujkani, — japim besën e burrave», (dhe zëri i dridhej pak e duart gjithashtu, se nuse e pati sjellë Sherifen në kullë dhe emrin të katër djemve të Bejtë Galicës ua pati vënë e nga të katër gjallonte vetëm Azemi.) «Japim besën e burrave, gjëmoi zëri i çetës, dhe jetën e familjeve e të fëmijëve, po kurrrë nuk e pushojmë luftën derisa Kosovën ta shpëtojmë. Gjak për gjak! Vdekje për vdekje!»

Çiçavica i përcillte fjalët «Gjak për gjak! Vdekje për vdekje!» Nata ishte e qetë, e kulluar si loti. Qielli plot yje. Burrat u mbuluan me zhguna dhe përsëri ra heshtja. Shota me Azemin ishin krejt pranë e në mes tyre Shota vuri Rahimen. E mbështolli vajzën dhe e la midis. Azemi zgjati dorën e për një kohë të gjatë nuk e lëvizi nga flokët e së mbesës.

— Do ta përcjellim me Ujkanin në një vend të sigurt, — tha.

Gruaja heshti. Ajo kishte humbur vëllezër e baba. Kishte parë shtëpinë e saj të shkrumbuar. Nuk kishte asnjë lajm nga nëna. E dinte që fshihej diku nëpër Drenicë, por Azemit tani nuk i kishte mbetur më asnjeri përveç Rahimes, që prapëseprapë ishte bijë e vëllait të Shotës. Nezir Radishevës. As nënë, as motër, as vëllezër, as nipa e mbesa. Të gjithë të shkretuar. Shok e familje ishte çeta. Vatër — malet e Kosovës, Nënë-Shqipëria!

Shota vërente fytyrën e Azemit. E tundonte dëshira ta shtrëngonte fort në krahët e saj, sepse kishte një ën-

dërr që të ishte nuse, që kullën e Azemit ta mbushte me fëmijë, me gëzim, me dasma.

Shota u drodh kur iu kujtua dasma. Dasma dhe nusja që shikonte thuaj çdo natë në ëndërr. Ajo dasmë u bë ëndërr e përhershme. Shota kishte frikë të flinte, se do t'i vinte nusja me djalin, se do të fillonte kënga, se do të ngrihej Azemi në valle e do ta pyeste:

«A po qan, a po këndon, Shotë Galica?»

Azemi e mbante ende dorën në flokët e Rahimes.

Rahimja flinte krejt e qetë.

Në fytyrën e zbehtë të Azemit herë pas here ngjitej gjaku, me vrull, i përflakur, e ia digjte faqet prej hidhërimit. Tëmthat i rrihnin fort e për herë të parë Shota pa lot në sytë e tij, që i kapërdinte bashkë me dhimbjen e shkretinë e shpirtit.

Ajo donte të klithte: «Azem, zemër, jeta ime!» Po nuk lëvizte, si të qe e mpirë.

Azemi u kthye në krah. Bërrylin e mbështeti në njërin gju e faqen në shuplakë të dorës. Nga lëvizja e lehtë e shpatullave e nga qafa krejt e ngrirë, e palëvizur, Shota e mori me mend, se nuk donte ta shihte që po qante.

Më e mprehtë se çdo herë tjetër, si një ulërimë që shkulej nga thellësitë e shpirtit të saj, i erdhi britma:

«Azemi do të mbetet trung i thatë. Azemi çdo ditë shkon drejt vdekjes e çdo ditë mund të vdesë, po prej gjakut të tij kurrkush nuk do të marrë gjak». Kulla ishte djegur e djepi ishte përmbysur. Fis i shuar. Derë e mbyllur me ferrë, ku veç qyqja kuket. Askush nuk do të thoshte dikur: Ky është biri, nipi e stërnipi i Azem Galicës.

Atëherë, Shotë Galica e pa dasmën për herë të parë zgjuar, në çdo detaj të saj, me një qartësi të çuditshme. Ajo po shikonte me sy të hapur pa mëshirë gjithëcka.

Dasmorët ishin të gëzuar. Qielli i Kosovës krejt i pastër. Mullarët e barit shtriheshin qetë mbi fushën e paanë të gjelbër, të veshur nga mjegulla e kaltër. Midis këngës e dasmës flamuri valëvitej e valëvitej me shqiponjën që printe krushqit në ballë. Flamuri ishte i kuq si

gjaku i Sherifes, i Mihanës e i Shqipës. E nusja krejt e shtangur midis krushqve...

Nuse e bardhë, si drita, që turma e grave e mbësh-tjell përqark. Çikat ia shtrojnë rrugën me lule dhe e zbresin nga kali. Kalin e bardhë e mban prej freri Ujkani.

Ëndrra vazhdonte. Nuses i vunë në prehër një djalë pesëvjeçar.

Ai ishte djali i tyre. Ishte rritur djali dhe i qeshte Shotës nga prehri i nuses.

«U shtoftë shtëpia juëj me djem dhe u rritshin me prindër», — thoshte Ujkani, e ngulte bajrakun.

Shotës i vinte të ngrihej, se nuk e mbante dot klith-mën e dyzimit të vetes. Po për një çast, për çudi, me një krismë të jashtëzakonshme, ajo ishte ndarë tashmë plotësisht në Shotën-nuse të bardhë e të brishtë, dhe në Shotë Galicën.

«Dhimbjen e lindjes e kam provue, — tha Shotë Galica, — asht ma e fortë se dhimbja e plumbit, po e kisha durue dymbëdhjetë herë me radhë, si Bajtije Seferi, E ti, nuse, që po të fërgëllon shpirti e trupi për Azemin, asnjë fëmijë kurrë nuk mund t'i japësh.»

Shota nuk duroi më. U kthye me kujdes nga Azemi. Tani shihte vetëm plisin e tij. Pak i mënjanuar plisi. Dora e ngrirë. Dhe ai krejt i ngujuar, si shtatore.

«Plisi i burrave të Kosovës e ka marrë emnin nga toka. I bardhë asht, si bora e bjeshkëve. Plisi mban emën toke.»

Ajo ishte një natë e gjatë dhe e kthjellët. Shumë yje lodronin mbi Çiçavicë. Bari i gjelbër i shtruar me lule. Rahimja e vogël flinte. Lule ishte edhe Shqipja, Zoja, që si një lulëkuqe kishte rënë në prehër të Mihanës. Shota e shihte Sherifen me sy të përlotur dhe Shqipen që zgjaste duart drejt saj: «Më merr me vete, dada Shotë!»

«Të kesh fëmijë, do të thotë të flesh, Të flesh e qetë mbi vdekje e kukamë. E unë due medoemos një djalë. Një bir, që vdekjes t'i thotë: ndal. Që tupanë të bien brez pas brezi në kullë: «O prite Azemin, të birin, të nipin, e të birin e të nipit, në tokën që plisa të bardhë na ka dhanë. Plisa të pastër si zemra, që zemra

akull të mos i ngrijë Azemit, që vdekja e ndjek në çdo hap. Përpëlitu sa të dësh ti, nuse e Azemit», — ngulmoi Shota me zemërim.

«Thonë se je trime e çartun ti, Shotë Galica, — foli nusja, që luhatej e përletur, — se plumbin me plumb e ke nxjerrë prej varrës. Po unë çdo gjymtyrë të këtij trimi fort e due. E malli më djeg si zjarri në shpirt për të. E në qoftë se do, më merr jetën, po jo atë burrë. Nuk mund kurrë ta ndaj me një tjetër Azemin, për këtë qiell e për këtë dhe!»

«Shuej ti, nuse! Kosova ka çika të reja, të bukura. E ti mund të mbjellësh vetëm vdekje. Po na vrasin. A nuk e ndien si po klith Kosova:

*Hasmi don me na farue,
Me na i mbytë fmijët në djep,
Me na i varë trimat në plep.*

Trimat flinin. Azemi heshte. Brenda heshtjes ziente urrejtja. Ajo shpërthen si zjarr. Ajo djeg e përmbys gjithçka.

«Ti dashke që gur në lis të mbetet Azemi?» — tha Shota me rrëmbim.

«Edhe ti aq të lehtë nuk e paske, o komite e vjetër, — iu përgjigj ajo tjetra, — po të shoh që po të thinjen flokët për çdo deqikë e po plakësh në çast, aq sa Azemi nuk do të mundet të të njohë ma.»

«Azemi dhimbjen e ndrydh në shpirt. Po gjaku i ri i zien ndër dej. Në çdo çap lufton me vdekjen. Ai e ka të fortë dorën e nusja duhet t'i sjellë jetë, kurse ti je tharë në rranjë», — foli Shota me kërcënim.

Por ajo tjetra, ajo nusja e brishtë, që kukaste brenda saj, po e shtrëngonte fort me duart e holla, po e mbërthente për gryke, po e shkundte e tmerruar.

«Njeriu për një çast i humbet të gjitha. Po ti ma mirë më vrit, nagantin në dorë e ke, o trime e Galicës, e plumbin me plumb e ke nxjerrë prej varrës. Më vrit, se nuk duroj dot, me një grue tjetër ta ndaj Azemin.»

«Plumbin me plumb do ta nxjerr nga zemra, vetëm të

të dërrmoj ty», — gati sa nuk klithi me zë të lartë Shotë Galica dhe pa me sytë e mendjes Galicën dhe dasmën me një qartësi të tejdukshme.

«Dasma të kemi, të mos mbesim kurrë pa to.»

Shota i binte sharkisë. Azemi ishte përzier në valle. Azemi u shkëput nga vallja e dorën mbi sup ia vuri guas.

«A po qan, a po këndon?» — e pyeti.

«Po këndoj, Azem, se nuk munden kurrë me na farue. Se jemi si bari, kur e kositin, ai përtërihet.» Flamuri valëvitej e valëvitej në kullën e Galicës.

«Veç po e mashtron veten, o Shotë Galica (shtrëngohej ajo tjetra brenda saj). Unë e kam zemrën tande në dorë. Ajo pikon gjak. E gjaku asht aq i hidhëruar, sa edhe gjarpnin e kishte helmue.»

«Ti s'ke pse vikat si bishë e plagueme që çjerr me thonj, — briti Shota. — Hiqi thonjtë nga zemra ime. Hiqi, që t'i shpëtosh helmimit. Ti do ta lash trung të thatë këtë burrë. Këtë trimni të mos e përtërih. Këtë bukuri e urti, të mos i trashëgosh.»

Shota nuk e dinte që përpëlitej. Kujtonte se këtë betejë, ndoshta më të vështirën e jetës së saj, po e bënte «krejt e qetë», e palëvizshme, ndërsa yjet që regëtinin po humbisnin një e nga një. Po zbardhte dita në Çiçavicë.

13

— Shotë, — i tha Azemi. — E di që nuk fle.

Shotës iu nderën të gjitha pajzat e trupit. Donte të ngrihej, ta përqafonte e ta puthte me zjarr dhe të shpëtonte nga kjo barrë, që e kishte thinjur patjetër brenda një nate e që e çonte aq larg prej tij, kur Azemi nuk ishte veç dy hapa më tej.

Por ajo ishte Shotë Galica. Mbërtheu duart përtokë e tha:

— Nuk po fle, Azem.

— Shotë, — i tha përsëri Azemi. — E di pse nuk fle e ç'të mundon.

— Jo, Azem. Nuk mund ta dish kurrë.

— E di, fisnike, — tha Azemi, — e lexoj në ballin e flokët e tu. Por ajo që mendon nuk bahet kurrë.

— Ajo që mendoj, do të bahet, Azem, — ngulmoi Shota e shtiu me nagant.

Shokët e çetës u ngritën nga gjumi.

Ujkani pyeti.

— Ç'asht kjo krismë?

— Krismë dasme, — tha Shota.

Ishte gdhirë tashmë e ata po vështronin pak të habitur Azemin e Shotën në këmbë, përballë njëri-tjetrit. Rahimja e vogël midis tyre në gjumë.

Asnjeri, as vetë Azemi nuk po lexonte dot në sytë e gruas atë pyetjen që e kishte munduar aq kohë nusen e tij.

«A po qan, a po këndon, Shotë Galica?»

Mozaik i Veriut

Ajkuna

Isha krejt e befasuar nga Ajkuna. Gjyshja ime, Hana, më kishte folur për të e nuk dija se do ta njihja Der-vishe Currin në muzgun e jetës, kur po i kapërcente të shtatëdhjetat. Atëherë dua më dukej e habitshme që një grua në moshë të shtyrë të kishte një lëkurë aq të freskët, ngjyrë trëndafili, sy të kaltër që të tronditnin me bukurinë e tyre.

Hana e pikasi që po kundroja e hutuar Ajkunën dhe qeshi nën buzë. Hana e pranoi menjëherë lutjen time për ta mbajtur ca kohë në Tiranë Ajkunën, se doja t'i bëja një portret.

«A nuk të pata folë, se kur kalonte Ajkuna trandej dheu», — tha Hana.

Nuk e dija që bukuria, aq kalimtare e fluturake, mund të kishte një jetëgjatësi të tillë. I rrija me orë pranë. E përqendruar hyja thellë e më thellë në detin e kaltër të syve të Ajkunës dhe rijetoja bashkë me të, gjithçka. Doja të hetoja ç'kishte lënë në fytyrën e saj atë mirësi, nga vinte ai zë i plotë i Ajkunës, që fliste rrallë e për mall e lëvizjet e saj gjithë hir.

I kisha vitet e para të punës. Ende nuk e kisha fituar sigurinë.

Sapo isha martuar e nuk isha veç një nuse e dashuruar. Çdo gjë ishte e bukur dhe e ndritshme në jetën time.

Atëherë ishte pranverë. Një pranverë e vërtetë, pa shira të rrëmbyera, me erën e mirë të luleve në blerimin e thellë. Rrushi në oborrin e Hanës e kishte fletën të hollë, si të tejdukshme, e Hana mbushte japrakë me «jeshillëqe», së e dinte që Miroshit tim i pëlqenin pa masë. Shtëpia jonë e re, dhomat, e sidomos studioja, na dukeshin shumë të mëdha në atë kohë, e ne të dy me Miroshin gëzoheshim kur mbushej çdo boshllëk në të.

Isha aq e dashuruar, sa kisha pak frikë, jo për Miroshin, por për veten. Do të dëshiroja të ishim përherë si atë pranverë, pa dimër, pa pleqëri të trishtuar, pa sëmundje e vdekje.

Ajkuna qëndronte e drejtë, e shkujdesur para meje. Edhe Hana vërente se si lëvizte në skicimet e mia figura e Ajkunës. Nuk çuditej aspak Hana prej meje. Veç shkonte e vinte nëpër shtëpi e tundte kokën si me qortim: «Mos ma prish Ajkunën, çiko, — thoshte, — Ajkuna asht Ajkunë!» E ku ta dinte Hana që më pati ikur gjumi për të? Çdo natë i tregoja Miroshit për Ajkunën.

I thosha «se qenka e vështirë».

Miroshi qeshte.

«Mos u mërzit, Drinë, bukuria është përherë e vështirë!»

Më dukej vetja si një trung para Ajkunës. Më dukej që s'dija fare të pikturoja. Shqetësimi filloi të më bren-te si një kërcënim. Ndoshta nuk do të kisha fare mundësi të jepja në linja e ngjyra atë çka dëshiroja.

Kur ia tregoja në darkë skicimet e mia Miroshit, prisja gati me ankth gjykimin e tij. Ai më bënte vërejtje. Kërkonte.

Miroshi i pari pati besim tek unë. Doja të isha e denjë për këtë, nuk doja që të zhgënjehej. Kjo është e rëndë te njeriu që do, baras me humbjen më të thellë. Miroshi më thoshte se talenti matet vetëm me punë, që unë e përfytyroja si ngjitjen e një së përpjete që

të merr frymën. Sikur të mund të arrija të jepja në portretin e Ajkunës gjithë atë brez grash të dashura, të mira e të thjeshta, që e jetuan jetën nëpërmjet epokës së burrave të tyre, kjo do të ishte e para kënaqësi e plotë në punën time.

«Mos ma mbaj gjatë të ngulun Ajkunën, çiko», — më thoshte Hana.

«Hanë, Hanë, mendoja, e paskam të vështirë me Ajkunën. E paskam shumë të vështirë. Flet rrallë. Është si fletët e një libri të lashtë, gjithë hieroglifë të panjohura».

Përse e quajtën Ajkunë Dervishë Currin?

Ndoshta sepse zbriti në Kosovë, si nuset e Jutbinës... Nuk pati lodër, as të shtëna në dasmën e saj. Dasma që e thjeshtë. Rruga e gjatë, bora e ngrirë. Nusen e përcillnin krushqit e kënga. Kënga e rreptë, e sertë, si vetë plaku Gjetë. Gjeta pati mbetur i rrethuar në një grykë në Kaçanik nga bora, akulli dhe armiku. Armiku i kërkonte Gjetës të dorëzohej. Plaku i drejtoi djemtë e çetës nëpër një shteg në lumin e ngrirë dhe vetë me komiten e thinjur u dolën përballë zaptijeve. I kishin mbushur sajat me gjylet e topave. Sajat rrëshqitnin me shpejtësi. Pleqtë shtinin me armë, as përkuleshin, as ruheshin nga plumbat. Asqerë e zaptije gjuanin mbi ta. Të gjitha predhat e topave, në të pesë sajat, bashkë me komiten e thinjur, shpërthyen e u zhdukën vetëm për disa çaste. U trand dheu e u drodhën shkëmbinjtë e Kaçanikut. Armiqve iu pre udha. Djemtë kapërcyen përtej lumit të ngrirë!

Dasmën e Dervishes e përcolli vetëm ajo këngë komitësh.

Emri erdhi fare papritur, kur e zbuluan nusen. Dikush thirri: «E bardhë shtatnaltë, si Ajkuna!»

Me se ishin mbushur sytë e nuses?

Në sytë e Ajkunës tërmetet e tronditjet e Kosovës. Gjoksi i lokes, plasa-plasa, nga karvanët e hakmarrjes osmane. Nusja e pa Bajramin drejt e në zemër: i fortë, shpatullgjerë, në lulen e moshës së burrit. Sytë e saj hetuan më thellë. Trung i lashtë, si' ahu treqindvjeçar, rrema-rrema. E një plasë, vetëm një plasë, ku shkimet

dritëza e hënës e pruar si dashuria. A ishte e vërtetë se Bajrami pati thënë për të: «që asnjë gruaje nuk i duhet burri që e ka emnin në shtëpi dhe trupin e mendjen në mal?»

«Ani, në qoftë fisnike, e mbart dertin», i ishin përgjigjur miq e dashamirës, që ngulmonin ta martonin.

Curri nuk ishte më i ri. I pati vdekur grua e kishte një çikë thuaje moshatare me atë nuse. Gruan e kishte dashur, e megjithatë qëndronte krejt i shtangur para saj. «Ajkunë!» — pëshpëriti me zë të butë. Iu dhimbs nusja e re, e lartë si cetinë e Bjeshkëve të Nëmuna, me sy të kulluar, që i sjellin jetë udhëtarit të etur për ujë. Ai nuk ishte më i ri. I madh, i rëndë, i fuqishëm, i butë si një fëmijë, po ngazëllehej për nusen e pastër, si pika e lotit, që iu ngul në zemër në vështrimin e parë.

Bajram Curri pati lindur në një qerre në rrugët e Gjakovës, kur po ia nisnin familjen për internim zaptijet turke. Malësori rugovas, sapo dëgjoi klithmën e foshnjës, i thirri: «O Curr, rrugës linde e rrugëve do ta çosh jetën.»

Këtë e dinte edhe Ajkuna, që herët në fëmijëri. Por bukuria e burrit është trimëria.

Më dukej se punoja pak e mendoja shumë.

Miroshi më ngushëllonte se, në qoftë se paskam filluar të kuptoj ç'fshihet pas të menduarit shumë, jam në udhë të mbarë. Asnië punë për të qenë nuk del, po të mos lodhesh së menduari.

«Ajkuna ishte dashuruar me trimërinë e Currit, — i thosha. — E në qoftë se do ta dish më saktë. Mirosh, e tatëpieta fillon kur burri frikësohet, atëherë mos prit asgjë të mirë nga zemra e gruas.»

«Kujdes, Drinë, — më pëshpëriste Miroshi. — duhet të gjesh çelësin e bukurisë që duron deri shtatëdhjetë vjet.

Pritjet e Ajkunës gjithë ankth e shpresë. Shpresa, si një pranverë që vjen pas dimrit të madh. Se dimër i madh qe kur Ajkuna e Bajram Curri u gjendën përballë njëri-tjetrit. Ajkuna shumë e re dhe shumë e bukur. Bajrami i vjetër e me plagë shumë.

Luftë dhe uri. Ikje nga një kullë te tjetra. Jetë e mbushur me shtëpitë e rrafshuara, klithmën e Kosovës dhe të Shqipërisë, që përplasej ngado shkonin hordhitë otomane, ngado shkelte këmba e çetnikut të nëmur dhe mbillte vdekje vojniku i kralit.

«Më shkoi jeta duke pritë! — më thotë Ajkuna. — Rrotullohej toka rreth diellit e jeta ime rrotullohej rreth bacës!»

Në sytë e Ajkunës u ngul përjetësisht pritja. Njëherë i patën pyetur trimat në ditët e kryengritjeve të mëdha: «Si luftohet për Shqipëri?»

«Me vesh opinga, qylaf të bardhë e me u ba Bajram Curr», — qe përgjigjja.

Bajrami nisej për luftë. Ajkuna qëndronte e heshur para tij. Mendonte për betejën në Krasniqe.

Curri luftoi në atë betejë me pushkën e shkurtër. Shtinte me një dorë, pa e mbajtur pushkën te tjetra. Nuk kishte fare në ato çaste fytyrën e një luftëtari, po një pamje si me të qeshur.

«Po a qeshet në luftë, o Curr?» — pyetën shokët pas betejës.

«Nuk e di, s'e kam provue», — u përgjigj Bajrami.

E ja ku qëndronin atë mëngjes përsëri përballë. Kur ia zgjati armën Ajkunës, Bajrami kishte po atë fytyrë të qeshur, si në betejën e Krasniqes.

«Ajkunë, ti e di kur duhet ta përdorësh.»

Asgjë më tepër. Dhe as që ishte nevoja. E mbajti paksa ndër krahët e tij të fuqishëm Ajkunën.

Të gjata e të shkurtra këto rrugët e Shqipërisë. E vogël toka, e madhe lufta.

Ajkuna priti sa u rrotullua edhe një herë toka rreth diellit. Në mes të luftës, një oaz i qetë, i mbushur me dhembje e trishtim. Ishte kthyer Curri nga udhët e vdekjes në shtëpi. Qëndronte para nuses, i malluar.

«A u mërzite, Ajkunë?» — e pyeti.

Ajkuna e vërente e heshtur. Bajramit i genë thelluar rrudhat në ballë, i ishin shtuar thinjat, po zëri ishte po ai, si i një fëmije që ngashërehet dhe i kapërcen lotët me fjalë shumë, vetëm e vetëm që të mos dëgjojë përgjigjen e saj.

«E ku mërzitesh ti, — i tha, — ti e kalon mërzinë me një kangë. A hoqe keq? Je grue kaçaku ti, nuk pyet për të keqen. A pate frikë? Ku e njeh frikën ti!».

Një lumë fjalësh, vetë pyet e vetë përgjigju.

Ajkunës i shtrëngohej zemra. «A kaq pak po më njeh, o burrë i dheut?» mendonte.

Nxori nagantin nga brezi i çitjaneve pa asnjë fjalë dhe e vuri në mes tyre.

Bajrami u ul i këputur.

«Ndizni një zjarr të madh, se po më fillon dimri në korrik», — tha Bajrami.

Ajkuna vrapoi e tronditur. Mezi i ndalonte rrahjet e zembrës. Nuk i duronte dot dhëmbët e tij që kërcitnin si një trok kuajsh mbi kalldrëm. Ajkuna ndizte zjarrin me duar të këputura. Drutë e thata kërcitnin. Të merrej fryma me atë zjarr në pisk të vapës! Ajkuna qëndronte qiri në këmbë, si e ngrirë, ngaqë nuk dinte ç'të bënte tjetër. I kishte hedhur velenxa të leshta, po Bajrami nuk pushonte së dridhuri. Dridhej nga ethet, si të ishte në mes të dimrit në një akullnajë.

«Mos u tremb, Ajkunë, — i pëshpëriti, — unë, unë nuk vdes në dyshek!»

Ajo e mblodhi veten menjëherë. Me të vërtetë, si mund të vdiste në dyshek Bajram Curri?

Kështu kaloi ajo natë e vështirë. Të nesërmen Bajrami ishte i dërrmuar nga ethet, por u ngrit e filloi të hante me oreks. Që ta qetësonte krejt nusen e tij, i tregoi këtë ngjarje:

«E di, Ajkunë? Njëherë, në një pushim, midis luftrash, ndërsa po haja bukë me djathë në mes të luftëtarëve, një i ri më kërkoi të kërceja një valle!»

Ajkuna qeshi. Dhe ai u gazmua.

«Nuk të kam pa kurrë në valle», — i tha Ajkuna.

«Edhe unë u çudita pak, — vijoi Bajrami, — dhe e pyeta djaloshin: Unë të kërcej?»

«Po, o Curr!» — më tha djali.

«Arusha kërcen ma bukur, bre bacë!» — iu përgjigja.

«E kërceve dikur një valle në dasmën e tim vëllai, — ngulmoi djaloshi. — Ishte një valle që nuk e kishim

pa. Hyre ndërmjet të rinjve, më zure dorën e më thirre «ngule fort kambën në tokë, o t'u thafshin krahët.»

Iu kujtua vërtet ajo dasmë bacës, vallja, a ai vetë ishte krejt i njomë atëherë. Shpejt ishte burrëruar. «As unë nuk e di, Ajkunë, se si jam hedhë në atë valle, kërceja e i bija tokës, e ngulja kambën në të, thuajse i përgjigjesha asaj kur ankohej. «Mos më leni në duer të të huejve, bre»... A thue do të shkojmë deri në fund të kësaj beteje të vështirë, se shumë ujq të uritur po duen të na shkyejnë, moj loka!»

Ajkuna e vështronte me dashuri Bajramin. Sumbullat e djersës i shkëlqenin në ballin e gjerë. Ajo ia fshinte lehtë me shami.

«Po e kërcejmë këtë valle të egër të luftës, Ajkunë, për të mos na e zhgulë jetën mbi këto troje të shtrenjta.»

«Po, a me gjithë mend priset jeta mbi tokën e lashtë e të vjetër sa bota?» e pyeti Ajkuna.

Bajrami ia shtrëngoi dorën fort. Dora e tij e madhe, e rëndë, e djersitur, mbante duart e Ajkunës, të buta e të bardha.

«Ti u trembe për mue, Ajkunë?» — e pyeti me zë të ulët.

«Jo, he burrë!»

«Mos u tremb kurrë për mue. E kam pasë një qerre për djep. Më së pari botën e kam pa nga dritaret e burgut turk. E unë nuk due që fëmijët ta njohin jetën pas dritareve të burgjeve. Burgu të shtrëngon shpirtin. Ta humbet fytyrën.»

Ajkuna ishte dhembja e madhe e ndrydhur në kullat e Jutbinës. Ajkuna ishte pritja e gjatë, pa mbarim. Pret Mujin, pret të birin. Ajo e donte kreshnikun dhe kishte frikë për të birin. Diçka janë të afërta këto Ajkuna.

«E ke në dorë fillin e Arianës, — tallej Miroshi, vec mos u ngatërro nëpër labirintet e Lugjeve të Verdha.»

Përse të lindte dielli e të mos nxehte, Mirosh?

«Ishte dimër i madh, e dashur, dimër i rëndë. Bora e madhe rëndonte ahet e çetinat për t'i thyer.»

«Njeriu ngrinte në atë akullnajë, Mirosh.»

Ishte me të vërtetë dimër i madh, si dimri i Jutbinës. Dimër i Shqipërisë e i botës. Të huajt as që e kishin bërë Shqipërinë e as që do ta ruanin e mëkëmbnin. Kosova vlonte në luftë. Të shiturit deshën ta vrisnin Bajramin para shtëpisë së tij në Shkodër. Në Shkodër Ajkuna kishte miq shumë e dashamirë, po para shtëpisë së tij doraci shtiu mbi Bajram Currin.

Gruaja u drithërua nga të shtënat.

«Zemër e fortë më paska qëllue, kur nuk po më ndal tash», — tha me vete e u ngjesh pas dritares.

Priti një çast, dy, tri. E pa tek vraponte këlyshin e shitur, si ujkua në mjegull. Mendonte me hidhërim: «Si mund të lindë një grua shqiptare përbindësia të tillë?! Më mirë barku bosh e jeta thatë!»

I ishte ndrydhur krejt zemra Ajkunës. Po i merrej fryma kur e pa Bajramin tek hynte krejt i qetë në derë. Kishte dashur atëherë të vraponte drejt tij, të vraponte e ta kalonte frikën me një klithmë gëzimi, po nuk lëvizti fare nga vendi. I qëndroi edhe buzëqeshjes së mekur në buzë të Bajramit e vështrimit pak të vrenjtur të syve, që thoshin: «Nuk na mjaftojnë krala e mbreta, po tash u dashkan edhe Esatat me dovleta!»

Ajkuna ngazëllente që Bajrami ishte shëndoshë e mirë. Një ishte ai burrë mbi dhé. Të dytë zor se bënte nëna.

«Ajkunë, — i tha Bajrami.

«Po, — iu përgjigj Ajkuna.

«Nuk mund të vdes kaq lehtë, se i kam edhe do punë, — i tha, e ai ia mori dorën. — Po dridhesh, nuse?»

«Jo, aspak.»

«Më duhet të iki përsëri.»

«Po e marr vesh. Tri ditë i ke pasë tepër në shtëpi.»

«Mos të të shoh kurrë të ligështueme, Ajkunë! — i tha Bajrami. Heshti për një çast. — Po a kemi gjë pas shpirtit, grue?»

Ajkuna solli stolitë, që nuk kishte pasur rast t'i mbante kurrë.

Bajrami u drithërua.

«Ajkunë, nuk ke çue jetë me mue, — i tha.

«Nuk të jam ankue. Jam e shoqja e Bajram Currit.»

«Me t'i lanë peng këto, nuk të siguroj se t'i kthej, Ajkunë.»

«Nuk ka dert, veç të kryesh punë», — iu përgjigj ajo, gati me gëzim.

Po gëzimet ishin tepër të rralla në jetën e tyre.

Ajkuna përgatiti shpejt ç'mundi për rrugën e gjatë të Bajramit, pa thënë më asnjë fjalë. U ndanë në heshtje. Ajo priti një kohë të gjatë, me zemër të ngrirë. Asnjë e shtënë. Bajrami matej me vdekjen. Vetëm pas një kohe, Ajkuna e përmbloodhi veten dhe shtrëngoi nagantin në brezin e çitjaneve. Mbeti vetëm dhe duhej të mbrohej e të luftonte vetëm. Ishte nuse e re dhe shumë e bukur Ajkuna. Po rininë e jetoi në kohën kur duhej ose të shuheshim ose të qëndronim, atëherë kur gratë nuk anko-heshin, të zëna me ato punët e vogla e të thjeshta.

«Pushkës së Bajramit po ia sheh sherrin kush po do me hangër në besë Shqipërinë», — përsëriste vetë me vete Ajkuna.

Trupat e pushtuesve bridhnin nëpër Shkodër. Ajkuna priste lajm nga Bajrami. Për një kohë i ndau vetëm heshtja, por heshtja ishte e mirë. Nuk kishte të shtëna në mes të rrugës. Lajmi i keq çan edhe detin. Heshtja ishte pritje. Ajkuna pret, nuk e zë vendi, sa të kthehet Muji nga Lugjet e Verdha.

Trokiti dera. Ajkuna zbriti me vrap. E hapi. Para saj qëndronte një ushtar i shkurtër, qesharak, që bel-bëzonte:

«Gospodari do t'ju takojë.»

«Takohe mi me barut», — iu përgjigj Ajkuna, pa e lëvizur dorën nga brezi i çitjaneve, ku shtrëngonte nagantin.

Ushtarit i mbetën të ngrirë sytë e rrumbullakët si prej qelqi.

Ajkuna mbylli derën e nuk lëvizi fare nga shtëpia. «Nuk i trembemi egërsisë, — përsëriti me vete fjalët e Currit, — kurthit i trembemi ma shumë!»

Dimër i madh i botës e i Shqipërisë. Me qindra Ajkuna prisnin t'u ktheheshin burrat nga frontet e largëta,

por ata mbeteshin në akullin e tokave të huaja. Ushqenin korbat. Ushqenin gjëmën e nuseve të reja.

Ato ditë i dërguan Ajkunë Currit lajm të largohej menjëherë nga qyteti.

Ajo nuk deshë të ikte nga Shkodra. Rojat e prisnin te dera, të armatosur e të zyrtë. Lufta e Parë Botërore mund të ngrinte gjithçka me akullnajën e saj vdekjeprurëse, po shkodoranët nuk i ndrynte brenda. Kishin mbushur të dyja anët e rrugës. Nuk donin t'i linin esatistët të festonin internimin e familjeve të patriotëve.

Rojat e shtynin Ajkunën bashkë me të tjerët, po shkodoranët këndonin:

*Ku len dielli e ku len hana,
Bajram Curr nuk ban ma nana!*

Ajkuna kapërdinte lotët!

«Ti je bijë Kosove», dëgjonte zërin e dashur të Currit. «Mos të të shoh të ligështueme!»

Ajkuna nuk kishte asgjë pas vetes, veç një bohçeje të lehtë dhe nagantit. Do t'i largonin në vende të huaja. «E huej në mes të të huejve, krejtësisht vetëm», mendonte Ajkuna.

Aty kishte shoqe të saj e të bacës. Së largu po e përcillnin edhe Fatimja me mësuesen e re. Atë mësuese ua kishte sjellë Luigj Gurakuqi asaj dhe Fatimes, mikeshës së ngushtë. Ndoshta Bajramit nuk i binte fare në sy që Ajkuna e tij nuk dinte as të shkruante, as të lexonte, por Luigjit po. Ai ua sollë mësuesen e re, me flokë të prerë e krejt të zbuluar. Po nuk arritën t'i mësonin shkronjat deri në fund. Ndërsa Ajkuna mendonte, dikush iu afrua e i lëshoi në dorë të holla.

Ajo mbeti e hutuar, por e përmendi zëri: «Merri, o burrneshë, e mos të të vijë zor. Ç'ka ba baca për Shqipni, nuk e lajnë as deti i gjanë e as bota e tanë».

Mirënjohja trazohej me lot në sytë e Ajkunës.

Nuk i bënë këmbët të ikte nga Shkodra. Po e shtynin bashkë me të tjerët. I futën në një varkë e i hodhën në det të hapur.

Ajkuna, si e përhumbur shikonte brigjet e atdheut që mbetën tutje. Vetëm një ngjyrë, tokë e det. Një vijë e largët e hollë në horizont.

Ajo i mbante ende në dorë paratë që i kishin falur shkodranët. Mendonte për Bajramin, që do të trishtohej kur të kthehej e të mos e gjente në shtëpi. «Ku asht Bajrami, ku asht tani?» mendonte gruaja.

Edhe pak e portretit po i vinte fundi.

— Ki kujdes, — përsëriste Miroshi. — Në çdo detaj, në çdo vijë, në dritëhijet e fytyrës së kësaj gruaje shtatëdhjetëvjeçare është ngulitur kjo jetë. Shihi pak sytë. Sytë janë të ftohtë.

— E kuptoj, Mirosh. Sytë duhet të flasin, — thashë e pezmatuar. — Siç duket nuk do të mundem. E di, kështu më ndodh gjithmonë. Atë që e dua më tepër se çdo gjë, asaj i druhem e nuk e arrij dot.

— Ajkuna kudo shihte Bajramin e saj.

— Sytë e nuses kishin mall e dhembje, po më tepër mall. Ku ishte Bajrami në atë kohë?

Bajram Curri kishte rënë në prita të armikut e çante me shokët nëpër pyll. I udhëhiqte trimat një grua. U dha bukë e u tregoi shtigjet e daljes. Bajrami i dha asaj një pare ari. Kishte lënë peng stolitë e së shoqes, po varfëria e popullit i therte në shpirt, e trondiste deri në palcë bujaria e tij. Malësorja, me zërin e sertë prej burri, kundërshtoi:

«Kush ma jep këtë pare ari?» — pyeti me një fytyrë gati të zemëruar.

«Bajram Curri, fisnike», — i thanë.

«Ani, po e marr e po e ruej, atëherë», — u përgjigj Dila dhe e rrotulloi në dorë paren me çudi. Rrallë i kishin zënë sytë e në dorë nuk pati mbajtur kurrë. Dhe e ruajti Dila.

Kaloi si stuhi lufta botërore. Erdhën traktatet dhe pazarllëqet e Fuqive të Mëdha, që shisnin e blinin kombet. Bajrami qëndroi krah popullit e nuk u çudit, kur malësorja Dilë ia ktheu paren e arit, kur ishin më ngushtë e më hollë se çdo herë tjetër.

Fëmijët pa bukë i ka lënë Dila, po paren e arit ia ktheu bacës për Shqipërinë.

U kthye përsëri Ajkuna në Shkodër. Erdhi edhe Bajrami.

«E s'ka si të na humbasë Shqipëria», drithërohej baca, ndërsa i tregonte Ajkunës për Dilën, në shtëpinë e tyre në Shkodër.

«Përse nuk po i çon sytë», — e pyeti ai të shoqen.

Ajkuna kishte mbetur e shtangur, si atëherë, kur po e internonin e nuk ishte e zonja të lëvizte as gishtin.

«— Jo, ashtu kot.»

Bajrami nuk u turpërua prej saj, që po i rrëshqitnin lotët mbi mustaqet e thinjura.

Miroshi i ndiqte me vëmendje ndryshimet në portretin e Ajkunës. Punoja me sytë. S'ma dridhte më dorën pasigurisë.

Drina, — më thoshte Miroshi. — E sheh që po ia del. Sytë po marrin jetë.

— Mua më duket vetja e përkëdhelur, bile e llastuar, kur mendoj jetën e Ajkunës.

— Ajkunë, ç'pate, përse heshte? — e pyeta me druajtje, kur portreti i mbaruar qëndronte para saj.

— M'u kujtu laku që i vuri Zogu, çika ime.

— E di, Ajkunë. Kjo është më e vështira për ty, — i thashë.

— Jo, Drinë, pak trimni i ka mbetë edhe grues së Bajram Currit, — ngulmoi Ajkuna ndërsa shihte portretin në heshtje.

Ishte dimër i egër i vitit 1925, kur Bajrami çante borën e ngrirë të staneve të Droçes. E ndiqnin këlyshët e Zogut e të Kryeziut. Në mes të akullit e borës ecte baca me këmbë të ngrira. Xhandarët i qenë ngjitur bashkë me mjegullën Dragobisë. Baca pati lënë një fishek për vete, e luftoi deri tek ai.

— Ajkunë, përse hesht? A nuk po të pëlqen portreti yt?

— Ta dish, Drinë, se e kam peng që e kanë shëtitë të vramë mbi kalë, — tha Ajkuna.

«Nuk ka kërkuar tepër Bajram Curri. Një qerre për lindje e një shpellë për vdekje», mendova.

Nuk e pa dot Ajkuna. Nuk e pa më kurrë, Burrecët, edhe të vdekur, e patën frikë Bajramin! Nuk e pa më Ajkuna. S'e qau te koka. Nuk e vajtoi me ligje. Dila, pa pyetur për rrethimin e xhandarëve, e shpërtheu gardhin e tyre e vajtoi bacën:

*Q'ajo pushkë, vëlla, si të muer ty,
Muer Krasniqen shpi më shpi,
Gash, Bytyç deri në Dri,
Muer Kosovën bitevi.*

Pak ka kërkuar baca. Një qerre për lindje e një shpellë për vdekje. Por edhe nga vdekja e tij kanë pasur frikë.

Lot të mëdhenj u rrokullisën nga sytë e Ajkunës.

— Ta dish se e kam peng që e kanë shëtitë të vramë mbi kalë... — përsëriti.

«Ti je bijë Kosove, — desha t'i thosha, — je gruaja e Bajram Currit.»

Po lotët tashmë ishin tharë e sytë e Ajkunës u bënë më të thellë, si të ndiqnin Mujin ndër Lugje të Verdha, me vikamën nga thellësia e shekujve;

*T'u shkimtë drita, mori hanë,
qysh me e lanë nanën pa djalë!*

Takimi

Për një kohë të gjatë Skulptori i Popullit H. u interesua të mblidhte të dhëna nga jeta e Isa Boletinit. Nuk la dokument e arkiv pa gërmuar, nuk la njerëz të gjallë që e kishin njohur pa pyetur. M'u lut edhe mua ta njihja me gjyshen time, Hanën.

Hana ishte mësuar me kërkimet e studiuesve për jetën e të atit, Isës. Sapo ishin larguar djemtë e televizionit me kamerat dhe gjithë telashet e tyre. Hanën e shqetësonin vetëm dritat e forta dhe munda që bënte për t'i mbajtur sytë hapur, po për të folur, foli e qetë, madje qeshëm me të madhe atë mbrëmje, kur u mblodhëm për të parë programin për Isën: «A thue kjo plakë qenkam vetë», më pyeti Hana gjysmë me shaka, gjysmë seriozisht. «Jo, Hanë, ti nuk do të plakesh kurrë, fajet i kanë aparatet!»

«Ani, Drinë, bija ime, e kam thanë vetë, se vitet numërohen deri në pesëdhjetë, pastaj, tek e mbramja, ikin vetë.»

Kur vinim së bashku me skulptorin, i tregoja për fëmijërinë tonë, që kishte kaluar pothuajse e gjitha në atë oborr të vogël, të rrethuar me mure qerpiçi. I tregoja sesi e ndieja veten përherë fëmijë në prani të Hanës.

Ishte pranverë atëherë dhe ne me skulptorin e gjenim shpesh Hanën duke mbjellë qepujka, domate ose sallatë.

— Siç duket do të hamë edhe ne nga këto domate, — thoshte skulptori.

E Hana gëzohej si fëmijë, kur i lavdëronin «jeshillëqet» e lulet, që rrethonin gjithë verandën me plloça të bardha.

Skulptori ngulej me durim në rrëfimet e Hanës. Unë vetëm sa e ngacmoja e ajo tregonte për gjithçka, pa u mërzitur fare. Skulptori i sillte edhe fotografitë e zmadhuara të Isës dhe pyeste se cili nga nipat i ngjante më tepër, pyeste me hollësi për çdo gjë.

Hana kishte kohë që qe rënduar nga veshët e unë ndonjëherë e mendoja botën e saj si një shtëpi të veshur me qyrk të trashë bore, ku nuk depërtonin tingujt e botës. Por Hana nuk e bënte veten asnjëherë dhe përpigjej të rrëmbente, nëpërmjet lëvizjeve të buzëve, çdo fjalë.

Rrëfente ulur nën pjergull, e rrethuar me lulet e gjelbërimin e kopshtit të saj, me zërin e pandryshuar.

I përsëriti edhe një herë me durim ç'dinte për të atin, ç'mbante mend për të.

Foli për ikjet e tyre, për mauzerin që rrinte i varur në odën e madhe të miqve, edhe kur trimat ishin larg; e ajo shtinte nganjëherë me të, që të mos mendonin se kishin mbetur vetëm, gra pa burra. Tregoi për plakën Aishe, nënën e Isës, me patllake në brez, për zërin e saj, që gjëmonte kur bëhej flakë e tym kulla e lufta ishte në zjarrin më të madh: «Qëndro i fortë, bir, se të ka ba nana të luftosh me pashallarë!»

Kur ishte në përfundim të monumentit, skulptori m'u lut t'i shkoja bashkë me Hanën në studio. Ta shihte Hana e në mund të thoshte ndonjë mendim për të. Vetëm atëherë e kuptova shqetësimin e Hanës, që ajo e fshihte aq bukur, me mahitë e saj.

«— Ka me qenë Isa njeri i gjallë?» — pyeti.

«— Jo, — i thashë, — është në punë e sipër, jo i mbaruar krejt!»

«— Due ta shoh kur të jetë mbarue, — tha Hana, — se më ka këputë malli për bacën.»

Këto po mendoja atë mëngjes dhjetori, kur shtyva derën e shtëpisë së Hanës. Këmbana vuri alarmin. Isha mësuar me atë zile të veçantë, që zgjonte gjithë mëhallën. Tingujt të kujtonin përçorët e tufave të mëdha dhe aromën e barit të gjelbër. Zilja — këmbanë rrinte e varur, që kur s'mbahej mend, pas portës së vjetër me dërrasa të ngrëna në fund. E dallova së largu fytyrën e Hanës, pas dritares, dhe e përshëndeta me dorë. Nuk kuptova në ishte e gëzuar a jo.

«Mos jam vonuar?»

«Thashë se të kish dalë ndonjë punë, çiko», — tha Hana dhe e tërëhoqi derën pas vetes. Megjithëse e njihja jetën e saj, të mpirë në vitet e gjata, në lëkurën e thatë e të tejdukshme si letër cigareje, në sytë e mprehtë që rrallë i kisha parë të qanin, tani, në ditët e ekspozitës së Lidhjes së Prizrenit, i pashë lot kur i tregova se si e kishin «vendue» në qendër të Pallatit të Kulturës monumentin e Isës.

«Tash po kena me shkue bashkë», — tha Hana.

Mbante ende rrobën e shtëpisë e nuk dinte si të fliste e si të vishej. Vishej shpejt, thuajse pa vënë re gjë, vraponte e përsëri ndalej. I rridhnin lotët e dhimbjes e të gëzimit brenda vetes. «Malli», mendoja, e vija rrotull nëpër dhomën e Hanës. Kërkonim relikte të dikurshme. Një pallto të gjatë prej pellushi të ndritshëm e të zi të modës së hershme.

«Ftohtë, çikë!»

«Është me të vërtetë ftohtë sot, Hanë. Bie shi.»

«Shi bore!»

«E lemë për një ditë tjetër, Hanë. Shkojmë një ditë me kohë të mirë.»

«Ani, se nuk jemi sheqer e kemi me u tretë.»

Nxora shallin e rëndë me thekë, ndërsa kërkoja dozë. Fillova t'ia fërkoja dhe t'ia hukatja duart para se t'i vishja dozë e leshta. Hana më ndiqte me një buzëqeshje të largët, si të zbriste nga shekujt, bashkë me tregimet e saj të hershme, që flinin në zemrën time, që nga fëmijëria, të gëzuara, po më shpesh të sërta.

Fëmijëve të tjerë u tregonin përralla. Hana tregonte për jetën e saj.

«Ishte një kullë, — fillonte rrëfimi, — ishte një kullë e lashtë, tepër e lashtë në Boletin. Gjashtë herë me radhë u ba shkrumb, gjashtë herë të tjera u ngrit ma e fortë e ma e bukur.»

E kisha parë me sytë e mendjes atë kullë. E kisha jetuar gjithë jetën e saj në fantazinë time fëmijërore, përherë me plagë gjaku në trup, gjithnjë me zjarr e gjuhë tymi nëpër të, gjithnjë të përtërirë.

«Si ngrihej kulla brenda një nate, Hanë?» pyesja, ndërsa fëmijët e tjerë, nipa e mbesa, vetëm dëgionin Hanën të vrenjtur. «Jo, çikë, brenda një nate digjesh kulla, digjeshin pajët e nuseve, djepet e fëmijëve, magjet e bukës. Ngrihej kulla, po jo për një ditë, asnjëherë për një ditë. Pse e mendon ashtu, Drinë?»

As unë nuk e dija përse e mendoja që kulla ngrihej shpejt, sa të hapësh e të mbyllësh sytë.

«Ne shkonim në vise të largëta, në miq e dashamirë, vetëm me këmishën e shtatit, — vazhdonte Hana, — Na

ndiqnin si bisha të egra zaptijet. Na ndiqnin, e Isa nuk na linte me marrë kurrëgjja veç robve të gjallë, veç robve e shpirtit. Iknim në të ftohtë, në akull. Iknin nuset e çikat e reja. Largoreshin e këtheshin përsëri. E ngrihej kulla e gjallonte. Kishte në të përsëri mauzerë, djepe, magje dhe frëngji. Atllarë, që turfullonin në derë e prisnin trimat, burrat që e kishin lirinë më të shtrenjtë se jetën.»

— Dalim, Hanë?

— Dalim, Drinë, dalim.

— A mund të ecësh deri tek autobusi?

— Jo, shkojmë në kambë, nuk jam trenue me hipë në të. Në kambë e kam gjetë rrugën ma qartë, çikë!

«Sidoqoftë nuk është aq larg, — mendova. — Edhe pak e do të dalim te sheshi i madh.»

— A po lodhesh, Hanë?

— Ec, Drinë, e mos u ndal!

— Ja edhe pak, në Pallatin e Kulturës është ngrohtë. Ke ftohtë?

— Nuk asht aq ftohtë, sa m'u duk në fillim. Diçka jam nxehe e po nxjerr avull, — qeshi Hana.

E ndjeva lëvizjen nervoze të krahut të Hanës, ajo e shkundi sikur deshi të thoshte: «Po a e ke harrue, çikë, që s'jam kaq delikate?»

Jo, nuk e harroja që edhe Hana ishte nisur nuse ditën që gratë përcillnin burrat, veshur me rrobën kuqezi. Atë ditë burrat zbritnin për në Vlorë e ato i dhanë me vete, në vend të pajës, një sënduk me armë e xhephane.

— E sheh Pallatin. Hanë?

— Bukur giatë paska kenë, çikë.

— Po ti vetë nuk deshe të hipnim në autobus.

— Edhe unë po kam pak qeif me pa qytetin, se jam ndry si zogu në kafaz e po ushqej veç plakun e trumcakët. Dhe fajin e keni ju.

Kur isha ngushtë, vrapoia përherë te Hana. Sapo kapërceja pragun, Hana e ndiente sherrin. por as unë e asnjëra nga mbesat e tjera nuk guxonte të zbrazej apo të ankohei. Sikur merrnim dicka nga qëndresa e Hanës. Ndonjëherë mendoja se ajo, që kishte parë aq shumë, më

në fund duhej të ishte bërë mospërfillëse. Po Hana të befasonte me qartësinë e mendimit, me gjallërinë e lëvizjeve të saj, e sidomos me kërkesën e përhershme: «Tash, çikë, e ke radhën me sjellë edhe një trim a një sokoleshë të Hana, Mos u mërzitni, se jua rrit Hana, Nuk po i dhimbset fare Hanës të rritë fëmijë e zogj trumcakë.»

Me të vërtetë në dimër në shtëpinë e Hanës kishte përherë mysafirë, miq të dashur, të gëzuar e llafazanë, që cukitnin te dritarja.

Hana ua hapte dhe i ushqente. I mbante brenda e i ngrohte afër sobës së bardhë, Ata qëndronin në duart e Hanës dhe vështronin me sytë e vegjël dinakë, të trembur. Kur ishin të ngopur, e të ngrohur, Hana u hapte dritaren dhe u thoshte: «hajt, nisuni, e ju priftë e mbara, kur të keni ftohtë, shpejt te Hana!»

Hana ecte ngadalë dhe mezi i tërhiqte këmbët, thujse po i rëndonin tepër. Ç'mendonte Hana? E kishte përcjellë bacën dikur me atë rrobë të hijshme kuqezi e nuk e pa më kurrë.

Kur u gjendëm te shkallët e Pallatit të Kulturës, Hana u ndal.

— C'ke, Hanë?

— Mos u qesh me plakën. Po diçka po më kërcen zemra jashtë kafazit.

Me të vërtetë kishin ardhur shumë njerëz te Hana, e ajo e kishte parë Isën nëpër libra, në fotografi, piktura e në filma, po tani «kishte me qenë krejt si njeri i gjallë», veç prej guri. Si njeri i gjallë. Këtë Hana po e përsëriste shpesh me vete ato ditë.

Pasdite përherë bëhej një grumbull i madh në hyrje dhe Pallati ndryshonte krejt fagen. Në mëngjes ishte serioz, i qetë, (zakonisht vinin pensionistë dhe studiuesit e heshtur, që humbisnin nëpër salla me ballin e rruddhur e flokët e thinjur). Po pasdite ai ishte zakonisht i tillë, i qeshur e i ri.

Edhe atë pasdite shkallët ishin plot me të rinj. Sa më të rinj ishin djemtë e vajzat që ngjitnin shkallët e Pallatit, aq më e vjetër dhe e lashtë më dukej Hana, që po e mbante sadopak veten të mos vraponte tek Isë

Boletini, që me krahun e shtrirë dukej sikur donte të grishte çikën e tij, Hanën, në atë takim. Takim që vinte përtej kohëve të largëta.

Ndofta Hana shikonte se si i kthente shpatullat e larta Isa, se si e ndiqnin nipat e djemtë në udhën e gjatë. Se si po zbritnin ata nga bjeshkët, si një ortek bore, zbritnin nëpër udhët e Kosovës drejt Vlorës, e linin pas djepe e fëmijë. Atëherë hapi i Isës që i lehtë, buzëqeshte e shikonte gjithçka linte pas.

Shikonte rrëmetin, që vinte pas tij.

Monumenti i Isa Boletinit ishte vendosur në sheshin kryesor të ekspozitës së Njëqindvjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Hapat e Hanës u bënë pak më të lehtë. Ata rrëshqitnin e shkonin drejt tij. Hana u drodh, kur pa që skulptorit nuk i kishte shpëtuar as ajo buzëqeshja e derdhur në buzë, as ai pezmi në ballë, as ajo rrudhë e thellë e fatit të tyre, për të gjitha ato ngjarje që kishin rrjedhur në rrugën e gjatë të Isës, nga Boletini në Vlorë e nga Vlora nëpër botë. Diku ishin mahnitur nga armët e tij, diku ia kishin helmuar dhembjen e thellë, që e mbante fshehur me burrëri e fisnikëri. Ishte tepër i lumtur, që më në fund flamuri u ngrit në Vlorë, i qëndisur me shpendin krenar, por ishte po aq i dëshpëruar, se tradhtia përgjonte pas krahëve. Hana më kishte treguar aq herë, që urën në malet e zeza e pati kaluar gjithnjë me sytë mbyllur. Sa herë që zbriste andej, dëgjonte trokun e kuajve të Isës dhe djemve të rinj, që akoma nuk ishin martuar, të dhëndurëve, që kishin lënë foshnjat në djepe, të burrave, që kishin dalë në log të mejdanit me atë veshjen krenare të tirqve të zinj e jelekëve të kuq si gjaku. E vdekja nuk i kishte korrur të gjithë, se ata qëndruan e tani ja ku ishin atë e bijë, krejt përballë njëri-tjetrit, në këtë takim. Isa, në moshën më të bukur të burrit, kundronte Hanën.

Të rinjtë qëndronin një copë herë para pikturave në katin e parë e të dytë të Pallatit, pastaj ktheheshin tek Isa. Boritë e luftës u hynin nëpër shtrëngimin e duarve,

nëpër vështrimet e thella të syve, e ndoshta në belbëzimin e parë të dashurisë.

Burrëria, besa, krenaria e emrit shqiptar e bënë më të tejdukshme e më të thellë ndjenjën e tyre.

«Kjo ndodhi moti, bacë, — thoshte vështrimi i saj. Ke qenë shumë larg kur kanë nxjerrë gra e fëmijë e kanë dashë me i shpërnda nëpër botë, si zogjtë shtegtarë, që u djegin folenë. Ti nuk e ke pa kurrë nanën tonë, Isë, si e ka qitë teneqen e vojpgurit para derës së shtëpisë, në Mitrovicë, se si i ka mbledhë fëmijët rreth vetes e se si ka thanë me za të thekshëm: «Ma mirë po digjemi në votrën tonë, sesa me u ba përrallë nëpër botë.»»

Baca dëgjonte i tëri i ngurtë, me dorën përpara dhe me buzëqeshjen e largët.

Hanës, si një vajze të vogël, të përmalluar, sytë i kishte marrë flakë. E druajtur, zgjati dorën e rreshkur dhe preku monumentin. Në fillim u drodhën lehtë gishtat e hollë, pastaj më e sigurtë, Hana e shtrëngoi fort, si të donte të shuante mallin e gjatë të viteve.

«Vetëm një herë e kemi turpnue veten bacë, e ti ke me na e falë. U koritëm me atllarët, që hingëllinin e qanin si fëmijë, kur u kthyen pa të zotët në Boletin. Vetëm atëherë na pati lëshue zemra, kur ati rrihte tokën me potkonj e guri nxirrte xixa, e kafsha fisnike lotonte si me qenë njeri. Çka të bajshim ne, o bacë?» — pyeti Hana me zë të ulët, gati me një pëshpërimë, që e dëgjova vetëm unë.

Maja e lartë

Hana nuk po bënte këmbë për të dalë jashtë Pallatit të Kulturës e po më shikonte ngultas.

— E tash, çikë, të shohim pak edhe «Shotën tënde», — tha fare papritur.

«Shotën tënde?» Nuk i pata thënë asgjë Hanës, për Shotën. Nga e dinte? Ime motër, sigurisht, asaj nuk i rri gjuha.

— Mori Drinë, çka po habitesh, a ke me më çue me pa «Shotën», apo jo?

— Më fal, Hanë, ja, po ngjitemi, është në katin e dytë.

I ngjitja shkallët së bashku me Hanën si e mpirë. Ç'do të thoshte për «Shotën» time? Tabloja e Shotë Galicës ishte gjithë mudi e djersa e vitit të fundit. E dija që nuk do të mund të krijoja kurrë diçka tjetër të ngjashme me të, ashtu si nuk ka mundësi njeriu të ri-jetojë edhe një herë nga fillimi jetën e tij. Një jetë është e vogël sa dhe e madhe. A do të kisha mundësi të rrokja brenda saj një majë të lartë, të lartë, si Çicavica?

Për shumë vite i jam tutur ngjitjes së saj, ashtu si tani po i tutem Hanës. Për shumë vite e kam përkëdhelur atë ëndërr, që e kam dashur më tepër se çdo gjë tjetër. Prej kohësh i kam thënë me zë të ulët vetes: «Prit pak, o nusja ime, dua të bëj diçka të denjë për ty!» E tani po i trembem Hanës më tepër se një auditori kritikësh arti, të heshtur e të rreptë.

Shota kishte qenë përherë një majë e lartë. Një mal me ballin në re, si Çicavica mbi tokën e begatë, pa anë e pa fund, të butë e të dashur. gjithë burime ujërash e rrëkerash gjaku, si fusha e Kosovës. Nuk kisha qenë ndonjëherë në Kosovë, por me Shotën e kisha përshkuar skaj më skaj. Nuk dihej si kishte zënë rrënjë aq thellë në jetën time Shotë Galica. Ndoshta sepse ne u rritëm në odën kosovare, në shtëpinë e Hanës, ku morëm mësimet e jetës me dëshmitarë të gjallë. Ndoshta sepse vetë Hana këndonte me një mall të largët, të largët, që pikonte në zemrat tona të njoma.

*...se shqiptari dy gëzime ka,
Një kur le e në luftë me ra,
Se me gjak vaditet trimnia,
Se nga gjaku vjen liria.*

Atëherë flija me Hanën. I strukesha në gjoks dhe i ndieja erën e borzilokut që mbante në arkën e saj. Arka

ishite mrekullia e mistereve për ne të vegjlit. Prej barkut të saj dilnin lloj-lloj relikte të vjetra, të harruara, me atë erën e mirë karakteristike. Dhe flokët e Hanës ishin ende të errët, kurse lëkurën e kishte të bardhë e të paprishur.

— Si ishte Shotë Galica, Hanë?

— Nuse ma të bukur e ma të rreptë syni nuk mundet me pa. Shtatnaltë si selvia, e pastër si lulet e bjeshtëve, e butë si vjollcat që mbulojnë shpatet e Kosovës. Në krve mbante plisin e bardhë si të kishte pikue nga mali. Në sytë e saj, eh, çikë, ç'të thotë Hana? Mos pafshin sytë e tu ç'kanë pa sytë e Shotës, ç'kanë pa sytë tanë, vaj e gjamë, bijë.

— Po pse, Hanë, pse nuk veshi fustan të bardhë Shota? — ngulmoja.

— Veshi një rrobë shqiptare që e pati qëndisë vetë.

— E mixha? E ka parë nuse Shotën?

— Im vëlla ka qenë shok i Azem Galicës. E shumë lufta të rrepta ka ba.

— Mixha ynë, Hanë? Luftëra të rrepta me bajlozë, si Gjergj Elez Alia? Mixha luftëtar?

Jo, mixha ishte më tepër kallëzimtar. Ishim të lumtur kur vinte me bujtë te ne vëllai i gjyshes Hanë. E prisja përherë me gaz. Luftëtarin e mendoja ndryshe nga mixha, nuk e di sesi, po ndryshe nga mixha, me dorën të cunguar e mjekrën e dendur, të vrazhdë e të thijnur, oë i mbulonte mollëzat e kërcvera. Mixha me plisin e bardhë, që nuk e hiqte kurrë. Mixha me duart me neblebli. Vraponim të gjithë sapa që pushonte zilja-këmborë e dukej plisi i mixhës te porta. Mixha zgjaste dorën e shëndoshë e na prekte flokët, supet, si të mos ngihej frymë prej mallit. Oborri i Hanës buiste nga nipat, mbesat e rrëmuja.

«Carrokët e mixhës», pëshpëriste.

Nuk e di përse më trishtonte dora e tij e cunguar. Aq shumë më trishtonte sa mezi i përmbaja lotët, vetëm e vetëm sepse e kisha shumë frikë Hanën, oë nuk donte të shihte kurrë lot në sytë e fëmijëve. Mixha

rrinte në krye të odës së mirë, ose ulej nën pjergull dhe pinte kafe me Hanën dhe bacalokun (kështu i thërritnim gjyshit tonë). Dhimbja ishte ngulur në fytyrën e mi-xhës e vërehej në gjithë lëvizjet e tij. Zëri i vinte si nga një shkretëtirë e largët:

— Qe besa, moj motër, vdekjen e ka pa me sy në kampin e Rudnikut. Azem Bejta, — i rrëfente mixha Hanës. — Një livadh i rrethuem me borë e akull. Me ditë, me javë pa shtrojë e pa mbulojë. Rojat serbe me armë shtrëngue rreth telave. Ditën sjellin të rinj, natën heqin të vdekunit e ngrimë nga të ftohtët e uria. Kush guxon me kundërshtue, vritet në vend. Po Drenica nuk mundi ma të durojë. U ngrit me sëpata e drunj e iu turr fushës së vdekjes.

I dëgjoja rrëfimet e mixhës krejt e ngrirë, gati pa marrë fyrmë deri në çastin kur drenicasit sulmonin. Atëherë çliroheshja nga fusha e akullt, me krokama korbash, që thyente shkretimin me thirrjet e kushtrimin e Drenicës. Fusha trandej. Korbat merrnin arratinë. Këto përfytyrime më lodhnin, po nuk u ndahesha mixhës e Hanës.

«Sugarja e mixhës, e butë, e butë si qengj», më thoshte, ndërsa dora kalonte mbi flokët e mi të rrallë.

«Ja kam frikën, vëlla.»

«Pse, mori Hanë?»

«A nuk po e sheh si i kapërdin lotët prej tutës?»

«Ani, asht e vogël.»

«Asht gjashtë vjeçe.

«E vocërr asht,» ngulmonte mixha.»

Merrja guxim e pyesja për Shotë Galicën.

Nuk ngopesha me nusen e Azem Bejtës. Bëhesha vërtet e bezdisur. Nusen nuk e përfytyroja ndryshe veçse shtojzovalle me të bardha, që endet nëpër terr e sjell dritë.

Ishte dimër atëherë, dimër i egër i viteve të luftës. Oborri ynë zgjohej i mekur nën një shtresë të trashë bore. Rrinim si të nemitur te dritaret, që kishin zënë avull, me hundën prapa xhamit. Shihnim plepin e lartë në oborrin e Hanës, me kurorën e zbardhur nga bora.

Ime motër, Hedija, thërriste: «Qe nusja e Azem Bejtës, po nusëron, po nusëron.» E ku ta dinim në atëherë, se nusja nuk kishte pasur kohë as të nusëronte. Se pa u mbushur akoma dy javë të dasmës, pa u gëzuar, pa u larguar miqtë, mësynë forcat e shovinistëve serbë në kullën e Galicës.

— Ishte luftë për jetë a vdekje, — përsëriste Hana.

— E vështirë ish ajo rrugë, — vazhdonte mixha.

— Besa, boll e vështirë, vëlla, — i thoshte Hana. — Nusja po vishte rrobën e komitës dhe nana po i mësoke carrokut, se për dhé të vet, ma parë hiqet këmisha prej shtatit, se pushka prej krahut.

Lufta. Nuk shpëtonim dot prej saj edhe sikur të futeshim njëqind pashë nën dhé.

— Rrugë të gjatë e të vështirë kërkonte Shota, — thoshte Mixha.

— Kishim humbë gjithçka e na u desh me e fillue jetën prej fillimit. Na shpëtonin duarsh do sende të dashuna, e zemra na pikonte gjak për çka s'kthehej kurrë ma, — vijonte Hana.

Mixha tundte kryet.

Dialogë të përsëritur të fëminisë sime. Edhe kur shiu nuk pushonte e trokiste, e trokiste në xhama, Hana po i vinte do kërcunj të trashë në vatër e dikur po kuvendonin së bashku me mixhokun.

— Vocërrakët kanë dashë me na i dekë e me e shterë detin e plisave të bardhë të Kosovës, oj loke!

Rrëfenjat ngjyrosën ditët e fëmijnisë sime. Shotë Galica duke mbartur Azemin e plagosur në shpellë. Azemi i anuar në brinjë mbi kalë shtrëngonte nofullat nga dhimbja. Nusja çan nëpër natën e marsit me erë të fortë, me borë e fërfëllizë. Azemi i duhet Kosovës. Erërat e dimrit sjellin me vete të ftohtët e bjeshkëve të larta të Pejës. Azemi qëndron mbi kalë e shtrëngon brezin, që të lehtësojë dhimbjen e plagës në brinjë. E midis tyre një amanet. Midis tyre një betim. Kurrë të mos e marrë vesh armiku se nuk jeton Azemi. Kurrë të mos e dijë varrin e Azem Galicës. Këto ngjarje, këto ditë e shumë

të tjera, fanarë që ndriçojnë natën e errët e të përgjakur të Kosovës. Vite të ikura në terr. Vite të ndriçuara nga pishtarë gjaku.

I kam rikujtuar me dhjetëra herë, kur shkoja bashkë me mixhën te Rahime Radisheva në Derven e ripërtërija, rikrijoja së bashku me ta jetën e Shotë Galicës. Rahimja nuk kishte qenë veçse foshnjë, por i mbante mend fare mirë të gjitha, sidomos vitet e fundit të kaluara me Shotën dhe fëmijët e tjerë jetimë kosovarë.

Kur kalonim të tre së bashku përbri lapidarit të Shotës, në buzë të rrugës, në Fushë-Krujë, mixha thoshte: «Një jetë e jetueme bukur!»

Nuk e di përse e shihja përherë në atë rrugë Shotën me kalin e Azemit, të vetmen pasuri, që e shet për bukën e gojës. Shotën me gishtërinj të kangrenizuar nga plagët e të ftohtët. Shotën në një shkretëtirë shkurresh e kënetash në kasollen e saj në Derven, kur ulet e shkruan atë letër në dimrin e vitit 1926: «Jam duke vdekë urie me katër fëmijë jetimë. Nusja e Azem Bejtës.»

«Mixhë, i thosha, nuk po mundem ta duroj mospërfilljen. Sa herë që kaloj pranë sahatit, në qendër të Tiranës, kërkoj ndërtesën e spitalit, ku ishte shtruar Shota dhe e patën përzënë njerëzit e Ahmet Zogut.

«E çka kishe me pritë ma tepër nga Zogolli, kryebandit e xhelat i popullit të vet?» — më thoshte mixha me zë të hidhur e i vrenjtur.

E megjithatë dhimbja është njëlloj, mixhë!

Ndoshta mund të kisha marrë një çast tjetër për tablonë: Shotën kur shtie mbi naçallnikun, kur udhëheq çetën, kur plagoset dhe shokët i thërresin: «Për hair të goftë varra, Shotë!» Po jo. E kisha marrë fisniken në

çastin kur e lëshon trupin e Azemit në shpellën e Përçevës. Përherë më ka tronditur ai çast, kur litari zgjatet e zgjatet si dhimbje e pafund.

Shpella është shumë e thellë. Litari ka mbaruar. Heshtje ogurzezë e vitit 1924. Heshtje e akullt, që thytet nga zëri i Shotës: «Shtrëngoni zemrat, burra: lëshojeni!» Zemra duhej të kullonte gjak pareshtur nga ky shtrëngim, nga kjo zbritje, në humbëtirën e shkëmbinjve të Përçevës.

Një lapidar në Fushë-Krujë dhe një varr në thellësi të shpellës së Përçevës në Kosovë. Dy jetë të ndara e të bashkuara njëkohësisht ndër dejet e tokës së lashtë.

Mbetëm një copë herë të heshtura me Hanën para tablosë së Shotës. Zemra më rrihte me rrëmbim, si para një provimi. Tabloja mbante dëfturën e lamtumirës: «Azem, tash po e kuptoj përse Kosova asht e papërkulën. Ajo i ka rranjët në zemrën dhe trupin e heronjve.»

Po Hana nuk dinte të lexonte. E nuk tha asnjë fjalë.

Lisa të mëdhenj

Gjatë udhës për në shtëpi Hana nuk foli. Në fillim nuk deshë as të hipte në taksi, po, siç duket, i erdhi rëndë nga shoferi, që po na priste me derën hapur. Hana dukej e lodhur nga takimi me Isën. Kur u nda prej tij, ecte e kthente kokën. Nuk po shkëputej dot nga baca. Në taksi u mbështet në ndenjësë e nuk bëri më asnjë lëvizje, si të qe krejt e ngrirë, me sy të ngulur në një pikë, aq sa, të thuash të drejtën, u tremba pak. Ndofta Hana kishte ende në sy xhamadanin e qëndisur nga plagët, pa u tharë gjaku i urës së Ribnicës, që e kërkonte si e verbër, në trupin e gurtë të Isë Boletinit.

U gëzova kur u futëm në shtëpi dhe Hana, duke ngjitur shkallët, tha: «Sot jam çmallë me njerëz fort të dashun.» Po kur zbriti në dhomën e bukës, u bë për-

sëri e heshtur. Nuk e di përse ndieja brenda vetes një dhembje therëse, që, siç dukej, e tregoja edhe në fytyrë, aq sa motra Hedije më zuri lehtë për krahu e më pëshpëriti: «Hajd, mos më rri me buzë të varuna, se nuk u ba hataja!»

Pastaj u kthye menjëherë nga mixha, që po e përshëndeste nga kreu i tryezës:

— E po, për të mirë, Hedije, — i tha ai me zë shumë të lartë. — Paç e shtrosh gjithmonë, për gëzime të mëdha!

E ky ishte me të vërtetë një gëzim i madh.

Kështu na pati mbledhur motra Hedije edhe kur u shpall Isa Hero i Popullit. Takimi i Hanës me të atin ishte një provë për të gjithë, e sidomos për mixhën. Mixha shkonte e vinte e nuk i ndahej Hanës.

— Mixhë, — tha motra Hedije, — së shpejti unë do të pres me duert e mia qytetarin e tremiliontë, siç të kam thanë e gëzim ma të madh se ky s'ka!

Hedija cakiti gotën e parë me mixhën, sepse ishte e sigurt që pleqtë tani nuk do ta përmbanin më veten, pa u rikthyer edhe një herë në motin e shkuar, siç bënin përherë në të tilla raste. Motra Hedije është katër vjet më e madhe se unë, po duket më e re për shkak të natyrës hokatare. E merr jetën ashtu si i vjen, është tepër praktike dhe me mendje esëll. Pastaj, nuk harron asnjë datëlindje fëmije. Nipa e mbesa lënë kokën pas ca çokollatave me bajame që ajo i sajon vetë.

— Po ku ua mban mend të gjithëve ditën e lindjes? — e pyesja.

Hedija më shikon drejt e në sy dhe qesh: «Sekret profesional, — më thotë, — po a e ke harrue, që unë ua kam pa fytyrën e ua kam ndie zanin ma parë edhe se natat vetë?»

Tryeza në dhomën e gjerë e gjithë dritë të bukës ishte shtruar me shije, ashtu siç di vetëm motra Hedije. Pjatat shkonin e vinin ndërmjet pecetave të bardha e luleve të freskëta. Dy vajzat e rritura të Hedijes, njëra pas tjetrës, si dy binjake, dhe im bir, e kishin marrë

shumë seriozisht detyrën e tyre. E për organizimin e punëve ime motër është pa shoqe. Mbesat e bukura shkonin e vinin pa u ndier nga kuzhina në dhomën e bukës, e asnjëri nuk i mungonte asgjë. Po heshtja e Hanës sikur ra mbi të gjithë. Papritur edhe Hedija u bë më e përmbajtur e më e heshtur se zakonisht.

— Kur e kam pa për herë të parë shpatën e Isës në muze, më asht dridhë shpirti prej mallit, — e preu heshtjen mixha.

Po Hana rrinte e palëvizur, drejt e me vështrim të ngulur diku.

Shpata e kishte një histori të sajën. Vëllai i vogël i Hanës e mixhës, që studionte në Vjenë, kur pati qenë i sëmurë, qe kuruar te një mjek i famshëm. Mjekut i kishte bërë përshtypje sjellja e fisnikëria e djaloshit dhe nuk kishte pranuar asnjë shpërblim. Atëherë Isa i pati dërguar shpatën si kujtim. Kujtimi ishte bërë më i çmuar kur mjeku mori vesh vrasjen e Isës me të bijtë në Podgoricë. Shpatën e solli në Shqipëri pastaj, para disa vjetësh, e bija e po atij mjeku, edhe ajo mjeke, që e shoqëruan këtu një kushëriri ynë dhe Hedija. Ne u njohëm me të të gjithë.

«Në kohën e Luftës së Dytë Botërore, — tregonte mjekja vjeneze, — kur iknim e fshiheshim nëpër strehime nga bombardimet, e merrnim edhe shpatën me vete.»

Ajo përsëriste se ndihej e lumtur që mundi ta përcillte porosinë e të atit: «Kurdo qoftë, shpata të kthehej te të zotët.»

Shpata tani rri në muze. Ndërsa mixha vijon monologun e tij;

«Nuk e harroj kurrë atë ditë të korrikut të vitit 1912, që e nisi agun me gjëmimin e topave. Trandej dheu. Ish fillimi i operacionit të zaptijeve drejt Llapit. Në grykë të Kulinës, për dy ditë rresht, jemi kapë fytafytas, derisa ia premë hovin dushmanit. Në pikë të përleshjes, trimi sypetrit Hysen Grisha shkante krahëhapun e ndalonte plumbat, që vërshonin drejt Isës. Kur ç'të shihje

gjëmonte zani i Isës si bubullimë: «Largohu!» Po ku ndigjonte Hyseni, e përgjigjej pa u tutë hiç; «Jo, sa të vritesh ti, ma mirë po vritem vetë.» Sikur të mund ta shihnit bacën në ato çaste. Thue se do të çahej dheu nga zemërimi e duhia e tij. Prej vrullit, i thërriste Hysenit, si i dalë mendsh: «Liromi sytë, o i marrë, se plumbi na shpon njëlloj si ty, si mue!»

Zëri i mixhës më dukej i thellë, i thellë, si të vinte nga një shkretëtirë gjaku e rrënimi, që më kujtonte shtëpinë e Hanës dikur. Shtëpi me letra katramaje, që e ngrinte gjyshi ynë si në përrallë. Bacalokut nuk i pushonin duart me gunga asnjëherë. Ndrejte samarë, ndërtonte mure prej qerpiçi, qepte në makinë, i kërrusur, pa fjalë, i buzëqeshur bacaloku ynë i mirë, që ishte tmerruar, kur ia patën dërguar Boletinët Hanën me arkën me xhephane. «Vërtet me xhephane të patën çue nuse, motër, — i thoshte ndonjëherë mixha. — po edhe ky trimi yt, i butë, i butë, si qengj, armëve po iu tutka, zavalli, po fëmijëve aspak. E shih si ju asht mbushë shtëpia e ju ngopet syni, plot e përplot!» Ndofta mixha e kishte peng që, edhe pse ishte martuar tri herë, nuk pati veç një fëmijë. Edhe atë djalë të vetëm e kishte përsëri nga kjo motër mixha. Vraponin njëherë nëpër dëborë, e nusja e re e mixhës nuk po mundej ta tërhiqte djepin e djalit me vete. I ndiqnin zaptijet, e kishin ecur nëpër dëborë e tufan. E kishin parë edhe tymin e kullës së largu. Gratë vraponin si të dala mendsh se mos binin në dorë të të huajit. Dikur Hana ishte ndalur dhe e pati mbërthyer nusen për krahësh, e çuditur që i mungonte djepi.

«Ku asht djali, nuse?» — e kishte pyetur.

«Në borë.»

«Qenke çmendë, nuse!»

«Jo, Hanë, po shpirti paska qenë ma i dhembshun.»

Hana e kishte tërhequr nusen pas. «Kthehemi sa nuk asht vonë!» Janë kthyer vërtet, nëpër borë, plumba e fërlazë dhe e kanë gjetur djepin të mbuluar nga bora.

E kanë njohur vetëm prej borës së shkrirë nga fryma e djalit.

Ishte dimër. Dhjetor i ftohtë. Po dhoma jonë e bukës ishte e ngrëhtë atë natë. Xhamat lotonin nga avulli. Motra Hedije e pati ndërtuar, ose më saktë rindërtuar një pjesë të mirë të shtëpisë së vjetër të Hanës. Patën lënë vetëm dhomën e Hanës e zilen-këmbanë sigurisht, sepse Hana thoshte që vetëm ajo po ia zgjonte veshin e shurdhër.

— Ç'nuk na kanë pa sytë e ç'nuk na kanë ndigjue veshët. Një gazetë e carit çirrej atëbotë: «Le të shuhen shqiptarët, ka popuj të tjerë në Ballkan, që do t'ua zënë vendin.»

Po Hana vetëm heshtte.

— Fol edhe ti, motër, një fjalë, — i tha mixha. — Ç'po më rri si e mbyllun me dry?

— E ç'të them?

— A nuk t'u duk monumenti i bacës si të qe duke zbritë tek ura e Ribnicës e po të thotë «Qe Isë Boletini?»

Qe Isë Boletini. As plak as i ri. Me djem e nipa të njomë. Mbi shpatulla disfatën e Cëralevës. Për çdo sekondë buzëqeshja i kthehej në acar, e gjithë stinët e moshës së re i kanë fluturuar me një shpejtësi të panjohur. mendova. Dikur i dërgonte fjalë pashait turk: «Mahmut Shefqeti të mos madhohet, se sa djem shqiptarë ranë dëshmorë në këto lufta, gjithsecili asht pague për dhetë. E Shqipnia nuk asht farue për disa të ndershëm dëshmorë. Por kur të bashkohen të gjithë shqiptarët, ku janë, e të lidhin besën, do të jenë të zotët ta përzanë urdinë turke jashtë Shqipnie, jo ma me armë, por edhe me hunjtë e gardhit.»

Qe Isë Boletini! Zemra e plasur nga pazarllëqet e vitit 1913, burrë i heshtur, edhe më i heshtur u bë. Gjysma e trojeve të lëna jashtë Shqipërisë ia helmoi shpirtin.

— Kur vdes njeriu, motër, njerëzia pyesin: «Ç'të mirë la pas?» — vijonte mixha. — Se vdekja kur nuk le asnjë punë të mirë, që të të kujtojnë, asht dhetë herë

vdekje. Vdekje e keqe asht, se erdhe e shkove e asnjë gjurmë nuk le, si të mos ishe fare.

Mixha i dashur, në pleqërinë e tejlargët e të thellë, thotë se po i ngjason Isës, kur ishte ngritur nga ethet në Durrës, i kërrusur e i pikëlluar, në prag të Luftës së Parë, e pati thënë: «Çka shpresuem e çka pësuem, po të qëndroni të fortë, se ditë ma të mira do të vijnë për Shqipninë!»

Ne hanim në heshtje. Është e pamundur të gëzohesh dhe të mos kesh hidhërim për kujtimet e moçme. Gazi dhe helmi janë vëllezër, thotë Hana. Po Hana atë natë nuk thoshte asnjë fjalë.

— Lis i madh qe baca ynë, motër. Lis me ballin në re. Lis i rrethuem me lisa, që qëndrojnë e mbajnë fort njani-tjetrin. Mos e harroni kurrë.

Qe Isë Boletini, mendoja, kalon mbi urën e Ribnicës, si të dojë t'i bëjë sfidë tradhtisë, si të dojë t'u japë përgjigjen e fundit intrigave të botës së plakur: «Mund të vritni tetë, tetëmbëdhjetë e tetëqind, po të dëshironi!»

«Nuk do të doja të shpëtoja në atë rast, Hanë, ti e di. Nuk do të doja të isha dëshmitar i asaj dite të janarit të vitit 1916. Po të mos më kish dërgue Isa për punë, do të isha edhe unë tek ura. bashkë me të tjerët, duke luftue. Isha në çarshi, kur ndigjova: «Ikni bre, se na ranë kaçakët arnautë!»

Dola shpejt në rrugë e pyeta i shqetësuem: «Ç'po thonë këta?»

«Ç'arnautë more, më tha një shok, bashkë me Isën, i vranë të gjithë tuajt!»

«Mos i raftë në krye njeriu lajm si ky! Flokët e kresë m'u çuen si eshkë përpjetë. Vrapova drejt shtëpisë. Pushka s'pushonte. Isa e Jonuzi po luftonin. Div qe Jonuzi. Kur i patën thanë se e nisën Hanën nuse për ngut, kafshata i kish mbetë në sofër e pambarueme: «Mosni bre», pati thanë. E kishte peng.»

Të gjithëve na shtrëngohej zemra nga monologu i mixhës, megjithëse nuk e dëgjonim për herë të parë.

— Luftonte Jonuzi, tek ura, me kambë të preme.

I binin plumbat breshën e nuk e mbytnin dot. E të gjithë të tjerët, Haliti, Halili dhe Zaidi, që sapo qe kthye nga Vjena, studenti, ma i vogli vëlla, me djemtë e Radishevës e patën ba flakë urën e Ribnicës vetëm me revole.

— O motërzeza, si mund të harrojë motërshkreta, bre vëlla, — tha me zë të shuar Hana.

— Për herë të fundit ia kam ndigjue zanin bacës: «Besa, nuk i jam dorëzue as mbretit!»

— Edhe sot e ndigjoj atë za, derisa të vdes do ta ndigjoj papra.

Mixha mbante dorën topolake të mbesës sime të vogël ndër duar, me sy të gapërruar nga çudia, që më kujtonte fëmijninë time. Edhe unë, kur isha e vogël, gjithë sy e veshë e pyesja Hanën me ngulm: «Po lotët e motrës, Hanë? Harrove lotët e motrës! «Lotët e motrës pikonin si shi te koka e Gjergjit, lot të motrave kosovare, lot bore e gjaku, bijë», më thoshte Hana. Atëherë nuk e dija, që edhe Hana ime ishte një motër e tillë. Po ta dija, nuk do të ngulmoja: «Po lotët e motrës Hanë!»

— Më kanë çue në dhomën e prefekturës, — vazhonte mixha. — Të tetë të vramët rresht. Duken sikur flenë. Shumë jam shtrëngue të mos ligështohem në sy të të huejve. Kur vendosa të përmbahem, diçka më krisi përbrenda. Dhoma m'u ba terr. Qielli i natës qe ende i kthjellët, e dielli ngrohte në dhomën me penxhere të mëdha, të ndritshme. Mue sytë nuk më banin dritë. Nuk e di sa zgjati kjo gjendje, as ditë, as natë, as gjallë, as vdekun. Një mijë herë ma mirë vdekun, sesa ta çoja atë kob në Boletin, Po njeriu nuk mundka të vdesë, as prej dhimbjes e as prej gjamës!»

Humbëtira e syve të mixhës e frikshme, si një hon, si të kishte parë gjithçka mund të shohë një vdekëtar.

Mbesës së vogël i shkonin lotët nëpër faqet e njoma, por asnjeri nuk i vinte re dënesat e saj.

«Kështu ndodhka në këtë botën tonë të vogël, mendoja vetë me vete, ngjarjet u përtërikan në sytë e çdo brezi.»

— Të mallkuemit, — tha Hana me zë të lartë, si të

zgjohet nga një ëndërr e frikshme. — Nuk na lanë kangët t'i këndojmë në vatrën tona. Dëshën edhe dritën të na e vrasin, edhe arat të na i lanë shkretë. Dëshën me uri të na mundin. Edhe vijat e ujit të mos bien kurrë ma në arat tona. E kush ka dashë të punojë tokën e kanë gri me gra e me fëmijë!

— E toka asht jona tash sa mijë vjet, — tha mixha.

— Veç nuk paska dashë vetëm ujë, vëlla.

— Asht ngopun me gjak, Hanë. Uji e ka rrujtë nga thatësina e gjaku nga armiqtë.

— Dushmani donte të na i ngulte thonjtë në fyt e na i ktheu vatrën në shkumb. Baltë e pleh. Gra e fëmijë të ngarkuem nëpër shi e borë, që sillen si patat në mjegull nëpër udhët e Kosovës. Dita natë nga tymi dhe nata ditë nga flakët. Jemi shty deri ku nuk mban ma njeriu i gjallë. Na plaçkitnin ditën për diell e natën pa hanë. Krisma e armëve ndigjohet në pishë të diellit dhe kufomat i shqyenin natën qentë, që vërtiten nëpër terr. Habitej hasmi, se si vdisnin gratë, së bashku me fëmijët, në heshtje, pa thanë kurrë një fjalë, pa lutje pa rënkime, — tha Hana tashmë e ngritur krejtësisht në këmbë, si ta digjnin përbrenda kujtimet.

— Ju kam sjellë diçka të bukur për këtë festë, — e ndërpreu Hanën motra Hedije.

Të dy pleqtë u kthyen nga ajo, si të vinin nga një botë e tejlargët, si të dilnin nga errësira në dritë.

— Paj, diçka po jetojmë ne të vjetrit me rininë tonë, Hedije. Kështu ndodh me pleqtë. E mbajnë kryet pas, — tha mixha.

— Ju kam sjellë këtë orë, — tha përsëri ime motër.

Mua më gufoi shpirti nga krenaria. «E dashura ime Hedije», mendova.

U ngrit mixha, iu afrua orës e po e shihte me sy të picërruar, sikur nuk mund ta besonte.

Të dy pleqtë thanë me një gojë: «Ora e Isës!»

Kështu ishte ime motër, nuk do ta duronte gjatë thatësinë e shkretinë e dramave të hershme. «T'i lëmë në një anë tragjeditë, thosh, t'i lëmë në shekujt e vjetër,

jeta jonë është e gëzuar e ndritun.» «Ne i lamë, po nuk na lanë ato», i përgjigjesha.

Kur ishim të vogla e Hana rrinte shpeshherë fare-ve-tëm, me gjithë dashurinë e dëshirën që kisha, nuk i hyja dot në thellësi të mendimeve. Gjithnjë më dukej pak e çuditshme Hana, me atë lotin që i rrëshqiste nga sytë, kur i futeshim ne të dyja, si dy zogj, nën krahë e kërkonim mbrojtje prej saj. Hedija i thoshte me zërin e ëmbël fëmijor: «Mbaji thytë mbyllur, Hanë, e unë po të them ç'do të dëshiroja më tepër tani.» «Hajde, moj thuthuqja e Hanës», i thoshte ajo duke ia lëmuar flokët e loti rrokullisej nga syri e nuk e di se ku humbiste. E ajo qeshte e qeshte e gëzuar me magjitetë e Hedijes.

Edhe kjo orë, në këtë çast, po më dukej si ato magjitetë e dikurshme të fëmijnisë sonë e po e vështroja time motër me sy të ndritur.

— Si mundi të bjerë në dorën tande, Hedije, — e pyeti Hana pas pak.

— Ma solli një shoqe, për t'ia çue Xhemë sahatçiu, — tha ime motër. — Kur shkova t'ia merrja orën, Xhema më tha: «Paj, pse tallesh me plakun, çikë?»

«Përse, baca Xhemë?» — e pyeta.

«Për këtë orë më the se asht e tjetërkujt, e po na dalka se qenka jueja, e Boletinëve. Po Xhema për Isën kishte me i qorrue sytë e ballit, e do ta rregullonte këtë orë!»

«Baca Xhemë, po më çudit, i thashë. Orën ma kanë dhanë për ta rregullue vërtet, E kanë ndigjue emnin tand të mirë. E kanë ditë se je miku ynë!»

«E gjithë jeta ime pak ka vleftë, po shihe, bijë, si po punon si dikur, kur e ka mbajtë baca», — më tha Xhema me sytë e lotuar. «Nuk e kam ditë, baca Xhemë, iu përgjigja sinqerisht, — vijoi Hedija, — po do ta marr vesh si asht puna e kësaj ore.» Dhe shkova te shoqja ime. Mësova që ishte e një kushërirri të saj, fshatar nga rrethi i Tiranës. Ja ku është shkruar në kapakun e orës: «Isë Boletin, për kujtim.»

— Rrugë të gjatë paska ba, — tha mixha, — rrugë

bukur të gjatë. Ia kanë grabitë tek ura e Podgoricës, po edhe grabitësi, siç duket, asht vra nga një shqiptar, babai a gjyshi i atij fshatari tiranas. Rrugën e shpagës paska ba kjo orë, Hanë. Shtegtimin e hakut paska ba, motër, derisa erdhi te ne, — përsëriste mixha me flokët e bardhë, ngritur si eshkë përpjetë. Nuk duroi dot dhe hoqi plisin nga koka. Nuk po mund të ulej më nga tronditja.

Në dhomë ra heshtja. Dëgjohej vetëm tiktaku i orës. Ora e Isës kaloi dorë më dorë, derisa u kthye përsëri te Hana, që nuk po ua ndante sytë akrepëve. E tiktaku i orës, si tiktaku i zemrës, trokiste fort në shurdhimin e Hanës së Boletinëve, si të donte të pyeste; si është e mundur, të kalonin gjashtë dekada, që nga krismat e Ribnicës e deri më sot, që ajo ishte takuar me Isën në gur, bacën, që nuk mund të fliste dot më kurrë, veçse nëpërmjet gurit, ndërsa ajo orë të rrihte e të rrihte, si të qe zemra e tij?

Portreti

Ne u takuam papritur. Skulptori ecte me rrëmbim dhe gati sa nuk po rrokullisej drejt meje. Pyeti për Hanën.

I tregova për vizitën që kishim bërë së bashku në ekspozitë. Skulptori dëgjonte në heshtje me atë kokën si të luanit e ballin e gjerë të përshkuar nga brazda të thella. Lëvizte duke u lëkundur pak mbi këmbët e gjata, si të donte të mbante drejtpeshimin. I pëlqente të të shihte gjithnjë në sy. Era luante me flokët e ashpër të pashtruar. Duart e fuqishme me muskuj dhe damarë të kërcyer, si të të gjithë njerëzve që merren me punë të rënda fizike, nuk dinte ku t'i shpinte, thua jse i rëndonin. Mendoja nusen e tij të brishtë. Siç duket, katallanët e nuset e brishta gjejnë diçka që i tërheq drejt njëri-

-tjetrit. Skulptori ishte si një shkëmb i rëndë, kurse ajo si ato lulet, që rriten në shpatet e mbrojtura nga era.

— Të kërkoja në telefon, — tha skulptori. — Nuk u përgjigj njeri të ju.

— Nuk ka njeri në shtëpi, — thashë.

— Duhet të bëhesh gati, nuse.

— Ti do të më thërresësh nuse edhe kur të plakem fare.

— Atëherë bëhu gati për rrugë, nuse!

— Ku?

— Në Kosovë.

Skulptori ishte miku ynë i vjetër. Mendova se po bënte shaka. Brenda vetes e kisha dëshiruar atë udhë. Jo e pata dëshiruar, por e prisja me padurim një lajm të tillë.

— Mos u tall.

— Ti e di që nuk tallem.

Skulptori nuk ishte kujdesur vetëm për jetën e Isës, por për gjithçka që kishte të bënte me historinë e dhimbshme e të përgjakshme të tokës që e kishte rritur. Ai ishte bërë i afërt për Hanën e për të gjithë ne. Po e vëreja me kujdes. Ai, biri i Jugut, ashtu si edhe babai im dikur, ashtu si edhe unë tani, në njëfarë mënyre ishim lidhur në një mijë fije, që nuk mund të ndaheshin. Do të shkoja me të vërtetë në Kosovë. E kisha dashur atë udhë, nëse dikur do të shkoja. Do të veja në vendin që e mendoja shumë larg, po aq sa dhe afër, si të gjitha kujtimet, të gjitha historitë e kullës së vjetër me plagë.

— Përse hutohesh, nuse?

— Nuk po hutohem, — thashë, ndërsa kundroja skulptorin. Kur vinte në shtëpinë tonë, skulptori hynte pa druajtje drejt e në studio dhe menjëherë fillonte nga debatet me Miroshin. Ishte i ashpër aq sa ishte edhe i drejtë. Nuk tërhiqej kurrë.

— Në qoftë se Miroshi nuk vjen këtë herë të të përcjellë, do ta gjobitim, — tha.

— Këtë herë do të vijë, do të vijë patjetër, nuk do të na dërgojë telegram, si atëherë.

— E megjithatë ai ishte një telegram i bukur, — tha skulptori. — *Sonte do të dëshiroja më tepër se kurdoherë të isha pranë teje. Të dua shumë, Miroshi.*

Qesha.

— Miroshi është i vetmi për këto.

— Edhe ti, Drinë, edhe gruaja ime, jeni me të vërtetë «goca» të mira. Nuk merreni me çikërrima. E përveç të tjerave, ju pëlqejnë të papriturat.

— Faleminderit!

— Përveç tablosë së Shotë Galicës, do të vijë edhe portreti i rilindëses sate në Kosovë me Ekspozitën e Lidhjes së Prizrenit. Do të udhëtojnë së bashku, — tha Skulptori.

E ndjeva se po skuqesha,

— Hajde tani, lëre modestinë. Është një portret i mirë, ndofta nga më të mirët, — tha skulptori, — e ti e di që unë s'i kam qejf komplimentet. Mirupafshim!

E ndoqa me sy.

Skulptori ecte me rrëmbim mes turmës së njerëzve.

Portreti i mësueses më pati munduar një kohë të gjatë. Ai nuk erdhi ashtu krejt rastësisht. Më frymëzoi mësuesja ime e filllores. Mësuesja më e dashur, që më nxiti pastaj për të hyrë në arkiva, ku mësova aq hollësi «bukur të gjata», siç thoshte Hana, nga jeta e mësueseve të tjera të para. I gjeta ato mësuese vajza të reja, të druajtura, veshur me fustane me jaka të bardha, tepër të thjeshta e tepër serioze.

I mbusha edhe unë bllloqet e mia, jo vetëm me skica, por edhe me këto mendime, shkëndija që ua ndritin sytë mësueseve, tashmë të plakura, me flokë të rralluar, me buzë të holla e përsëri me një zjarr brenda, që i ngroh-

te deri në pleqërinë e thellë. Në bloqet dhe skedat nuk kishte më vend. Ecja midis njerëzve me një ndjenjë të thellë e të bukur.

Më dukej se mendimi kishte pasur nevojë për një nxitje që më shpuri deri te portreti i mësueses. Dikur, kur punoja për të, nuk dija se si ta emërtoja. Pastaj mendova që emërtimet nuk kanë rëndësi, ato vijnë më vonë. Fëmijëve nuk u vënë emra pa lindur. Kisha punuar pa u ndalur për atë krijim, punova me vrull, që ai më në fund të arrinte të jetonte «i pavarur», krejtësisht i pavarur nga unë. Portreti i mësueses sime kishte diçitoren «Rilindësja e fundit».

Ecja midis njerëzve në Sheshin e Madh.

Ecja dhe shikoja fytyrat. Kapja me bisht të syrit nuanca: lëvizjen e një krahu të zhdërvjellët, forcën e një trupi të hedhur, delikatesën e një vështrimi ëndërrimtar.

Sa më thellë kam hyrë në jetën e të tjerëve, aq më e pasur jam bërë vetë, aq më të bukura më duken perëndimet e diellit në Tiranë, Në sheshin «Skënderbej» një turmë zhurmëmadhe, e bujshme e gazmore, djemsh e vajzash të veshura në purpur, merrnin diç nga nuanca e perëndimit. Muzg, që kryqëzohet fluturim në vështrimet e syve, që u jep aq hijeshi e fshehtësi bredhave përgjatë trotuareve.

As që e prisja ta takoja pikërisht aty mësuesen time.

— Drinë, bija ime!

Ktheva kokën dhe e ndjeva fare pranë, si të më çikte frymëmarrja e lehtë e mësueses së vjetër, mbledhur në pallton e rëndë blu, pakëz e kërrusur e me flokë të bardhë.

— Kam një copë herë që po mendoja për ju, — thashë e gëzuar, duke ia shtrënguar dorën e vogël. — Qenkeni shumë mirë me shëndet.

Më kishte shtrënguar malli për ata flokë krejt të bardhë. Ajo më kishte mësuar të vëreja të bukurat që të befasonin në çdo kënd të Shqipërisë. Ato më kishin hyrë në zemër, qysh kur ajo grua i kishte flokët të zez, që bënin një kontrast të thellë me sytë e kaltër. Këtë e ki-

sha shkrirë në portretin e saj. Kisha ruajtur në kujtesë ata flokë të dendur, që ajo i mblidhte përherë pas pa vëmendje e kujdes të veçantë.

«Kur isha e vogël si ju, të dashur fëmijë, dashurinë për vendin e ndieja në strofa. I këndoja Shqipërisë së Naimit, «Ku dita është tjetër ditë, e nata tjetër natë», e zemra më rrihte plot lumturi, se Shqipëria për mua qe vjershë, melodi. Pak më vonë, Shqipëria qe flamuri, flamuri ynë i bukur kuqezi. Ishte ditë e shënuar në një kohë robërie dhe unë e shtrëngova fort në duar. Oh, sa më dhimbshin. Po ç'kish më të shtrenjtë?»

Flokët dukeshin si argjend i kulluar. Doja t'i thosha që portreti i saj do të nisej për rrugë. Do të nisej së bashku me Isë Boletin, Shotë e Azem Galicën, Bacë Bajramin dhe bashkëluftëtarë të tjerë të vjetër të njëqind viteve të shkuara.

Ecnim në muzg në sheshin «Skënderbej» pa folur, me ndjesinë e ëmbël të asaj mbrëmjeje, që po zbriste e qetë dhe e madhërishtme mbi kryeqytet.

— Është një mbrëmje e rrallë, — tha mësuesja.

— Shumë e bukur, — iu përgjigja.

— Edhe ti po më dukesh shumë e gëzuar sot, — tha mësuesja.

— Kam një lajm të bukur. Një lajm që do t'ju gëzojë edhe ju. Do të shkoj bashkë me Ekspozitën e Lidhjes së Prizrenit në Kosovë.

Mësuesja ndali hapin. Më zuri lehtë për krahu.

— Do të vijë edhe portreti juaj, — i thashë. Heshtëm për një kohë të dyja. Kur po ndaheshim, mësuesja pëshpëriti me zë të ulët, si të kishte frikë se mos prishte mrekullinë e atij çasti.

— Do të dëshiroja të kisha diçka, që rritet në atë tokë të shtrenjtë.

— Lule. Lule nga malet, ku ka luftuar Shotë Galica, — iu përgjigja, ndërsa ia shtrëngoja duart fort. Sytë e mësueses ishin të përlotur.

Prishtina pati hyrë në jetën time shumë kohë më parë se të vinim këtu, përpara se të ndaleshim në atë stacion, përpara se ato vajza të vogla gjimnaziste me bluxhins të çuçuritnin në buzëmbremje duke krehur flokët nën një llambë neoni, në një pasqyrëz që qarkullonte nga njëra dorë te tjetra. Pati hyrë përpara se të lexonim reklamën në çdo kilometër, në natën që po bin-te: Hotel Grand Prishtina.

Prishtina të befasonte me formën e saj të zgjatur në hapësirë, që sa vinte e lartësohej.

Skulptori shtyu derën e makinës dhe zbriti i pari.

— Është një pamje që të sjell ndër mend...

— Durrësin, — tha Bujar Rugova. — Edhe unë, kur e kam parë Durrësin për herë të parë, kam kujtuar Prishtinën.

— Me një ndryshim, — tha skulptori.

— Durrësi rrethohet me detin, kurse ne me fushën e Kosovës, — tha përsëri Bujari.

Prishtina kishte hyrë në jetën time, ose më mirë një natë e qiellit të saj, e fushës dhe e tokës së saj, ishte ngulitur përgjithmonë tek unë e afërt dhe e largët njëkohësisht.

— U lodhët, shoqja Drinë?

— Disi.

— Është udhë e gjatë e më vjen keq që nuk po mundemi ta shohim fushën e Kosovës, — murmuriti Bujar Rugova, pasi mbylli derën e makinës me tërsëllem.

— Nesër, — tha skulptori. — Nesër.

Kishim thuar se gjithë ditën në udhëtim.

Mëngjesi na pati bashkuar në brigjet e liqenit të Shkodrës. Liqeni ishte në atë ngjyrën e plumbtë, ngjyrën e fjetur, të përgjumur të ujërave në fund të verës

e në fillim të vjeshtës, kur nisin shirat. Shavaret e shëlgjet përkulnin ballin. Zogjtë e vonuar iknin të trembur në shtegtimet e largëta. E ne, qëndronim në kufijtë e tokës, me ngarkesën e çmuar në kamionin «Albania», përballë njëri-tjetrit.

Shiu na pengonte të shihnim fytyrat. Ai binte si të donte ta bënte më të gjatë hapësirën e shkurtër, ku hidhnim hapat drejt njëri-tjetrit, mbushur me atë ndjenjë të thellë, të afërt, e të lashtë, si jeta e ngurtësuar në kamionin «Albania».

Ishte e pamundur ta fiksoje njeriun te vija e kufirit nën atë rrjetë të dendur shiu. Fytyrat rrëshqitnin nëpër ujë si shatore të ngujuara. Vetëm kur u afruam fare pranë e kur kaluam vijën e kufirit dhe shtrënguam duart e njëri-tjetrit e dëgjuam belbëzimin e emrit Bujar Rugova dhe Azem Prizreni, vetëm atëherë menduam se do të ishim po aq të zbehtë sa ata e po aq të lagur nga shiu e të malluar.

Azemi zgjati dorën pa shtuar asnjë fjalë.

Më pëlqejnë njerëzit e heshtur, që nuk e zbulojnë veten brenda një çasti, që të mundojnë sadopak me heshtjen e tyre.

Në sytë e Bujarit kishte diçka nga liqenet e kulluara malore, mbushur me lulet e tejdukshme.

Ndoshta të dy palët ishim sforcuar në buzëqeshjen tonë të ngrirë.

Në buzë kishim shumë për të thënë nga malli i një-qind vjetve të shkuar nën një strehë, duke pritur të pushonte shiu.

Azemi e ngiste makinën i heshtur. Kisha pasur aq kohë, sa ta ndieja të afërt atë burrë të heshtur, më të heshtur se një gur varri, me një emër aq të dashur për mua.

Kur isha fare e vogël, kisha ëndërruar për një djalë me emrin Azem, që e shpëtoi tim atë nga vdekja dhe e sollti të të gjallët, te ne.

Skulptori këndonte me zë të ulët, i shoqëruar nga Bujar Rugova.

Kënga kumbonte si e habitur në kubenë e makinës, përplasej nëpër xhama dhe dilte e lirë e fluturonte në hapësirën e mbrëmjes së përmallshme.

Këngët ishin të lashta dhe rridhnin njëra pas tjetrës. E dija që skulptori ishte këngëtar i këngëve të Jugut, dija që ishte i pari në sofra tek kthente ndonjë gotë, po nuk e merrja me mend se dinte aq shumë këngë kreshnikësh, aq këngë për fatosat e Kosovës:

*Kaçanik, ty të raftë pika,
Nuk po din se ç'asht frika,
Shtatë sahat tu u therë me thika,
Shtatë sahat me thika n'dorë.*

— Po ju, shoqja Drinë, nuk dini të këndonni?

— Nuk i di të gjitha këto këngë.

Makina ecte me shpejtësi. Muzgu dendësohej. Reklamat: Hotel Grand Prishtina u bënë më të shpeshta. Në një stacion autobusi djelmoshat ngacmonin një grup vajzash ekskursioniste. Vajzat u ndalën e përshëndetën makinën me duartrokitje, shoferët e kamionit «Albania».

— Hana, gjyshja ime, e këndon përherë këngën e Rexhës, — thashë papritur.

— E dini historinë e saj? — më pyeti Azemi.

Ishte hera e parë që merrte pjesë në bisedë.

— Azemi është një thesar i pazbuluar, — tha Bujari.

— Mahitet, — tha Azemi.

— Jo, nuk mahitem. Vetë më ke folur për nënën gjakovare. Nuk e reshti dasmën, edhe kur e gjeti të vdekur birin e vetëm.

— Nuk e prish dasmën? — pyeti Azemi. — Po dasma ka qenë e shenjtë në këto troje. Nëna e dinte se krushqit ishin të lodhur e nusja vinte nga larg.

Ndërsa Azemi tregonte, mendoja për Hanën. Pikërisht aty, në atë kube makine, përbri tij, m'u duk se e zbulova shkakun përse e këndonte aq shpesh, edhe në shurdhimin e saj të plotë, ime gjyshe këngën e Rexhës:

*Po thotë nusja hyna e dola,
Kurrë një fjalë me Rexhën s'fola.*

Edhe Hanës i treti pa gjurmë një djalë në Luftën e Dytë. As emër, as varr nuk la. Nusja e re u kthye te të vetët. Hana nuk e përmendte asnjëherë të birin, dhëndër të padhëndëruar, as nënën time, nuse të panusëruar.

*More krushq, hani e pini,
Nesër Rexhën në dhé t'ma shtini.*

Zëri i ngrohtë i skulptorit, dilte drejt e nga shpirti. E ndiqte Azemi. Dasma dhe vdekja. Si ishin përzier kështu në këngët tona?

Nuk e di nga më erdhi edhe mua dëshira për të kënduar. Zërat, për çudi, shkriheshin me njëri-tjetrin.

*Çohu, Rexho, çohu, djalo,
Se s'ka nana tjetër-o.*

Azemi shkeli gazin e kerit të vet. Reklammat e Grandit tani fluturonin. Sapo filloi shiu, dritat e Prishtinës lundronin e thyheshin pas xhamave të makinës.

— Po ti këndoke bukur, — tha skulptori.

— Nuk jam shquar ndonjëherë.

— Po më çudit pak, — tha përsëri skulptori.

— S'e marr dot me mend, si e vazhdoi dasmën me gjëmën e një vdekjeje të tillë, — thashë.

— Vdekjen nuk do ta pranoni, sido që të na vinte, — vërejti skulptori.

— S'ke ç'i bën. Mund të vdesësh papritur nga një rastësi ose banalitet edhe ditën e dasmës, — tha Bujari.

— Ndoshta, po megjithatë kjo është tepër, është përmbi forcat e njeriut.

— Ashtu duket, — tha Bujari. — Po asgjë më njerëzore s'ka.

Po kundroja Bujarin. Megjithëse i ri, tregonte më shumë, për shkak të rrudhave të thella e të lëkurës së rreshkur. E kishte qëlluar të vërtetën me çiltërsinë e tij. Po më dukej krejt e gjallë ajo nuse e largët. E kërkoi, e priti dhëndrin në odën e nusërisë, e kurrë një fjalë me të s'e foli. E ku ta dinte, e ngrata, se dhëndri i bukur ishte i vdekur? E ku ta dinte, murgja, se dhëndërin po ia mbante të fshehur nëna, se edhe ai priste në heshtjen e ftohtësinë e vdekjes, ndërsa daullet e dasmës së tij nuk reshtnin atë natë?

— Nënata tona, — tha skulptori. — Duken të buta si prej pambuku, po zemrat i kanë gatuar me strall.

Shiu u dendësua papritur. Trokiste mbi xhamin e makinës i njëllajtë. Ujërat rrëshqitnin e krijonin arabeska, rrëkera gjarpëruese e lozonjare, që na turbullonin vështrimin dhe e mbulonin pamjen anash me avull, si të donin ta merrnin me vete, ta largonin e shpërndanin dhembjen që të gjithë e fshihnin me vështirësi, e mbulonin në hesh-tje të nderë, duke ndjekur lëvizjen e kamionit «Albania» me ngarkesën e çmuar. Ç'kishte qenë njëherë jetë, dashuri, luftë e një shekulli të tërë, zbriste në Prishtinë, nën atë shi, e materializuar në gur, në dru, në metal, në pëlthurë.

— Ja, erdhëm më në fund, — tha Bujari.

Në hollin e Hotel Grandit dritat të rrethonin me një belbëzim të vagët, të përgjumur, që dukej se binte edhe mbi lëvizjen e vazhduar të njerëzve. Ishin mbushur barret, sallat dhe kolltukët. Njerëzit hynin e dilnin indiferentë, të mardhur e të lagur, me përplasjen e lehtë të këmbëve. Tingujt e një orkestre ngjiteshin si nga nëntoka. Diku këndonte një grua.

— Nga koncerti në koncert, — tha Bujari.

Po koncerti në kubënë e makinës kishte diçka shumë të vërtetë, të sigurtë e intime.

— Koncerti ynë ishte më i bukur, — thashë.

— Kjo nuk luan, — vërejti skulptori. — Drina Gura-si është një grua e kursyer në lëvdada.

U ulëm në kolltukët prej meshini të zi në hollin e

rrethuar me mure mermeri. Prisnim Azemin të na regjistronte emrat në sportel. Dyqani përballë hotelit, apartamentet e ajo rruga e gjatë mbushur me njerëz të kërrusur nën çadrat, të ngutur, si në një vrapim, reflektoheshin në dyert e xhamta të hollit.

Përpiqesha të lidhja reklamën në çdo kilometër me Hotel Grandin e vërtetë, që më rrëmbeu me butësinë e dritave të ngrohta, me shkujdesjen e të rinjve, me ecjen elegante të nuseve paksa të lakuara, si luledielli, ndaj supeve të burrave të tyre.

Këtu do të keni rast të njihni ajkën e inteligjencies, — tha Azemi, thujse me bezdi, kur solli numrat e dhomave tona.

Morëm bagazhet dhe iu drejtua ashensorit.

— Mos ia vini veshin këtij eremiti, — tha Bujari. — Azemi e quan kohë të humbur ndenjjen midis njerëzve, në lëvizjen e pandërprerë të këtij hoteli luksoz.

Azemi qeshi pak i zymtë dhe tha:

— Më falni, po më pëlqen më tepër të tymos në shtëpinë time.

Ashensori na ngjiti në katin e gjashtë.

Ishte një natë pak e ndryshme nga të tjerat. Gjatë kohës që lëvizja nga një abazhur te tjetri, nga banja në dollapë, e nxirrja nga valixhja të gjitha çikërrimat që duhen vendosur kur vjen në një hotel, mendimet më ishin disi të shpërndara. Kërkoja t'i lidhja, por ato nguleshin me një qëndresë kryeneçe e nuk donin të shkonin në rrjedhën e zakonshme.

Pastaj shkudeshin si ata zogjtë shtegtarë të trembur, që nisen nëpër udhëtimet e largëta, pasi kanë humbur prijësin e tyre e përplasnin krahët pa drejtim, në hapësirën pa anë e pa fund.

Dhoma ishte e veshur me dru të errët e nga dritaret me perde të shkurtra vinin dritat e Prishtinës, të lagura në shi.

Në çfarëdo formash që të më shfaqej Prishtina, në sytë e mi ajo ishte e lidhur me atë ngjarje të largët të tetorit të vitit 1944, kur në një mbrëmje, në një apel,

e nxorën tim atë nga rreshti, bashkë me njëqind e katër djem të tjerë e i mbyllën në një barakë për t'i pushkatuar.

Shpesh më sillej mendimi, ishte trim apo frikacak im atë, që u iku gjermanëve nga thonjtë e vdekjes midis plumbave? Apo qe ashtu si përsëriste Hana, se «jetëgjati nuk u bëka kurrë jetëshkurtër»?

Im atë na e kishte përsëritur aq herë, se e shpëtoi jo vetëm guximi për t'u ikur plumbave, po një djalosh me emrin Azem. Ai e përcolli nga një shtëpi në tjetrën, me njerëz mikpritës, bujarë, deri në kufi. Im atë u kthye bashkë me lirinë, i tretur, i stërzgjatur, me atë histori të ngatërruar të ikjes nga plumbat.

«Këtu duhet të ketë shumë Azemë», thashë me zë të lartë, duke ecur e shkujdesur në tapetin ngjyrë bari, ndërsa krihja flokët.

Trokiti dera. U dëgjua zëri i skulptorit.

— Drinë, je gati?

— Ja edhe pak.

U veshja shpejt e shpejt e dola.

— U vonuam, — tha skulptori, — na presin për darkë.

— Edhe kjo darkë, nuk më hahet fare sonte, — thashë.

— Mban linjat ti, nuse e Miroshit, — u tall skulptori.

— Mos e pyet. Po ti si u rregullove?

— Jemi më të thjeshtë ne burrat.

Ashensori ishte i zënë nga një çift. Një djalë i paralizuar ulur në karrocë e një vajzë. Nuk desha të hyja, po skulptori as që e vuri re ngurrimin tim. U gjendëm të katër në ashensor. Vajza ishte e gjatë, shumë e bukur. Era e lehtë e parfumit, flokët e bardhë, si prej argjendi, bënë kontrast me djaloshin thatim, me ballë krejt të rrudhur prej plaku e sy të vegjël të plumbtë. Kur zbritëm nga ashensori, nuk e di pse pata dëshirë të ikja sa më larg e të mos e shihja kurrë më krekosjen e çupës me thonjtë me manikyr të kuq, shumë larg vuajtjes së

syve të të gjymtuarit, që ajo e rrotullonte në karrocë, si një mostër të rrallë.

Zbritëm në katin përdhes nëpër shkallët prej mermeri të zi. Në të majtë ishte bari. Rrëshqitas më zuri syri gruan, që këndonte me zërin e kumbueshëm kontralto, me një moshë dhe fizionomi të papërcaktuar.

Sapo u dukëm në derën e restorantit, Bujari u ngrit e na e bëri me dorë. Tryeza ku po na prisnin ishte përballë hyrjes kryesore. Një tryezë e rrumbullakët me karriget e larta me cohë të gjelbër.

Azemi buzëqeshi i ngujuar në heshtjen e tij.

Shiu nuk ndihej në Grand, veç në përplasjen e lehtë në xhama.

— A u çlodhët pak? — pyeti Bujari.

— U çlodhëm, — tha skulptori.

— Ju jeni lodhur më tepër, — thashë, ndërsa vështroja si dridhej dritëza e praruar, me një bardhësi qumështi, mbi serviset e karafilat e kuq ende të freskët, stërpikur nga pikat e shiut që rrëshqitnin ngadalë, si pika loti.

— Është udhë e vështirë malore, — tha Azemi, — po ne jemi mësuar.

— E dini ç'thonë për Malin e Zi? — pyeti Bujari.

— Thonë se atyre maleve të larta u është zgjatur qafa gjer në re, duke parë me zili fushën e Kosovës.

— Ah, kjo zilia! — tha skulptori.

— Zili e vjetër, shkatërrimtare, — tha Bujari.

E kaluam Podgoricën dhe malet e zeza gjithë mëngjesin e asaj dite. Male e qiell. Masiv i egër, i rëndë shkëmbor, që përshkohej nga hekurudha e thyhej papritur nga lëndinat e blerta. Nuk i kalova me sy mbyllur, si Hana dikur. Vëreja me vëmendje peizazhin e rreptë, me shtëpitë e ngulura të shpërndara nën mjegull, që dukej sikur rrëshqiste nëpër çatitë e pjerrëta. A thua pati arritur deri në atë lartësi gjëma e urës që Ribnicës dhe ato male nuk qenë turpëruar?

«Sytë m'u ferruen, dita u bë natë, nuk kisha dashë me e çue atë kob në Boletin», përsëriste mixha.

Po kryeqyteti i maleve të zeza dukej krejt i qetë. As i madh, as i vogël, me udhët e mbushura me njerëz, dyqane, me gra të veshura e të krehura bukur, sikur asgjë e keqe të mos kishte ndodhur asnjëherë e në asnjë vend.

Skulptori buzëqeshi lehtë, si të lexonte në sytë e mi gjithçka. Bujarin e kërkuan në telefon. Ai u ngrit, i gjatë, i zhdërvjellët, me lëvizje të prera, pak i përkulur. Kur u kthye, ishte shend e verë.

— Kush të kërkoi? — pyeti skulptori.

— Im bir, Lumi.

— Lumi është sugari i Bujarit, — tha Azemi. — Nuk rri dot pa bacën e vet.

— Sapo ishte ngritur nga gjumi e nuk shkulej nga telefoni, — tha Bujari.

Për një cast ra heshtje.

— Dikur kam pasur shumë shpresa të Bujari — ngaçmoi Azemi.

— Tani i ke bjerrë krejt? — pyeti Bujari.

— Jo krejt.

— Thuaje më mirë të vërtetën, bacë.

— E kam pasur edhe nxënës, — tha Azemi.

— Njëherë, pothuajse jemi prishur keqas, — tha Bujari.

— Nuk i kam pranuar një pikturë, — tha Azemi.

— E unë, vëllezër, jam hedhur deri në tavan nga idhnimi. Mendoja se e kisha kryevepër. E në Paris mund të paraqitesha me të. Dicka po e mendoja veten të rëndësishëm, derisa edhe nusen time do ta pyesnin gazetarët e huaj: «Si e ndieni veten ju, gruaja e një personaliteti?»

— Pse nuk thua se e pata gatuar një çorbë?

— Jo, përkundër, isha i bindur se ti, bacë, na paske mbetur shumë prapa. Jeta po ecte përpara me vrull e Azem Prizreni nuk do të mundej dot kurrë ta kuptonte pikturën moderne.

Azemi u ngrit të porosiste dicka. M'u duk se nuk i pëlqente të dëgjonte për grindjet e vjetra.

— Ju nuk mund ta merrni me mend sa fort ka qenë i

zemëruar me mua. Na duhet të shohim qartë, — ngulte këmbë, — qartë, si sheh edhe populli në artin e tij. Nuk i kemi bjerrë ende vlerat kombëtare, që të futemi në botën e tymnajave dhe të hiçit. Kemi nevojë për dritë e qartësi. Kemi nevojë t'i themi sa më hapur të vërtetat tona, që janë vetëm tonat e të papërsëritshme për një komb tjetër. Më mirë të mos i dalësh përballë në inat e sipër Azemit. Ja, po jua sjell vetë verën e famshme të Pejës. Azemi shtrëngonte në duar dy shishe me etiketën e Pejës. I hapi me lëvizje të sigurt dhe i mbushi gotat.

— Gëzuar, — tha.

— Gëzuar, — iu përgjigjëm.

— Veç ta dini, se nuk më ka bindur krejt Azemi, — tha Bujari.

— E, sigurisht, — tha Azemi. — Nuk kam mundur të të bind, megjithëse jemi grindur fort me njëri-tjetrin.

Nuk është e vërtetë, — tha Bujari. — E kam kuptuar plotësisht se ke të drejtë, kur më ka mahitë nëna ime. «Ç'asht ky tevat, more bir, a ban me ma tregue pak?» As Vjosa, as çunat s'kanë kuptuar gjë. Mirë nëna, që po tallej, po brezi i ri, brezi i arsimuar, përse po më shihte me ftohtësi? Gati-gati jam mbyllur në vete.

Zëri i Bujarit u dobësua. Vështronte ngultas, pa i shkëputur sytë, përballë. Ishte pak i zbehtë.

Nuk e di se si lexova tejpërtej në fytyrën e Azemit. Edhe skulptori edhe Azemi vështronin në të njëjtin drejtim. Ktheva kokën. Dera prej xhami ishte hapur krejt. Për herë të parë ndesha aq shumë djem e vajza të reja, të gjymtuar, nëpër karrocet e tyre, tek pinin verë, rrethuar nga këngë në gjuhën e huaj. Nuk e dallova asgjëkundi djalin thatuq e belbëzak. Ishin më tepër fytyra të lëmuara e të dhjamosura, të mbështjella nga tymi i dendur i cigareve. Ato fytyra, të gëzuara, të mbufatura, që luhateshin, qeshnin, argëtonin, të trishtonin pa masë.

— Ç'janë këta? — pyeta.

— Takimi i paralitikeve të të gjitha republikave të Federatës — tha Azemi.

— Qenkan shumë, — thashë.

Nuk ngurova shumë, rrëmbeva gotën e dytë të verës, që po më zgjaste Azemi.

— Mos u trishtoni kaq, — tha Bujari me zë të ulët. — Gjymtimi më i shëmtuar është ai që nuk shihet me sy, Nuk shihet deri në atë shkallë, sa vetëm kur e zbulon krejt papritur, nën një petk të ndritur a trup të përsosur gjithë atë kalbësirë, të vjen të klithësh nga habia: «Ç'je ti, njeri, apo kërmill?»

— Kërmill? — pyeti Azemi. — Kërminjtë, kur ecin, lënë vazhdë.

— E po t'i hapësh pak sytë, nuk ke përse çuditësh, gjurmët i gjen. Gëzuar, Drinë!

— Gëzuar!

— Kjo është një verë e jashtëzakonshme, — tha skulptori e më pa me vëmendje, që s'po ua ndaja sytë duarve të mëdha, të fuqishme, leshtore të Azemit, si të ishni diçka e veçantë, e shkëputur krejt nga ai.

— Nuk gjen askund si kjo verë, — tha Azemi.

— Do ta shpiem Drinën në Pejë, — tha Bujari, — e, siç duket, kemi një fat të mirë, — vijoi. — Drinën nuk e zënka makina, si nusen time.

— Nusen time e zë ashensori, bile edhe makina qepëse — qeshi skulptori.

— Ja, më në fund e nxori kokën edhe nusja, më parë se vajza. Kjo do të thotë se të mori malli, — i thashë skulptorit.

— Mos mbetshim kurrë pa mallin e nuseve, — tha skulptori. — Sa fëmijë ke ti, Azem?

— Pesë, — tha Azemi.

— Ndërsa unë kam tre djem, — tha Bujari.

Ne me skulptorin buzëqeshëm.

— Tani do të dalim të turpëruar, — thashë.

— Pse?

— Sepse që të dy kemi vetëm nga një, — tha skulptori.

— Edhe ju?! — pyeti i çuditur Azemi. — Mos, bre burrë.

— Këtë sakrificë nuk do ta pranonte asnjëri nga ne. Dhe në radhë të parë gratë tona, — tha Bujari.

«Hana, mendova. Hana ime përsërit: «Kemi gjallue mbi vdekjen, sepse nuk i kemi lanë kurrsesi djepet shkretë.» E ç'do të ishte një vënd, një vënd i vogël, po të mos kishte nuse trime, që do të sillnin në jetë shumë sokola e sokolesha?»

— Unë i kam tre, — tha Bujari, — po me Lumi nuk vë asnjërin.

— Lumi bën vjersha, — tha Azemi.

— Eshtë një bejtexhi i vogël, dhe unë mendoj se do të bëhet mbledhës folklori.

— Jo, — tha Azemi, — Lumi yt do të bëhet poet i vërtetë.

— Paska edhe emër të veçantë, — thashë unë.

— Emrin ia ka vënë e ëma. Ajo deshi që Vjosa të kish edhe një Lumë.

— Vjosa e paska emrin nusja juaj?

— Kur të takoheni ju të tre: Lumi, Vjosa edhe Drina, merre me mend se ç'do të bëhet, një përmbytje e tërë, — tha skulptori.

— Këtë vit kemi qenë bashkë për pushime, — tha Azemi, — dhe Lumi donte të dinte saktë a ka qenë Azem Galica «trim me fletë», siç thoshte kënga. Unë kam lindur shumë vite pasi ka vdekur Azem Galica e nuk e kam parë, i thosha. Po Lumi nuk donte të bindej. Nënë Vjosa më ka thënë, se nuk e ka marrë vesh kurrë armiku se ka vdekur Azem Galica. Se ai s'mund të vdesë kurrën e kurrës.

«— Po, Lumë, ashtu është.»

«— Atëherë, përse nuk ma keni vënë emrin Azem, — i kthehej ai Vjosës, — po Lumë?»

«— Sepse jeta e njeriut nuk është gjë tjetër, veçse një lumë, një lumë, që derdhet në detin e madh,» — i shpjegonte Vjosa.

Ishte hera e dytë që Azemi fliste gjatë.

— I ka flokët të verdhë nusja juaj? — e pyeta Bujarin.

Papritur ai qeshi.

— Përse pyesni kështu?

— Nuk e di përse e mendoj një grua të imët, me flokë të verdhë, po të verdhë vërtet ama.

Kjo bisedë e gëzueshme, e çliruar, hyri atë mbrëmje midis nesh, siç vijnë përherë bisedat për nuset e fëmijët, si të donte të zbuste përshtypjen e rëndë të të gjymtuarve.

— Ekspozitën do ta vendojmë në Pallatin e Rinisë, — tha Azemi. — Sallat janë gati dhe forca kemi mjaft.

— A do të mbarojmë nesër në mëngjes? — pyeti skulptori.

— Do të mbarojmë.

— Nesër është e diel, — tha Bujari, — dhe Drina do të shohë fushën e Kosovës.

— Do të vijnë edhe nuset tona, — tha Azemi.

2

Gjithë mëngjesin punuam në Pallatin e Rinisë për ekspozitën. Padurimi e gëzimi plekseshin dhe ndieja një lehtësi e frymëzim të çuditshëm. Përherë kam kërkuar njeriun. Kërminjtë, që thoshte Bujari, jo se nuk i shihja, por isha krejtësisht indiferente, si të ishin, si të mos ishin. Për këtë shpesh bënim debate me skulptorin, që e quante të metë të punës sime. Njeriun duhej ta shihja ashtu si ishte.

«E keqja nuk më çudit aspak», — thosha.

«Po të mëson ta dallos të mirën, që të bëhet më e mirë, — ngulmonte skulptori. — Njeriu është i ngatërruar, shpirti i tij me dufe. Ndonjëherë njerëz shumë të butë bëhen agresivë, për të ruajtur veten, për të mos zbuluar dobësitë e tyre.»

Atë mëngjes ishim të lodhur deri ku s'mbante më.

Skulptori vërtitej qull në djersë, nga njëra sallë te tjetra. Kur çdo gjë zuri vendin e vet, sallat morën jetë e u mbushën me ngjarje e burra të vjetër, të njëqind vjetër, që kuvendonin me emrat e tyre të njohur.

— Histori që flet, — tha Bujari.

— Lidhje e pavdekshme e burrisë dhe besës shqiptare, — tha Azemi.

— Kanë dashur të na e hedhin historinë njëqind pashë nën dhé, — tha Bujari.

— E vërteta dalka, po qafa t'u zgjatka, përsërit ime gjyshe, — thashë.

— Tani që e kryem punën tonë, s'na mbetet veç një dush i mirë e vrap e te tyrbja, — tha skulptori.

— Kur t'ju presim? — pyeti Bujari.

— Pas gjysmë orë, — tha skulptori e pa nga unë.

— As më pak, as më shumë, — u përgjigja duke qeshur me vete. Pallati i Rinisë ishte afër Grandit e ne shpejtuam. Kur zbritëm në holl, pas gjysmë ore, Azemi e Bujari po na prisnin me gratë e fëmijët. E nioha menjëherë Viosën e giatë, me flokët e qelibartë, të mbledhur pas dhe Lumin e vogël.

Azemi erdhi i pari drejt nesh.

— Nusia ime, Myrveti, — tha.

Myrveti kishte një trup të bukur e sy të mëdhenj të hirtë. Flokët e errët gështenië e zbehtësia e teidukshme e fytyrës, bënin kontrast me zërin e gëzueshëm rinor. E megjithatë brenda saj ruhej një brengë e thellë, fshehur me kudes.

— Vaiza ionë, Besa, — tha Azemi.

Besa zgjati dorën e druaitur. Qeshi, e fytyra i mori dritë nga gropëcelet që iu thelluan.

— Ishte e pamundur të shkëputeshe prej saj, — tha Myrveti, si për t'u shfajësuar.

Besa pa nga ata, me sytë e mëdhenj e të zinj. Azemi i buzëqeshi. Besa u gazmua. «Falemnderit», — thoshte çdo lëvizje e saj. Edhe gërsheti i trashë, i rëndë, u lakua nga lëvizja e kokës.

Vjosa e Lumi kishin mbetur pak më pas. Shpejto-

va drejt tyre. Lumi nuk po na i ndante sytë e mençur e të menduar, si të një djali të rritur.

— Siç e shihni, miqtë e mi, — tha Bujari. — ky është sugari im, lum Lumi. — Vjosa lëvizi dorën, si për të thënë: «Po ia rrit veshët.» Bujari e pa me një vështrim gazmor: «Mos u mërzit, e dashur, nuk do t'i kaloj kufijtë.»

Nuk ishte e bukur Vjosa, po kishte aq mençuri e finesë në të gjitha tiparet e saj, në mënyrën e sjelljes, sa të bënte për vete.

— Nisemi? — pyeti Azemi.

— Menjëherë, — tha skulptori, që e ndiente veten ngushtë në prani të femrave.

— Me mikrobusin e shoqatës do të shkojnë gratë e fëmijët, — tha Bujari.

Mezi po prisja të shihnim, ditën për diell, ç'na mbuloi e fshehu muzgu e shiu i mbrëmshëm.

Hymë në makinat tona dhe u nisëm.

Prishtina dukej atë mesditë pakëz e hutuar, nga ke-rët me flamuj, që përcillnin nuset nëpër rrugët e saj. Kishte atë qartësi të tejdashme, që kanë qytetet pas shiut, kur ngjyrat bëhen më të rrepta e më të kthjellëta.

— Qenkan shumë të bukura! — thashë.

— Cilat? — pyeti Myrveti.

— Po ja, këto nuse me flamurë.

— Nuset gjithmonë janë marrë me bajrakë këtu, — tha Myrveti.

— Edhe ti, Vjosa, me Bujarin, ke qenë nuse me bajrak?

— E si mund të isha ndryshe? — tha Vjosa.

— Kur e kam parë në vallen e Rugovës, në festivalin folklorik të Gjirokastrës, më është dukur simbol i hershëm.

— Nuk është vetëm një simbol i hershëm, është e vërteta jonë e përhershme, derisa gjallojmë në këtë dhë, — tha Vjosa.

— «Kosovës, së gjerë/ ballit tënd të lavruar/. Floku i kalliu hidhet si flokë vashe/ Ndër logje të saj, thonë ha-

pin e ke të erës/ Ndër ara të saj, thonë duart i ke të gurit», — thashë me zë të lartë.

— Ditkeni përmendësh vargje të poetëve kosovarë? — pyeti Vjosa.

— E dua poezinë.

— Edhe ne, — tha Vjosa, — e duam tepër. Gjimnazistët e mi dinë pa u ndalur vargje të Naimit, Nolit, Migjenit, Mekulit e Podimjes, Kadaresë, e Agollit.

— Edhe Lumi im di shumë vargje.

— Në ç'klasë je, Lumi?

— Në klasën e dytë.

— E po doemos që di shumë, — thashë.

Lumi buzëqeshi, po nuk u përgjigj. Në përgjithësi fëmijët flisnin pak e dëgjonin shumë. E kjo po më dukej një veti e bukur. Nuk më pëlqejnë ata prindër, që i paraqitin fëmijët si paragaj e që flasin vend e pa vend, për të dëfryer të tjerët, me zgjuarsinë e tyre të rrallë.

— Thuaje një vjershë, Lumi, — i thashë.

Lumi pa nga Vjosa. Ajo buzëqeshi e ia bëri me kokë, «po».

— Do të them vjershën e shokut të babit, xhaxhi Sabriut, — tha Lumi, e sytë i morën flakë e i ndriçuan si llamba të vogla.

Me miken mbjellim lule në ballkon,

I ujitim përditë me ujë të kroit,

Vogëlushi t'i mësojë emrat e tyre.

Ky është kopshti më i lartë.

Në katin e pestë.

Shiu bie mbi lulet në fushë,

Kur vjen vera e pjekur nga dielli,

Ne u japim luleve pushim,

E mbledhim plaçkat për në det,

E duartrokitëm Lumin me gëzim. «Të lumtë, bukur, Lumi!»

— Edhe Lumi, si babi i vet, e do shumë detin, — tha Vjosa.

— Besa më ka mësuar të notoj, — tha Lumi.

- Po ti, Besa, në ç'klasë je?
- Në të tretën gjimnaz.
- Është nxënësja ime, — tha Vjosa.
- Nuk ngopesha së pari fytyrën e bukur e të pastër të Besës, me trupin e hedhur e të formuar mirë.
- Merresh me sport? — e pyeta.
- Besa u skuq.
- Është basketbolliste, — tha Myrveti.
- Duket.
- A e dini se ç'ëndërron gjithë kohën? — pyeti Myrveti.
- Nënë, të lutem, — tha Besa e me një lëvizje të shpejtë të shpatullave e hodhi gërshetin e rëndë para e filloi ta shturte me duar të dridhura.
- Të vijë në Tiranë me skuadrën e saj, — tha përsëri Myrveti, pa u tërhequr aspak nga vështrimi qortues i së bijës.
- Sytë e Besës u turbulluan.
- Po kjo është krejt e natyrshme, — thashë, — përse mërzhitesh, Besa?
- Besa ishte bërë flakë. E përqafova dhe ndjeva zemrën e saj të trokiste rrëmbimthi.
- Ne do të jemi që të gjithë nesër në hapjen e ekspozitës, — tha Myrveti, për të kapërcyer mallëngjimin e së bijës.
- Baca Azem është gëzuar tepër, — tha Besa, me sytë që i shkëlqenin.
- Edhe ju i paskeni do punime në të, — tha Myrveti.
- Bujari më foli për një tablo të Shote Galicës, — tha Vjosa. — E keni pikturuar dadën kur varros Azemin. E Lumi im tash do të kërkojë t'ia ndërrojmë përsëri emrin.
- Jo, — tha Lumi, shumë serioz. — Po baca Bujar, kujt t'i thotë pastaj lum Lumi?
- Unë ju kam kuptuar krejt, — tha Vjosa. — Dikujt po i rëndon emri e dikujt po i ndrydhet shpirti, kur e di se sa e ka shtrënguar zemrën Shota ta lëshojë burrin nëpër honet e Perçevës. Bujari ka qenë në zhvarrimin e eshtrave të Azemit.

— Sa vajza keni, Myrvet? — e pyeta për të ndërruar bisedë.

— Pesë çika, — tha Myrveti, disi me dhimbje në fytyrë.

— Të të rrojnë!

— Të rrojnë, — tha Myrveti, — po nuk e fsheh dot se për të pestën kam qarë me lot të hidhur.

— Jo, — tha Besa. — Mos thuaj se ke qarë, nanë, thuaj se je dëshpëruar.

— Po, — tha Myrveti. — Nuk e fsheh. Azemit nuk i ka qëlluar vëlla.

— Kur ka lindur motra e vogël, nana sa nuk ka dekë, — tha Besa.

— Kjo është e tepërt, — thashë.

— Ndoshta, — tha Myrveti, — ju keni të drejtë. Po unë nuk e shkul dot nga zemra hidhërimin tim. Kjo as nuk varet fare nga unë. Po djalin do ta ketë Azemi, sikur ta di edhe që të vdes.

— Jo deri këtu, — thashë. — Nuk do të kishte kuptim, Myrvet.

Më në fund arritëm te kodrina ku ishte tyrbja e sulltan Muratit të Parë. Kisha lexuar kronika osmane për betejën e Kosovës 1389. «Para se të fillonte beteja, doli Sulltani së bashku me të birin, shkruanin kronikanët. U hipën kuajve e nga një vend i lartë (a thua ishte kjo kodër?) vëzhguan ushtrinë e të pafeve. Ata panë se fusha tejprtej ishte mbuluar nga ushtria dhe nga numri i ushtarëve nuk dukej sipërfaqja e tokës. Ata ishin të pamundshëm, ishin krejt si një mal prej çeliku. Sulltani u habit. Filloi sulmi. Më në fund dy dete u përplasën njëri me tjetrin. Shpatat vringëllinin dhe shkëlqenin si vetëtima, aq të shumta ishin ushtat, sa era nuk mund të depërtonte midis tyre, aq të dendura ishin këmbët e kuajve, sa edhe lumi nuk mund të gjente rrugë midis tyre. Shigjetat binin në tokë nga qielli si breshri, ndërsa britmat e rënkimet nga toka ngjiteshin në qiell.

Sulltani doli të shihte kasaphanën e tij. Ballkani ishte mundur... «Po i plagosuri, Milosh Kubli, i përlyer me gjak, midis kufomave, u ngrit nga vendi dhe e goditi

mbretin me hanxhar», përsëritnin kronikanët njëri pas tjetrit. «Murati i Parë vdiq. Në vendin ku ra, bënë një tyrbe, që qëndron në atë vend.»

Rrija para tyrbes dhe kullës-monument, mbushur me shkronja cirilike, që sikur ridimensiononte betejën e popujve. Veç tyrbja dukej krejt e rrëgjuar në detin e tragjedisë njerëzore. Tyrbja nuk e përjetësoi dot «fitimtarin». Nuk e la ajo figurë e përgjakur me përmasa mitologjike, që dëshmoi qëndresën e popujve. Megjithëse, të mundur, megjithëse u derdhën lumenj gjaku dhe Ballkani mori goditje të padëgjuaara, ajo betejë e kishte Miloshin e saj, birin e një shqiptari, që u ngrit nga vdekja, për t'i sjellë vdekje Gaziut. Pyeta:

— A thua që këtu e ka ndjekur betejën Sulltani?

— E nga ç'vend tjetër do ta ndiqte? — tha skulptori.

— Aq thellë e ka thithur toka gjakun këtu, sa mbinë lule të kuqe, që ne i quajmë lule gjaku, — tha Vjosa.

— Nuk ka kënduar kot së koti populli, se Kosova e ka adet, ka një pashë me e pre përvjet, — tha skulptori.

— Derisa ia ka prerë kokën me hanxhar një sulltani, — thashë, ndërsa vështroja si e mahnitur fushën e Kosovës mbuluar nga mjegulla, që dridhej mbi mullarët e barit. Veturat me flamuj, me fluturimin e pandalur të nuseve të bardha, që zhdukeshin para syve tanë, si mirazhe, i jepnin larushi gazmore së dielës.

Nuk po shkëputesha dot nga ajo fushë, me tokën e përtërirë, me barin ende të gjelbër, si të donte të na përshëndeste, për gëzimet e hidhërimet e moçme njëqindvjeçare, me zërin e saj të lashtë. Mirë se erdhët e bukë e kripë, Sulë Vokshi, Isë Boletini, Bajram Curri, Sefë Kosharja e Mic Sokoli. Koha ju përcolli në njëqind breza. Njëqind herë u tha e buloi bari në këtë fushë. Ne ju kemi pritur. Mirë se keni ardhë.

— Dreka është gati, — tha Myrveti, — që vrapoi drejt e te restoranti i vogël me xhama të mëdhenj. Dukej e ngazëllyer, si çdo zonjë shtëpie para mysafirëve të saj të dashur.

— Pra qenkemi bujtës të Azemit. — tha skulptori.

— Do ta provoni piten kosovare? — tha Vjosa, —

Myrveti është një specialiste e vërtetë e jua ka sjellë të ngrohtë deri këtu.

— Nuk po ndahem dot prej këtej, — thashë.

— Është si një nuse e urtë, e shtruar, pjellore fusha e Kosovës, — tha skulptori. — Është nga ato nusët e shëndetshme, që ta mbush jetën me fëmijë e gëzim.

Myrveti po e vështronte me sytë e bukur, të mëdhenj e të hirtë. Edhe unë Myrvetin: «Si ti, e dashur, thoshin sytë e mi, po jo deri në vetëflim.»

«Vetëfljimi është gjëja më e natyrshme për një grua, për një nënë, për një kosovare; në qoftë se nuk e kemi mësuar këtë, ju nuk mund ta bënit dot kurrë tablonë e Shotë Galicës», përgjigjeshin sytë e kthjellët të Myrvetit, ndërsa na printe për në drekë.

3

Mëngjeset në Prishtinë ishin të bukura. Drita hynte nëpër perdet e holla e rridhte qetë së bashku me zhurmën e rrugës. Nga kati i gjastë dukeshin të ulëta kubetë e bibliotekës së Fakultetit të Filozofisë dhe kodrat që sundonin qytetin. Ndërtesat e reja dykatëshe, si të ishin sharruar njëherësh, mbulonin Prishtinën e dikurshme të vjetër, me rrugicat karakteristike dhe oborret e rrethuar, me ato udhët e çertexhinjve, dhe sidomos me gështenjat e pjekura, aq intime e thuajse të harruara që nga fëmijëria. Ditët vinin të ngarkuara me një lumë njerëzish, në Ekspozitën e Lidhjes në Pallatin e Rinisë.

Skicat e mia ndonin njëra-tjetrën. Rridhnin të papërbaitur ato grupe të rinjsh, studentësh, fëmijësh.

Përpiqesha të ngulitja detësinë e skulptorit e buzëqeshjen e nderë të Bujar Rugovës, kur shihte fëmijët me blloqe ndër duar, që vinin në ekspozitë, uleshin shkruanin e pyesnin për çdo gjë. Pastaj, para se të iknin, i zgjatnin përherë dorën Bajram Currit, si të donin të

ndaheshin me të. Gjatë kësaj kohe, pata rast të vëreja shumë mësues, njerëz të thjeshtë, të zakonshëm, tepër të ngjashëm e tepër të ndryshëm.

Vjosa e Bujar Rugovës erdhi në ekspozitë së bashku me nxënësit e saj. Gjimnazistët u interesuan për çdo tablo me hollësi. Kujtesa e popullit është e gjatë. Mençuria e tij e pashtershme, qëndresa e pafund. E ndiqja me kërshtëri gjithë atë mëngjes ethen e nxënësve, për të marrë sa më tepër shënime.

— Janë të rinj të dëgjueshëm e kureshtarë. — thashë.

— Po, — tha Vjosa, — mësojnë mirë. Është një rini me zell, e këtu kemi shumë për të mësuar. Kjo është vetë historia.

Nxënësit falënderuan skulptorin e bacë Bujarin, për shpjegimet e hollësishme, dhe ikën të gëzuar, të zhurmshëm, nëpër rrugët e rrugicat e Prishtinës.

— A ke kohë të pish një kafe me ne, — i tha skulptori Vjosës.

— Me gjithë qejf, — tha Vjosa.

E pastaj, duke dalë nga ekspozita për në bar, ajo tha:

— Gjimnazistët ju ftojnë në teatrin «Sofra», që ka in-skenuar veprën e Nolit.

— Do të vijmë me gëzim, — tha skulptori. — Nolin e kam poetin e zemrës.

— C'bën lum Lumi vnë, nuse? — pyeti Bujari.

— E ka marrë malli për babin. — i tha Vjosa.

— Ti mos m'u trishto, nuse. — i tha përsëri Bujari.

— Sapo u kthyem nga Prizreni e Azemin e lamë fare atje.

— Jo aspak, — tha Vjosa. — e di që keni shumë punë, po Lumi nuk e di. «Një grua të re, shumë më të bukur, kurdoherë mund ta giente një piktor i talentuar, si Bujari». më shkrepri ndër mend. Por ai dashuroi Vjosën, bashkëstudenten e Universitetit të parë të Prishtinës, mësuesen e një shkolle të periferisë, që çdo ditë shkonte e vinte me urban.

— C'do të merrni? — pyeti kamerieri.

— Nga një kafe e një shveps. — tha Bujari.

Qesha. U tregova për shvepsin. Në fillim, kur shihja

Bujarin që porosiste shveps, mendoja se ishte uzo, kurse nuk qenka veç një limonadë.

— Dukesh që je nusja e Mirosh Gurasit, — tha skulptori.

— Ma lër Miroshin të qetë, — iu përgjigja.

— Miroshi yt nuk di të pijë asnjë gotë raki, — vijoi skulptori. — E dini? Miroshi nxiton sikur po e ndjek njeri pas, ha shpejt e shpejt dhe më në fund e rrëkëllen një gotë si ilaç, duke u thartuar në fytyrë.

— Sapo të kthehemi do t'i them se e ke përgojuar.

— Dhe ai do ta kuptojë menjëherë se na paskësh marrë malli, — tha skulptori.

— Më ka mbetur peng, — tha Bujari. — Qëndrova tri javë në Tiranë, si nuk u takova një herë me ju të dy?

— Drinën, — tha skulptori, — zor se do ta gjeje.

— Pse, ku rri Drina?

— Shpesh nuk është në Tiranë, por, edhe kur është, rri mbyllur me muaj në studio, si Oso Kuka.

— Ai tallet përherë me mua dhe Miroshin, — thashë. — Vetëm në Tiranë qëndrova, Bujar?

— Jo, — tha Bujari. — kaluam pothuajse nga Veriu në Jug. Zbritëm deri në Sarandë e Ksamil, shkuaam edhe në Korçë. Korça më ngjante me Pejën. Ishte dimër. Binte borë. Nuk e di përse më ngjante me Pejën, ndoshta nga bora, ndoshta nga rrugicat me kalldrëm. Ndoshta sepse Peja është qyteti i fëmijnisë sime dhe ka po aq poezi sa Korça. Nuk e di.

— Ne kemi dëgjuar pastaj një muaj të tërë, me hollësi për çdo gjë, — tha Vjosa. — Edhe unë e kam një përfytyrim të qartë tashmë për Tiranën, për të gjitha avtetet ku ka qenë Bujari. Për shëtitiet në shëtitoren «Dëshmorët e Kombit», për veshiet e thjeshta të vajzave e diemve, për metalurgjikun, nër brezalet dhe kodrat me agrume, për Ksamilin dhe detin, vecanërisht për detin.

Dëgjoja Vjosën, tek fliste me fialën e ëmbël, që dukej se dilte nga thellësia e kuitesës së popullit.

— Në të vërtetë, — tha Bujari, — detin e dua shumë. E soditja me orë pafundësinë e tij. Dëgjoja zemëri-

min, zemërim i drejtë. E më dukej se Posejdoni kalonte me karrocën e tij nëpër të. Kuajt grahnin me galop, të bardhë, të shkumëzuar nga valët. Është i bukur deti. Ne, që e kemi mësuar notin në lumenj të rrëmbyeshëm, si Bistrica e Pejës, kur notojmë në det të hapur, e ndiejmë menjëherë se është i gjithëpushtetshëm. Është i gjithëpushtetshëm si vetë zemërimi i popullit. Ilirët, të parët tanë, e kanë rrahur detin anembanë.

— Ilirët, — tha Vjosa. — Bujari u nis për arkeolog dhe përfundoi piktor.

— Dhe më ka gëzuar aq tepër puna, — tha Bujari. — Kur kam kaluar nga Veriu në Jug, jam gazmuar si fëmijë nga puna që ia ndërron faqen tokës. Dhe ta dini. Kur i ke hambarët plot, edhe kokën po di ta mbash më lart e të mos e ulësh, si një rrogëtar i mjerë.

— E dini ç'na ka sjellë nga Shqipëria? — tha Vjosa. — Sigurisht nuk e merrni me mend.

— Tani e teprove, nuse, — tha Bujari.

— Jo, — tha Vjosa, — na e trego.

— Kur jam kthyer nga Shqipëria, — tha Bujari, — kam sjellë një grusht dhé nga Dragobia, për ta hedhur mbi varrin e tim eti. Ky ka qenë amaneti i tij. Babai im ka qenë bashkëluftëtar i bacë Bajramit.

— Pse nuk ia tregon Drinës, si ke zbritur në shpellën e Perçevës për të mbledhur eshtrat e Azem Galicës? — tha Vjosa.

— Kjo më intereson tepër, — thashë.

— Po këtu s'ka asgjë të jashtëzakonshme, shpesh na është dashur të zhvarrosim nierëz tepër të shtrenjtë. Veç atë punë e ka kryer një kushëri i nënës sime, që është drenicak, mësuesi Abdyl Krasniqi. Abdyli e ka pasë daië Kadri Berishën, që edhe ia ka vënë emrin, në kujtim të Abdyl Frashërit. Sa herë, kur dëgjonte këngën e Azem Galicës, Kadriu qante. Kur Abdyli e ka pyetur plakun: përse po qan? Kadriu është përgjigjur: «E kam pasë udhëheqës të mirë e të dashun Azemin. E sot, kur mendoj se as varri i tij s'gjenet kund, sepse me duert e mia e kam lëshue kufomën e tij në një shpellë të thellë, që kurrkush s'ia ka shkelë fundin, më vjen keq». Abdylin e

rrëmbeu ideja për t'i zbuluar dhe nxjerrë eshtrat e Azem Galicës, duke sakrifikuar çdo gjë. Më të vështirë e ka pasur me plakun. Nuk donte të tregonte në asnjë mënyrë ku ishte shpella, se i dukej se po shkelte amanetin e kryetrimt. Një vit është përpjekur Abdyli, e nuk ka hequr dorë nga qëllimi i tij fisnik. Më kanë interesuar edhe mua ky pasion e këto përpjekje. U siguruan më në fund edhe mjetet për të zbritur në shpellë. E ka kërkuar edhe një llambë karbiti nga minatorët Abdyli, e jemi lëshuar në shpellë, rreth dyzet metra. Ishte shumë ftohtë. Kërkuam të na nxirrnin lart. U veshëm me lesh e u lëshuam përsëri. Në të dyzetepestin metër ngecëm. Kthina ishte aq e ngushtë, sa mezi përbirohte një njeri. Unë mbeta. Abdyli zbriti deri në të tetëdhjetin metër. I gjeti dhe i mblodhi eshtrat e Azemit. Shokët na tërhoqën me litarë e çikrikë. Dolëm jashtë që të dy. Atëherë populli tha: «Edhe nga shpella fluturoi Azemi.»

Megjithëse kjo punë i hëngri Abdylit një vit mund e shqetësim, gjithë vitin 1972, edhe mua gjithashtu mjaft kohë, e kishte vlejtur vetëm për të parë atë çast, kur plaku i moçëm Kadri Berisha qante me ngashërim, i përkëdhelte eshtrat e Azemit, duke i lëmuar me kujdes, si nëna birin e saj, pas një ndarjeje të gjatë. Shpesh matem të kryej një tablo për këtë, por, siç, duket, arti është i varfër për të dhënë dhembjët e mëdha.

— Po i vëreja Vjosën e Bujarin si e mpirë. Nuk ishte e mundur të thosha ç'ndieja në ato çaste. Një therje në shpirt, një dhembje të patreguar për një burrë të fuqishëm si Bujari, që belbëzonte, sepse po e hapte krejt zemrën para të huajve. Por a mund të ishim të huaj ne për njëri-tjetrin? Nuk po flisja fare. E as që ishte nevoja. Vjosa ia mori Bujarit dorën e madhe midis duarve të saj të brishta.